



Organizata për
Demokraci, Antikorrupsion
dhe Dinjitet, Çohu!



QASJA NË DREJTËSI DHE TË DREJTAT E NJERIUT



Maj 2016 - Maj 2017

RAPORT I MONITORIMIT
TË GJYKATAVE NË
PRISHTINË, MITROVICË
DHE GJILAN



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian ne Kosovë




QASJA NË

DREJTËSI DHE

TË DREJTAT

E NJERIUT



Maj 2016 - Maj 2017

RAPORT I MONITORIMIT
TË GJYKATAVE NË
PRISHTINË, MITROVICË
DHE GJILAN

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është prodhuar me asistencën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e organizatës Çohu! dhe Communication for Social Development (CSD) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.

Përpiluar nga:

Genc Nimoni

Monitorues:

Drilon Dobruna dhe Fjolla Azemi

Lekturoi:

Besa Kalaja

Origjinali është shkruar në shqip

Publikuar nga:

Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu!
Rruga: Rrustem Statovci Nr.17; Prishtinë, Kosova
Tel / +381 (0)38 248 506
www.cohu.org

PËRMBLEDHJE



Përmbledhje Ekzekutive	8
Shkurtesat	11
Metodologjia	12
Hyrje	13
I. Informacione bazike – gjykatat themelore në Prishtinë, Gjilan dhe Mitrovicë	14
1.1 Gjykata Themelore në Prishtinë - Struktura dhe organizimi i gjykatës.....	14
1.2 Gjykata Themelore në Mitrovicë - Struktura dhe organizimi i gjykatës.....	15
1.3 Gjykata Themelore në Gjilan- Struktura dhe organizimi i gjykatës.....	16
II. Të gjeturat e monitorimit	17
2.1 Transparenca e gjyqësorit	18
2.2 Vonesa në fillimin e shqyrtimeve dhe shtyrja	20
2.3 Shkelja e afateve ligjore.....	24
2.3.1 Shkelja e afateve në shqyrtimin fillestar	25
2.3.2 Shkelja e afateve në shqyrtimin dytësor	26
2.3.3 Shkelja e afateve në shqyrtimin kryesor	26
2.3.4 Shkelja e afateve lidhur me përfundimin e shqyrtimin kryesor	27

BAJTIJA

III. Mungesa e procesit të rregullt gjyqësor dhe shkelja e të drejtave të njeriut - Mitrovicë	28
3.1 Historik i shkurtër	28
3.2 Vështirësitë	29
3.3 Mungesa e qasjes në drejtësi dhe shkelja e të drejtave në gjykim	30
3.4 Trajtimi i rasteve dhe krahasimi me gjykatat tjera.....	32
IV. Rastet e profilit të lartë - Luftimi i korrupsionit të nivelit të lartë	33
4.1 Mungesa e të dhënave për profilet (pozitat).....	38
V. Përfundime dhe Rekomandime	40
ANEKSE	44
I. Krahasimi dhe analiza e procedimit të rasteve në prokurori dhe gjyqësi gjatë viteve 2015 dhe 2016.....	44
1.1 Procedimi i rasteve në prokurori dhe gjykata gjatë vitit 2015 dhe të gjeturat.....	44
1.2 Procedimi në prokurori dhe gjykata gjatë vitit 2016 dhe të gjeturat.....	47
1.3 Mospërputhja e të dhënave	47
1.4 Përqindja e zgjidhjes së rasteve sipas kapitujve.....	51
II. Trajtimi i rasteve dhe efikasiteti në prokurori dhe gjykata.....	54
2.1 Rastet e korrupsionit	54
2.2 Rastet e krimit të organizuar.....	61
2.3 Rastet e veprave penale kundër martesës dhe familjes.....	65
2.4 Rastet Nxitja e Urrejtjes, Përçarjes ose Mosdurimit Kombëtar, Racor, Fetar apo Etnik.....	69

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjtet, Çohu! (tutje në tekst organizata Çohu!) në partneritet me OJQ-në Komunikimi për Zhvillim Shoqëror (tutje në tekst organizata CSD), kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (tutje në tekst si KGJK) për monitorimin e gjykatave. Pas nënshkrimit të marrëveshjes në muajin prill 2016, organizatat kishin filluar monitorimin e rasteve të korrupsionit, krimit të organizuar, rastet nga veprat penale kundër Martesës dhe Familjes si dhe rastet nga neni 147 i Kodit Penal të Kosovës (tutje në tekst si KPRK).

Qëllimi i fokusit në kapitujt e tillë të veprave penale është monitorimi i lëndëve të caktuara si lëndë për trajtim me prioritet, rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe krahasimi me veprat tjera penale të karakterit sensitiv, ato kundër dhunës në familje dhe kundër të drejtave të njeriut, siç janë rastet penale nga kapitulli i veprave penale kundër familjes dhe martesës si dhe vepra penale e nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik.¹

Gjatë periudhës një vjeçare, ÇOHU! dhe CSD kanë monitoruar gjithsej 102 raste me 214 seanca gjyqësore në gjykatat themelore në Prishtinë, Gjilan dhe Mitrovicë, me ç'rast janë identifikuar shkelje të ndryshme në sistemin gjyqësor nga këto tri gjykata, duke filluar nga ato teknike dhe procedurale, deri te ato përmbajtëse.

Fokus i analizës janë të gjeturat e monitorimit, krahasimin dhe analizimin e të dhënave për veprat penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe të tjerat që ishin fokus i analizës dhe monitorimit.

Fillimisht të gjeturat nga analiza e të dhënave për vitin 2015 dhe 2016, identifikojnë shpërputhje dhe mos-harmonizim të të dhënave të Këshillit Prokurorial të Kosovës (tutje në tekst si KPK) për rastet e korrupsionit dhe, ndëshkimet e pakta dhe të ulëta nga gjykatat.

Sipas llogaritjes së të dhënave për vitin 2015, gjejmë se

¹ Shënim: Fokus i monitorimit për këtë vit kanë qenë tre (3) gjykatat themelore të Kosovës, Gjykata Themelore në Prishtinë me degën e sajë në Graçanicë, Gjykata Themelore në Mitrovicë si dhe Gjykata Themelore në Gjilan. Fillimisht monitorimi është fokusuar në rastet penale nga kapitujt e veprave penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare, krimit të organizuar, veprat penale kundër martesës dhe familjes si dhe veprën penale të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, me fokus të veçantë në rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

ka shpërputhje për 59 raste me 59 persona, me ç'rast në mekanizmin përcjellës të KPK-së për rastet e korrupsionit, figurojnë 59 raste me shumë dhe 59 persona më pak sesa do të duhej të ishin, bazuar në të dhënat në punë, pa ato të zgjidhura gjatë periudhës janar – dhjetor 2015.² Ndërsa për vitin 2016, mospërputhja e lëndëve ekziston në numër më të vogël të rasteve, 2 raste me 78 persona më shumë.³

Çohu! dhe CSD konsiderojnë se mospërputhja e të dhënave të tilla, në veçanti rasteve të korrupsionit, dëshmon problemet e vazhdueshme të KPK-së lidhur me unifikimin dhe procedimin e saktë të rasteve të tilla. Edhe pse në dukje probleme të natyrës teknike, Çohu! dhe CSD vlerësojnë se mospërputhja e të dhënave nga mekanizmi përcjellës, pamundëson qasjen në të dhënat e sakta dhe si pasojë krijon vështirësi në analizën dhe përfundimin e procedimit të këtyre të dhënave nëpër kategori të ndryshme.

Ndërsa në anën tjetër bazuar në të dhënat e KGJK-së, në gjykata, dominojnë dënimet e lehta për rastet e veprave penale të korrupsionit, derisa gjithashtu vërehet mungesa e ndëshkimeve për rastet e kimit të organizuar.

Nga raporti del se si në prokurori, ashtu dhe në gjykata numri me i madh i lëndëve të trajtuara janë ato të natyrës së korrupsionit.

Bazuar në të dhënat e KPK-së për kapitujt përkatës, prokuroritë kishin zgjidhur 44.76% të personave të përfshirë në rastet e natyrës së korrupsionit gjatë vitit 2016 (1,115 persona nga gjithsej 2,491 të tillë sa ishin në punë për këtë periudhë), 45.86% të personave për veprat penale kundër martesës dhe familjes, kanë zgjidhur 41.38% për krimin e organizuar dhe vetëm 18.22% të personave (16 persona nga 85 të tillë sa kishin në punë prokuroritë gjatë vitit 2016).

2. Shënim: Statistika e tillë del të jetë ndryshe nga kjo që figuron në të dhënat e KPK-së nëse llogaritim të gjitha lëndët në punë gjatë vitit 2015 (1,119 raste me 3,216 persona) pa lëndët e zgjidhura gjatë periudhës së njëjtë (522 lëndë me 1,113 persona). Nga llogaritja e të gjitha lëndëve në punë (1,119 raste me 3,216 persona) pa lëndët e zgjidhura gjatë periudhës së njëjtë (522 lëndë me 1,113 persona) dalin të jenë 597 raste me 2,103 persona dhe jo siç figurojnë në të dhënat e KPK-së, 656 raste me 2,162 persona.

3. Shënim: Mospërputhja e të dhënave sipas kapitujve të trajtuar për prokuroritë, ekziston gjithashtu në periudhat kohore ndërmjet vitit 2015 dhe 2016. Saktësisht, të dhënat të cilat kanë figuruar me 31 dhjetor 2015 e të cilat do të duhej të ishin po ato të dhëna që trashëgohen në vitin pasues, përkatësisht me 1 janar 2016, nuk figurojnë të jenë të barabarta. Marr parasysh të dhënat totale nga të gjithë kapitujt, derisa në fund të vitit 2015 (31 dhjetor 2015) kishin mbetur të pazgjidhura 656 raste me 2,162 persona, me 1 janar 2016 figurojnë 658 raste me 2,240 persona.

Veprat penale të korrupsionit prijnë me përqindjen e rasteve të zgjidhura edhe në gjykata me ç'rast nga gjithsej 929 rastet e korrupsionit në punë gjatë vitit 2016, gjykatat themelore në shkallë të parë kanë zgjidhur 357 raste apo 38.4% të tyre. 30.6% dhe 35.71% janë zgjidhur rastet për veprat penale kundër martesës dhe familjes, përkatësisht vepra penale e nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, derisa vetëm 3 raste nga gjithsej 63 të tilla në punë i rasteve të kimit të organizuar, janë zgjidhur gjatë vitit 2016.

Edhe pse të trajtuara me prioritet po ashtu nga gjykatat, rastet e korrupsionit vazhdojnë të bartën nga viti në vit në numër pothuajse të njëjtë më atë të viteve paraprake.

Monitorimi i Çohu! dhe CSD është bërë në baza ditore, me ç'rast fokus i monitorimit kanë qenë rastet e korrupsionit dhe kimit të organizuar. Të gjeturat e monitorimit në tri gjykatat themelore, Prishtinë, Gjiilan dhe Mitrovicë, kanë identifikuar të gjetura të ndryshme, duke filluar nga ato me teknike siç janë mungesa e transparencës dhe vonesat në fillimin e shqyrtimeve gjyqësore, deri të shkeljet e afateve procedurale ligjore dhe shkeljet e të drejtave të njeriut.

Në regjionin e Mitrovicës, e cila gjithashtu përfshinë komunat në veriun e Kosovës, përveç mosfunksionimit të gjyqësorit në atë pjesë për më shumë se 8 vjet, monitorimi gjithashtu ka identifikuar probleme të vazhdueshme. Mungesa e kushteve normale për gjykim dhe mungesa e hapësirave në gjykatë, numri i madh i lëndëve dhe mungesa e numrit të mjaftueshëm me gjykatës dhe prokuror për të mbuluar të gjitha rastet, kishin rezultuar me vështirësitë e trajtimit të tyre (rasteve) brenda afateve ligjore dhe kishin pamundësuar zhvillimin normal dhe mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore.

Çohu! dhe CSD konsiderojnë se përkundër lëvizjes në drejtim të funksionimit dhe trajtimit të rasteve të tilla për regjionin e Mitrovicës (veriu i Mitrovicës, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan), komunat veriore vazhdojnë të kenë probleme serioze në funksionim.

Organizata Çohu! dhe CSD konstatojnë se pamundësia e zhvillimit të procesit të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të arsyeshme, shkelja e afateve hetimore dhe ato procedurale për procedimin dhe përfundimin e shqyrtimeve gjyqësore, është shkelje e të drejtave të njeriut, e parapare me Kon-

ventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, dispozitat kushtetuese për gjykimin e drejtë dhe të arsyeshëm, Ligjin për Gjykatat si dhe dispozitat procedurale penale.

Tutje të gjeturat e monitorimit, identifikojnë mungesë të transparencës së gjyqësorit, me ç'rast shpesh seanca të rëndësishme publike në të cilat akuzohen funksionarë të lartë të cilët mbanin pozita të larta publike, janë mbyllur për publikun dhe të interesuarit si dhe kanë qenë të pa qasshme. Vonesa në fillimin e shqyrtimeve gjyqësore si dhe shtyrja e tyre është identifikuar në të tri gjykatat e mbuluara me monitorim.

Shkelje ende më e rëndë ishte mosrespektimi i afateve procedurale ligjore. Nga gjithsej 102 rastet e monitoruara me 214 seanca në tri gjykatat themelore (Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjiilan), pothuajse në asnjërin prej rasteve nuk janë respektuar afatet ligjore të cilat kanë të bëjnë me caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimeve gjyqësore (fillestar, dytësor dhe atij kryesor) si dhe me afatet e përfundimit të tyre. Edhe pse caktimi i një shqyrtimi fillestar përfshinte periudhën prej 30 ditë nga momenti i pranimit të rastit në gjykatë, sipas të dhënave të monitorimit një gjë e tillë nuk ishte bërë edhe deri në 3 vjet.

Çohu! dhe CSD konsiderojnë se shkelja e afateve të tilla dhe mos-respektimi i tyre, është shkelje e dispozitave procedurale dhe vazhdon të ketë pasoja në tejzgjatjen e shqyrtimeve gjyqësore dhe grumbullimin e vazhdueshëm më lëndë. Njëkohësisht shkelja e tillë, është shkelje e parimeve të drejtësisë për një gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme.

Bazuar në të dhënat e monitorimit në tri gjykatat përkatëse, nga gjithsej 102 rastet e monitoruara, 15 të tilla janë të kualifikuara si korrupsion i nivelit të lartë. Sipas të dhënave të monitorimit, në rastet e korrupsionit të lartë, të përfshirë janë personat nga profilet e ndryshme, deri të biznesmenë dhe qytetar të thjeshtë si: deputetë, ministra, zv/ministra dhe sekretar të përgjithshëm të ministrive, kryetar të komunave, kryetar të gjykatave, kryeprokuror dhe të tjerë. Organizata Çohu! dhe CSD identifikojnë si shqetësuese rastet e pakta të profilit të lartë, gjithashtu mënyrën e zgjidhjes së rasteve të tilla. Nga gjithsej 13 personat e profilit të lartë, rastet ndaj 8 të akuzuarve kanë përfunduar, në shkallë të parë apo të dytë, derisa rastet për 5 të tjerë, vazhdojnë të jenë në procesin gjyqësor.

Nga gjithsej 8 të akuzuarit ndaj të cilëve ka përfunduar procesi gjyqësor (2 ministra, 4 kryetar komunash, një kryetar gjykate dhe një kryeprokuror) 4 janë shpallur fajtor dhe janë ndëshkuar me dënime minimale, ndërsa ndaj 4 të tjerëve janë hedhur

poshtë aktakuzat në mungesë të provave, sipas arsyetimit të gjykatës.

Çohu! dhe CSD vlerësojnë se dënimet e ulëta, hedhja poshtë e aktakuzave dhe lirimi i zyrtarëve të kualifikuar si zyrtar me profilin e lartë, dëshmon edhe njëherë për shkallën e ulët të luftimit dhe ndëshkimit të korrupsionit të nivelit të lartë.

Tutje në aneksin e raportit, është trajtuar efikasiteti i gjykatave dhe prokurorive veçanërisht për secilin kapitull. KPK dhe KGJK kishin vendosur që lëndët e natyrës korruptive, të trajtohen me prioritet absolut, duke nxjerrë Strategji dhe Plane të Veprimit për reduktimin e lëndëve të korrupsionit dhe trajtimin e tyre me prioritet. Derisa gjatë vitit 2016, prokuroritë kishin zgjidhur gjithsej 461 raste, në anën tjetër gjykatat për periudhën e njëjtë kishin zgjidhur 357 raste të natyrës së korrupsionit.

Rastet e krimit të organizuar janë shpallur gjithashtu si lëndë për trajtim me prioritet nga prokuroritë dhe gjykatat në Kosovë, të cilat madje janë kategorizuar edhe si standard për të arrihur në proceset e ndryshme integruese. Edhe pse lëndë më komplekse për nga natyra, mbetet shqetësues numri i vogël i rasteve të zgjidhura në prokurori dhe gjykata, më theks të veçantë në gjykata. Për dy vjet me radhë (2015, 2016), gjykatat kishin zgjidhur vetëm 5 raste të krimit të organizuar dhe marrë parasysh faktin e standardit me prioritet, shifra e tillë as për së afërmi nuk përmbushë luftimin e dukurisë së tillë si një ndër dukuritë problematike në Kosovë.

Organizata Çohu! dhe CSD konsiderojnë se numri i madh i rasteve të trashëguara nga viti në vit, vazhdojnë të mbetën ngarkesa kryesore, në veçanti për gjyqësorin. Profilizimi i prokurorëve dhe gjykatësve për veprat penale të natyrës së njëjtë, gjithashtu rritja e numrit të nevojshëm me prokurorë, gjykatës dhe bashkëpunëtor profesional, do të ndikonte në zvogëlimin e numrit të madh në gjykata dhe prokurori, si dhe në procedimin më efikas të prokurorisë dhe gjykatave në trajtimin e rasteve të korrupsionit.

Rekomandimet adresojnë të gjeturat për institucionet kryesore si KPK, KGJK, gjykatat dhe prokuroritë, Institutin Gjyqësor dhe të tjerë, dhe të cilat kanë të bëjnë me rritjen e numrit të gjykatësve dhe prokurorëve, evitimin e mos-përputhjes së të dhënave në mekanizmin përcjellës, vazhdimin e arsimimit ligjor, përgjegjësinë gjyqësorit dhe prokurorisë për vjetërsimin e lëndëve, forcimin dhe krijimin e mekanizmave llogaridhënës në KGJK dhe KPK të cilat kanë të bëjnë me përgjegjësinë dhe masat ndaj gjykatësve dhe prokurorëve.

SHKURTESAT

BE

Bashkimi Evropian

DKR

Departamenti i Krimeve të Rënda

DP

Departamenti i Përgjithshëm

EULEX

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

GjA

Gjykata e Apelit

GjS

Gjykata Supreme

GjTh

Gjykata Themelore

KE

Komisioni Evropian

KGJK

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK

Këshilli Prokurorial i Kosovës

KPRK

Kodi Penal i Kosovës

KPPK

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës

PK

Policia e Kosovës

PTh

Prokuroria Themelore

PSRK

Prokuroria Speciale e Kosovës

PE

Parlamenti Evropian

USAID

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

ÇOHU!

Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet

CSD

Organizata Komunikimi për Zhvillim Shoqëror



METODOLOGJIA

Në muajin prill të vitit 2016, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka lidhur memorandum me organizatat Çohu! dhe CSD për bashkëpunim dhe monitorim të rasteve penale nga kapitujt e veprave penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare, krimit të organizuar, veprat penale kundër martesës dhe familjes si dhe veprën penale të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik. Memorandumi i tillë kishte mundësuar qasjen e Çohu! dhe CSD në monitorimin e rasteve në gjykata dhe në të dhënat e Këshillit Gjyqësor për periudhat relevante.

Fillimisht gjatë procedimit të të dhënave për gjykatat dhe prokuroritë, të dhëna këto të siguruar nga Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial, organizata Çohu! në partneritet me organizatën CSD ka përdorur metodën krahasuese kuantitative duke krahasuar dhe analizuar kështu procedimin e të dhënave të prokurorive dhe gjykatave për periudhat e caktuara sipas kapitujve të cilët edhe ishin në fokus të analizës.

Qasja në përcjelljen e seancave gjyqësore dhe monitorimi i 214 seancave gjyqësore në 102 raste, ka mundësuar identifikimin e problemeve nga me të ndryshmet të cilat karakterizojnë një shqyrtim gjyqësor dhe vet gjykatën. Gjatë punimit të raportit, gjithashtu është përdorur hulumtimi ligjor i legjislacioneve përfshirë këtu legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar, të cilat janë edhe burim i punës, krahasimeve, të gjeturave si dhe rekomandimeve të këtij punimi.

Gjatë punimit janë përdorur aktet duke filluar nga Kushtetuta, Kodi Penal, Kodi i Procedurës, Ligji për Gjykatat, Ligji për Prokurorin e Shtetit, Ligji për Këshillin Prokurorial dhe atë Gjyqësor, Konventa Evropian për të Drejtat e Njeriut, Strategjitë dhe Planet e Veprimit të këshillave (Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial) raportet statistikore të këshillave si dhe akte të tjera nënligjore relevante.

Intervista me akterët kryesor të prokurorisë dhe gjyqësorit, kryetarë gjykatash, kryeprokurorë dhe akterë të tjerë, gjithashtu janë përfshirë në punim, duke bërë kështu ballafaqimin e të gjeturave nga monitorimi dhe gjithashtu duke mundësuar qasjen në pikëpamjet dhe shqetësimet e akterëve kryesor të gjyqësorit dhe prokurorisë lidhur me efikasitetin e gjyqësorit dhe prokurorisë për çështjet relevante.

HYRJJE

Korrupsioni dhe krimi i organizuar, mbetën ndër sfidat e vazhdueshme të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Shkalla e lartë e korrupsionit e cila pamundëson funksionimin normal të institucioneve lokale dhe qendrore dhe e cila përcjellët me mungesën e gatishmërisë dhe vullnetit politik për të luftuar korrupsionin, mbetet gjithashtu shqetësim për zhvillimin në vend dhe kërkesë e vazhdueshme e institucioneve ndërkombëtare duke u vendosur kështu edhe në kriteret e Bashkimit Evropian (BE) për proceset e ndryshme integruese.

Ani pse është shtuar efikasiteti i prokurorive dhe gjykatave me numrin e rasteve të zgjidhura, në veçanti në vitin e fundit, megjithatë bazuar në raportet ndërkombëtare dhe vendore, mbetet ende për t'u bërë në luftimin dhe ndëshkimin e korrupsionit.

Qëllimi i fokusit në kapitujt e tillë të veprave penale është monitorimi i lëndëve të caktuara si lëndë për trajtim me prioritet, rastet e korrupsionit dhe krimet të organizuar, si dhe krahasimi me veprat tjera penale të karakterit sensitiv, ato kundër dhunës në familje dhe kundër të drejtave të njeriut, siç janë rastet penale nga kapitulli i veprave penale kundër familjes dhe martesës si dhe vepra penale e nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik.⁴ Lidhur me këtë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial, kishin nxjerrë vendime dhe strategji për trajtimin me prioritet të rasteve të korrupsionit dhe krimet të organizuar, duke miratuar edhe Plane të Veprimit për rastet e tilla. Një ndër objektivat kryesore të planeve të veprimit ishte reduktimi dhe përfundimi i rasteve të vjetra.

Prandaj fokusi në monitorimin dhe analizën e këtyre dy kapitujve të veprave penale, krahasueshmërisht me dy kapitujt të tjerë, atë kundër martesës dhe familjes si dhe veprën penale të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, kishte për qëllim krahasimin e procedimit të rasteve të

tilla në prokurori dhe gjykata, si dhe faktin nëse KGJK dhe KPK, respektonin vendimet e tyre për trajtim me prioritet të rasteve për të cilat kishin vendosur të trajtohen si të tilla, me prioritet (ato të korrupsionit dhe krimet të organizuar).

Mirëpo fatkeqësisht prokuroritë dhe gjykatat, vazhdojnë të kenë numër të konsiderueshëm të rasteve të vjetra të po kësaj natyre dhe numër të madh të tyre në procedim.

Gjatë periudhës së monitorimit maj 2016 – maj 2017, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe Gjykatën Themelore në Gjiilan, Organizata Çohu! dhe CSD kanë monitoruar gjithsej 102 raste me 214 seanca gjyqësore i cili monitorim ishte bërë bazuar në Marrëveshjen për Bashkëpunim.⁵ Synimi i marrëveshjes ishte përkrahja e proceseve për avancimin e sistemit të drejtësisë dhe sundimit të ligjit në Kosovë, përmes bashkëpunimit reciprok të palëve nënshkruese bazuar në legjislacionin në fuqi në Kosovë.

Monitorimi i 186 seancave gjyqësore, kishte identifikuar problemet si: me mungesën e transparencës, numrin e madh me lëndët dhe numrin e vogël me gjykatësit dhe prokurorët, vonesat e fillimit të shqyrtimeve dhe shtyrja e tyre, mos-funksionimi i gjyqësorit në veri dhe shkelja e parimeve të drejtësisë deri të shkelja e të drejtave të njeriut, bazuar në Kushtetutën e Kosovës, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe legjislacionin vendor. Ndër tjera, gjithashtu janë identifikuar shkelje të afateve procedurale ligjore lidhur me caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimeve gjyqësore (fillestar, dytësor dhe kryesor), si dhe shkelja e afateve të përfundimit të një shqyrtimi kryesor. Përveç monitorimit të rasteve në gjykatat e lartshënuara, analiza dhe krahasimi i procedimit për të dhënat nga kapitujt e tillë të cilët kanë qenë fokus të monitorimit, është bërë gjithashtu për të gjitha lëndët në gjykatat themelore dhe prokuroritë themelore për periudhën 2015 dhe 2016. Analizimi dhe krahasimi i të dhënave, është

4 Shënim: Fokus i monitorimit për këtë vit kanë qenë tre (3) gjykatat themelore të Kosovës, Gjykata Themelore në Prishtinë me degën e sajë në Graçanicë, Gjykata Themelore në Mitrovicë si dhe Gjykata Themelore në Gjiilan. Fillimisht monitorimi është fokusuar në rastet penale nga kapitujt e veprave penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare, krimet të organizuar, veprat penale kundër martesës dhe familjes si dhe veprën penale të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, me fokus të veçantë në rastet e korrupsionit dhe krimet të organizuar.

5 Shënim: Marrëveshja ka për qëllim bashkëpunimin reciprok në mes të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe organizatave: Organizatës për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu! si dhe organizatës për Komunikim dhe Zhvillim Social - CSD për monitorimin e procedurave gjyqësore me qëllim të kontributit të përbashkët për interesin më të mirë për publikun dhe gjyqësorin.



Në fund të vitit 2016, gjykatat kanë numëruar gjithsej

261 gjykatës me

365,976 lëndë të pazgjidhura në fund.

bërë bazuar në të dhënat e siguruara në Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe ato në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Kjo pasqyron procedimin e rasteve për periudhat e tilla, përqindjen e rasteve të zgjidhura sipas kapitujve, mospërputhjen e të dhënave dhe efikasitetin e prokurorive dhe gjykatave.

Si përfundim, bazuar në të gjeturat e monitorimit dhe analizës së të dhënave, janë përfshirë rekomandimet duke vënë në pah të gjeturat kryesore dhe adresimin e tyre për institucionet relevante të zbatimit të ligjit.

1. Informacione bazike – gjykatat themelore në Prishtinë, Gjilan dhe Mitrovicë

Bazuar në të dhënat e KGjK-së, gjykatat themelore të Kosovës në fund të vitit 2016 kanë numëruar gjithsej 261 gjykatës me 365,976 lëndë të pazgjidhura në fund. Organizata Çohu! Dhe CSD janë fokusuar në monitorimin e gjykatave themelore në Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjilan.⁶

1.1 Gjykata Themelore në Prishtinë - struktura dhe organizimi gjykatës

Gjykata Themelore në Prishtinë është gjykata me numrin më të madh të lëndëve ndër gjykatat themelore në

Kosovë. Regjioni i GjTh në Prishtinë përfshinë katër degë të gjykatave në komunat Gillogoc, Graçanicë, Podujevë dhe Lipjan. Degët e gjykatave, trajtojnë lëndët nga Departamenti i Përgjithshëm, derisa Gjykata Themelore në Prishtinë, trajton gjithashtu lëndët në kompetencë të Departamentit për Krime të Rënda, atij Administrativ dhe Departamentit për Çështje Ekonomike, përveç departamenteve të tjera.

Nga gjithsej 261 gjykatësit e gjykatave themelore në Kosovë, GjTh në Prishtinë numëron gjithsej 83 gjykatës,⁷ apo 31% të të gjithë gjykatësve. Nga gjithsej 365,976 lëndë të pazgjidhura në fund të vitit 2016 në të gjitha gjykatat themelore, Gjykata Themelore në Prishtinë së bashku me degët numëron 144,562 lëndë apo rreth 40% të të gjitha lëndëve që kanë mbetur të pazgjidhura në të gjitha gjykatat themelore në fund të vitit 2016.⁸

Bazuar në po këto të dhëna, nëse krahasojmë numrin e gjykatësve në proporcion me numrin e lëndëve, del se GjTh në Prishtinë, ka numër më të vogël me gjykatësit në proporcion me lëndët në punë. Pra, përderisa mbulon pothuajse gjysmën e lëndëve të të gjitha gjykatave themelore në Kosovë (përkatësisht rreth 40%), kjo gjykatë numëron vetëm 31% të të gjithë gjykatësve, e cila shifër duket të mos e plotësojë as për së afërmi nevojën e trajtimit dhe zgjidhjes së rasteve.

Ngarkesa e secilit gjykatës me numrin e madh të lëndëve në punë dhe atyre të reja që pranohen çdo ditë, ka pamundësuar zvogëlimin e lëndëve, të cilat në numër të madh, vazhdojnë të barten nga vitit në vit.

Nëse llogaritet mesatarja e lëndëve për një gjykatës, atëherë

6 Raporti statistikor i gjykatave për vitin 2016, faqe 5; <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/report/list/1>.

7 Vërejtje: Në bazë të të dhënave të GjTh në Prishtinë të muajit prill, në GjTh në Prishtinë së bashku me degë, numëron gjithsej 81 gjykatës.

8 Raporti statistikor i gjykatave për vitin 2016; <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/report/list/1>.



Gjykata Themelore në Prishtinë:

40% të lëndëve në Kosovë (144,562 lëndë nga gjithsej 365,976 lëndë)

30% të gjykatësve në Kosovë (83 gjykatës nga gjithsej 261)

del se një gjykatës në Gjykatën Themelore në Prishtinë së bashku me degët është i ngarkuar me 1,741 lëndë.

Shuma prej 1,741 lëndëve për një gjykatës të vetëm, marrë parasysh gjithashtu numrin e rasteve të reja të cilat pranojnë gjykatat, del të jetë e pa përbalueshme për një gjykatës. Sipas të dhënave të KGJK-së, vetëm gjatë një viti një gjykatës në Gjykatën Themelore në Prishtinë, është i ngarkuar me 1,608 lëndë të reja.⁹

Numri i lëndëve në punë dhe ato të reja që pranojnë gjykatat gjatë një viti, del të jetë shifër e papërbalueshme për efikasitetin e një gjykatësi, e cila vazhdon të rëndojë tutje gjendjen më lëndët dhe mos-efikasitetin edhe të kësaj gjykate.

Në anën tjetër, nga gjithsej 102 rastet me 214 seancat e monitoruara nga ÇOHU! dhe CSD për periudhën një vjeçare në gjykatat themelore në Prishtinë, Gjilan dhe Mitrovicë, në GjTh në Prishtinë janë monitoruar gjithsej 64 raste me 165 seanca gjyqësore. Gjatë monitorimit po në këtë gjykatë, organizata ÇOHU! dhe CSD kanë identifikuar shkelje të shumta, nga ato teknike procedurale, deri të shkeljet përmbajtjesore. Vështirësia e kompletimit të trupit gjykues për shkak të numrit

● Nëse llogaritet mesatarja e lëndëve për një gjykatës, atëherë del se një gjykatës në Gjykatën Themelore në Prishtinë së bashku me degët është i ngarkuar me 1,741 lëndë.

⁹ Shënim: Sipas të dhënave të KGJK-së, Raportit statistikor të gjykatave për vitin 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë me degët, gjatë vitit 2016 kishte pranuar gjithsej 133,098 lëndë të reja në punë nga gjithsej 423,044 lëndë sa kishin pranuar të gjitha gjykatat themelore me degë në Kosovë.

TË GJETURAT KRYESORE TË MONITORIMIT NË GJYKATËN THEMELORE NË PRISHTINË JANË:

- Vështirësitë në krijimin e trupit gjykues;
- Numri i vogël me gjykatës;
- Mbyllja e seancave gjyqësore të rëndësisë publike;
- Shkelja e dispozitave procedurale;
- Shkelja e afateve në shqyrtimet fillestare, dytësore, kryesore dhe shkelja e afateve lidhur me përfundimin e tyre;

të vogël me gjykatës, në veçanti në Departamentin e Krimeve të Rënda, vazhdon të jetë ndër problemet kryesore të GjTh në Prishtinë. Të gjitha të gjeturat si më lartë, janë trajtuar në kapitujt përkatës të këtij raporti.

Në kuadër të degëve të GjTh në Prishtinë, vlen të përmendet fakti se Dega në Graçanicë me vetëm 1 gjykatës, trajton vetëm lëndët e natyrës civile. Sipas të dhënave të raportit statistikor të KGJK-së, vetëm gjatë vitit 2016, dega në Graçanicë kishte pranuar gjithsej 239 lëndë, kishte zgjidhur 223 të tilla me vetëm një gjykatës, derisa të pazgjidhura në fund kanë mbetur 666 lëndë.

1.2 Gjykata Themelore në Mitrovicë - struktura dhe organizimi gjykatës

Gjykata Themelore në Mitrovicë është njëra ndër 7 gjykatat themelore në Kosovë, e cila ka në juridiksion Jugun dhe Veriun e Mitrovicës, komunat Laposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Skënderaj dhe Vushtrri. Brenda këtij juridiksioni,

mbulohen gjithsej 328 fshatra.¹⁰ Gjykata Themelore e Mitrovicës, numëron degët e saj në Leposaviq, Skenderaj, Zubin Potok dhe Vushtri.¹¹

Regjioni i Mitrovicës tani numëron gjithsej 26 gjykatës (24 shqiptarë dhe 2 gjykatës serb) nga e cila statistikë GjTh në Mitrovicë ka gjithsej trembëdhjetë (13) gjykatës, dega në Skenderaj pesë (5) gjykatës ndërsa ajo në Vushtri gjashtë (6) të tillë.¹²

Bazuar në kategorizimin dhe standardin për numrin me gjykatës, për GTh në Mitrovicë janë të parapara gjithsej 46 pozita për gjykatës, derisa në vitin 2004, gjykata numëronte gjithsej 54 gjykatës. Marrë parasysh numrin e lëndëve në GjTh në Mitrovicë, edhe po të plotësoheshin 46 pozitat me gjykatës, as shifra e tillë nuk do të mjaftonte në mbulimin dhe procedimin e të gjitha rasteve më efikasitet.¹³

Sipas të dhënave të KGJK-së, në GjTh në Mitrovicë me degët në Vushtri dhe Skenderaj gjatë vitit 2016, kanë punuar gjithsej 24 gjykatës, e cila gjykatë me degët, në fund të vitit 2016 kishte pasur në punë gjithsej 44,237 lëndë të pazgjdhura. Bazuar po në këto statistika, një gjykatës në GjTh në Mitrovicë me degë është i ngarkuar me 1,843 lëndë.

BAZUAR NË MONITORIM, NDËR PROBLEMET KRYESORE TË IDENTIFIKUARA NË GJTH NË MITROVICË KANË QENË:

- Mungesa e hapësirave të gjykatës dhe mungesa e kushteve normale për gjykim;
- Numri i vogël me gjykatës;
- Problemet e qasjes në drejtësi për shkak të mos-funksionimit të gjyqësorit në komunat e veriut;
- Stërzgjatja e gjykimeve dhe shkelja e të drejtave në gjykim;
- Shkelja e afateve ligjore, dhe të tjerë¹⁴

10 <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/courts/page/index/198>.

11 Ibid.

12 Interviste me UD Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Ali Kutllovci, intervistuar me 3 nëntor 2016, Vushtri.

13 Shënim: Ud. i Kryetarit të Gjykatës Themelore, derisa përmend shifrën prej 54 gjykatësve sa numëronte kjo gjykatë me degë në vitin 2004, gjithashtu deklaroi se as 46 gjykatësit e paraparë për këtë regjion, nuk do të mjaftonin për të trajtuar numrin e madh të rasteve që kanë në procedim, intervistuar me 3 nëntor 2016, Vushtri.

Për periudhën një vjeçare, Çohu! dhe CSD kanë monitoruar 23 seanca gjyqësore në 20 raste. Gjatë monitorimit një vjeçar, (maj 2016 – maj 2017), në GjTh në Mitrovicë janë identifikuar probleme të vazhdueshme të cilat kanë penguar mbarëvajtjen e shqyrtimeve gjyqësore.

Gjykata Themelore e Mitrovicës vazhdon të mos jetë e shtrirë në të gjitha komunat në pjesën veriore që nga viti 2008. Së fundmi marrëveshjet për drejtësinë të nënshkuara në Bruksel të cilat kishin qëllim integrimin e veriut të Kosovës brenda sistemit të drejtësisë së Kosovës, kanë dështuar në zbatim dhe si pasojë, komunat e veriut si Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, vazhdojnë të mos jenë të integruara brenda sistemit juridik të Kosovës.

1.3 Gjykata Themelore në Gjilan- struktura dhe organizimi gjykatës

Gjykata Themelore në Gjilan mbulon territorin në komunat e Gjilanit, Kamenicës, Novobërdës, Ranillugut, Parteshit, Vitisë dhe Klllokotit, i cili territor përfshinë 167 fshatra e cila ka degët e gjykatës në Viti, Novobërde dhe Kamenicë.

Sipas të dhënave të KGJK-së, gjatë vitit 2016, GjTh në Gjilan me degët e saj, ka pasur në punë gjithsej 20,393 lëndë si lëndë të pazgjdhura në fund të vitit 2016 me 29 gjykatës.¹⁵

Krahasuar me gjykatat themelore në Prishtinë dhe Mitrovicë, GjTh në Gjilan qëndron më pak e ngarkuar me lëndët për një gjykatës. Sipas po këtyre të dhënave, një gjykatës në GjTh në Gjilan me degët e saj, ka në punë 703 lëndë. Mirëpo vlen të theksohet fakti se GjTh në Gjilan gjithashtu ka pranuar dyfish lëndë më shumë se sa lëndët e mbetura të pazgjdhura në fund të vitit 2016, gjithsej 46,797 lëndë gjatë vitit 2016, derisa gjithashtu ka zgjidhur më shumë lëndë sesa që kishte në punë dhe kishte pranuar gjatë vitit 2016, gjithsej 52,288.

Nga gjithsej 102 rastet me 214 seancat e monitoruara në të tri gjykatat, Organizata Çohu! dhe CSD në periudhën maj 2016 – maj 2017 kanë monitoruar gjithsej 18 raste me 26 seanca gjyqësore në GjTh në Gjilan.

14 Shënim: Të gjitha të gjeturat e sipërhënuara, trajtohen në pjesën e veçantë të këtij raporti për sistemin gjyqësor dhe prokurorial në Mitrovicë.

15 Raporti statistikor i gjykatave për vitin 2016; <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/report/list/1>

Monitorimi ka identifikuar shkelje të natyrës së njëjtë gjithashtu në GjTh në Gjilan, të cilat janë trajtuar në kapitujt e këtij raporti.

2. Të gjeturat e monitorimit

Bazuar në Marrëveshjen për Bashkëpunim të lidhur në prill 2016 ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe organizatave Çohu! dhe CSD, në maj të vitit 2016 organizata Çohu! dhe CSD kanë filluar monitorimin e gjykatave themelore në Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjilan.

Monitorimi i Çohu! dhe CSD është bërë në baza ditore, me ç'rast fokus i monitorimit kanë qenë rastet e korrupsionit dhe krimet të organizuar. Bazuar në të dhënat e monitorimit, për periudhën maj 2016 – maj 2017, Çohu! dhe CSD kanë monitoruar gjithsej 214 seanca gjyqësore në 102 raste. Gjatë monitorimit një vjeçar, organizata Çohu! dhe CSD, kanë identifikuar të gjeturat e natyrave të ndryshme, duke filluar nga ato me teknike siç janë mungesa e transparencës dhe vonesat në fillimin e shqyrtimeve gjyqësore, deri të shkeljet procedurale ligjore dhe shkeljet e të drejtave të njeriut.

Në regjionin e Mitrovicës, e cila gjithashtu përfshinë komunat në veriun e Kosovës¹⁶, përveç faktit të mosfunksionimit të gjyqësorit në atë pjesë për më shumë se 9 vjet, monitorimi gjithashtu ka identifikuar probleme të vazhdueshme të cilat pamundësojnë zhvillimin normal dhe mbarëvajtjen e procese gjyqësore.

Mungesa e transparencës në veçanti është e gjetur në GjTh në Prishtinë, me ç'rast seanca të rëndësisë publike në të cilat akuzohen funksionarë të lartë të cilët mbanin pozita të larta të rëndësisë publike, janë mbyllur për publikun dhe të interesuarit. E gjithë kjo kishte pamundësuar qasjen e publikut dhe të interesuarve në seancat e rëndësisë publike, siç janë rasti ndaj ish kryetarit të Gjykatës së Apelit, Salih Mekaj, rastin e njohur “Stentat” dhe të tjerë.

Vonesa në fillimin e shqyrtimeve gjyqësore si dhe shtyrja e tyre është identifikuar në të tri gjykatat e mbuluara me monitorim.

16 Shënim: Gjykata Themelore në Mitrovicë ka në juridiksion Jugun dhe Veriun e Mitrovicës, komunat Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Skenderaj dhe Vushtrri, brenda së cilës hapësirë, mbulohe gjithsej 328 fshatra.

BAZUAR NË MONITORIM, NDËR PROBLEMET KRYESORE TË IDENTIFIKUARA

- mungesa e transparencës
- vonesat në fillimin e shqyrtimeve gjyqësore
- shkeljet procedurale ligjore
- mosfunksionimi i gjyqësorit dhe prokurorisë në komunat e veriut të Kosovës
- shkeljet e të drejtave të njeriut
- mungesa e rasteve të profilit të lartë
- ndëshkimet e ulëta

Nga gjithsej 102 rastet e monitoruara me 214 seanca në tri gjykatat themelore (Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjilan) pothuajse në asnjërin prej rasteve nuk janë respektuar afatet ligjore të cilat kanë të bëjnë me caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimeve gjyqësore (fillestar, dytësor dhe atij kryesor) si dhe me afatet e përfundimit të tyre.

Edhe pse caktimi i një shqyrtimi fillestar përfshinte periudhën prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të rastit në gjykatë, sipas të dhënave të monitorimit një gjë e tillë nuk ishte bërë edhe deri në 3 vjet. Moscaktimi më kohë dhe mosmbajtja e shqyrtimeve gjyqësore brenda afateve të parapara, gjithashtu mosrespektimi i kohës brenda së cilës duhet përfunduar një shqyrtim kryesor, është shkelje e dispozitave procedurale ligjore, të parapara në Kodin e Procedurës Penale.

Monitorimi dhe analiza e rasteve të korrupsionit dhe krimet të organizuar, ka identifikuar gjithashtu numrin e madh të lëndëve në tri gjykatat themelore dhe gjithashtu, ngarkesën e gjykatësve me rastet e shumta. Vetëm në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila është gjykata me numrin më të madh të lëndëve, një gjykatës mesatarisht është i ngarkuar me 1,741 lëndë. Aspak më mirë nuk qëndrojnë gjykatat në Mitrovicë dhe Gjilan.

Mungesa e rasteve të profilit të lartë dhe ndëshkimi i ulët për rastet ekzistuese, është e gjetur tjetër në raportin e monitorimit e cila dëshmon për mungesën e efikasitetit të prokurorisë dhe gjykatës në ndjekjen dhe ndëshkimin e zyrtarëve të profilit të lartë, të kategorizuar edhe sipas Udhëzimit Administrativ për zyrtarët e profilit të lartë.

Si përfundim, mosfunksionimi i gjyqësorit në komunat e veriut të Kosovës për më shumë se 8 vjet, ka bërë që qytetarët mos

- Gjatë monitorimit të seancave gjyqësore, Organizata Çohu! dhe CSD kanë hasur në raste të rëndësishme publike të cilat janë mbyllur për publikun.

të kenë qasje në drejtësi duke rezultuar kështu me shkëlqen e parimeve bazë të drejtësisë lidhur me gjykimin e drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme, të paraparë me Kushtetutën e Kosovës, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Ligji për Gjykata si dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

2.1 Transparenca e gjyqësorit

Bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, shqyrtimi gjyqësor është i hapur për publikun dhe ka karakter publik. Neni 293 i Kodit të Procedurës Penale (KPPK-së) ka paraparë që shqyrtimi gjyqësor është i hapur,¹⁷ ndërsa ai 294, parasheh rastet kur përjashtohet publiku.

Sipas po të njëjtës dispozitë (neni 294 i KPPK-së), gjatë shqyrtimit gjyqësor, publiku ose ndonjë pjesë e tij mund të përjashtohen për shkaqe të ruajtjes së fshehtësisë zyrtare dhe informacionit të fshehtë, mbrojtjes së jetës personale ose familjare të të akuzuarit, të dëmtuarit ose të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, mbrojtjen e interesave të fëmijëve, mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve bashkëpunues dhe të tjerë.¹⁸

Gjithashtu Kushtetuta e Kosovës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e njeriut, kanë paraparë publicitetin e një gjykimi. Sipas nenit 31, paragrafi 3 i Kushtetutës së Kosovës, i cili parasheh të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, gjykimi është

17 Kodi i Procedurës Penale, neni 294; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>: Shqyrtimi gjyqësor është i hapur. 2. Në shqyrtim gjyqësor mund të marrin pjesë personat madhor. 3. Personat e pranishëm në shqyrtim gjyqësor nuk mund të mbajnë armë ose mjete të rrezikshme, me përjashtim të zyrtarëve të policisë që ruajnë të akuzuarin, të cilët mund të jenë të armatosur.

18 Kodi i Procedurës Penale, neni 294; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>: Nga fillimi deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues me propozimin e palëve ose sipas detyrës zyrtare, por gjithnjë pas dëgjimit të tyre, 175 mund të përjashtojë publikun gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ose nga një pjesë e tij, kur kjo është e nevojshme për: 1.1. ruajtjen e fshehtësisë zyrtare; 1.2. ruajtjen e informacionit të fshehtë i cili do të rrezikohet nga shqyrtimi i hapur; 1.3. ruajtjen e rendit dhe respektimit të ligjit; 1.4. mbrojtjen e jetës personale ose familjare të të akuzuarit, të dëmtuarit ose të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë; 1.5. mbrojtjen e interesave të fëmijëve; ose 1.6. mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve bashkëpunues ose dëshmitarëve, siç parashihet në Kapitullin XIII të këtij Kodi.

- Procesi ndaj ish kryetarit të Gjykatës së Apelit, Salih Mekaj i filluar me 20 tetor 2016, u mbyll për publikun me vendim të trupit gjykues pas kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit e me pajtim me prokurorin e çështjes.

publik në përjashtim të disa rasteve kur gjykata për të mirë të drejtësisë, konsideron se është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, të parapara edhe në ligj.¹⁹

Neni 40 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ka paraparë shprehimisht se seancat janë publike përveç rasteve kur gjykata në rrethana përjashtimore vendosë ndryshe.²⁰

Gjatë monitorimit të seancave gjyqësore, Organizata Çohu! dhe CSD kanë hasur në raste të rëndësishme publike të cilat janë mbyllur për publikun. Derisa dy rastet të cilat vazhdojnë të mbesin të mbyllura për publikun janë ai ndaj ish kryetarit të Gjykatës së Apelit Salih Mekaj dhe tjetri i njohur si rasti “Stentat” në të cilin janë të përfshirë ministër, sekretar ministrie, mjekë, biznesmen dhe zyrtarë tjerë të shumtë publikë, rasti i ri-hapur është rasti i njohur si “Toka”, në të cilin janë të përfshirë rreth 40 të akuzuar, ndër të cilët ish deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Azem Syla.

Procesi ndaj ish kryetarit të Gjykatës së Apelit, Salih Mekaj i filluar me 20 tetor 2016, u mbyll për publikun me vendim të trupit gjykues pas kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit e me pajtim me prokurorin e çështjes. Me kërkesën dhe vendimin e tillë, ishte pajtuar gjithashtu prokurori i çështjes.

Në arsyetimin e vendimit, thuhet se procesi mbyllet i tëri për shkaqe të mbrojtjes së jetës personale ose familjare të të akuzuarit, bazuar në dispozitat penale procedurale, përkatësisht neni 294 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4. Bazuar në arsyetimin e aktvendimit, gjykata konstaton përjashtimin e publikut

19 Kushtetuta e Kosovës, neni 31 paragrafi 3; <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>: Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medie, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

20 Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, neni 40 paragrafi 1: Seancat janë publike, përveç rasteve kur Gjykata në rrethana përjashtuese vendos ndryshe.

dhe medieve si dhe ndalon publikimin në mediat e shkruara dhe elektronike të aktakuzës apo një pjesë të saj, transkripteve të përgjimeve si dhe bisedat telefonike ndërmjet Salih Mekajt dhe të akuzuarës në rastin e njëjtë me arsyetimin se publikimi i të dhënave personale, do të dëmtonte të akuzuarit.²¹

KPPK ka paraparë mbylljen për shkaqet e tilla, ashtu si ka paraparë edhe mundësinë e mbylljes vetëm të një pjesë të shqyrtimit për shkaqet e njëjta. Në rastin konkret, edhe pse rasti i rëndësisë publike në të cilin akuzohet ish kryetari i Gjykatës së Apelit dhe i cili akuzohet për veprat e keqpërdorimit me detyrën, duke shtuar kështu rëndësinë e interesit publik për rastin, gjykata kishte vendosur ta mbyllë të tërin.

Rëndësia publike e rastit Mekaj qëndronte në faktin se ai akuzohet për dy vepra të keqpërdorimit të detyrës zyrtare për kohën kur ishte në pozitën kryetar i Gjykatës së Apelit.²²

Vendimi për mbyllje të procesit gjyqësor, duket absurd dhe arbitrar marrë parasysh rëndësinë publike të të gjithë procesit, arsyetimin e vonshëm të mbylljes së procesit si dhe faktin se një vendim i tillë, mbështetej nga prokuroria, (prokuroria dhe gjykata ishin pajtuar për mbylljen, pas kërkesës së mbrojtjes) derisa në të njëjtin vendim, parashihej e drejta e ankesës.

Rasti tjetër i mbyllur për publikun, është ai i njohur si rasti “Stentat”. Në rastin e tillë, janë të përfshirë 64 persona, në mesin e të cilëve janë akuzuar: një ministër, sekretar i ministrisë, 44 mjekë dhe një infermier të punësuar në institucionet publike shëndetësore, si dhe 13 persona që kanë punuar ose punojnë në institucionet private shëndetësore.²³

Organizata Çohu! dhe CSD vlerësojnë se përjashtimi i publikut në rastin “Stentat” ishte bërë duke mos respektuar dispozitat procedurale penale. Sipas gjykatës së rastit, përjashtimi i publikut në rastin e tillë, ishte bërë për shkaqe teknike, përkatësisht për shkak të mungesës së hapësirave të mjaftueshme në gjykatë, me ç’rast mediat ishin lejuar të qëndronin vetëm 2 minuta në fillim të seancës sa për të marrë pamjet për rastin.

21 Aktvendimi PKR.nr.338/16 i datës 20 tetor 2016, Departamenti I Krimëve të Rënda, GjTh në Prishtinë.

22 Shënim: Salih Mekaj ishte i suspenduar nga pozita e Kryetarit, i cili më pas vetëm pasi kishte filluar procesi gjyqësor, i kishte ofruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dorëheqjen e tij nga të gjitha funksionet e cila gjë, edhe ishte aprovuar në mbledhjen e KGJK-së.

23 Shënim: Më 15 qershor 2016, Prokuroria Speciale e Kosovës kishte ngritur aktakuzë kundër ish-ministrit të Shëndetësisë, Ferid Agani, Sekretarit të Përgjithshëm të MSh, Gani Shabani dhe 62 personave të tjerë, për veprat penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Marrje e rryshfeti”, “Dhënie e rryshfeti”, “Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor”, “Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe farmaceutike” dhe “Shmangia nga tatimi”.

● **Transparenca e gjykatave duhet të sigurohet edhe përmes hapjes së shqyrtimeve publike, në veçanti në rastet e rëndësisë publike, bazuar në dispozitat ligjore.**

Në seancën e mbajtur me 30 nëntor 2016, përjashtimi i publikut ishte bërë pa vendim siç përcaktohet në nenin 296 të KPPK-së, gjithashtu pa ndonjë shkak, shkaqe këto të përcaktuara edhe në nenin 294 të Kodit të Procedurës Penale.

Pra përjashtimi i publikut në rastin “Stentat”, nuk është përcjellur më respektimin e dispozitave procedurale penale. Mbyllja e rastit “Stentat” është bërë duke shkelur dispozitat procedurale penale si dhe në anën tjetër gjithashtu ka dëshmuar paafësinë e gjyqësorit për të siguruar hapësira të mjaftueshme për mbarëvajtjen e një procesi gjyqësor, të hapur, siç parashohin dispozitat ligjore dhe kushtetuese.

Rasti tjetër i njohur si rasti “Toka” në të cilin akuzohet ish deputeti Azem Syla dhe 38 persona të tjerë, fillimisht ishte mbyllur për medie, për t’u rihapur me 13 dhjetor 2016. Kryetari i trupit gjykues në rastin “Toka” i cili është nga EULEX, në fillim të po kësaj seance, ishte deklaruar se gjykimin e tillë e ka rihapur për media dhe publikun me arsyetimin se është i rëndësishëm për mediat dhe u intereson rezultati. Në rastin e tillë, Azem Syla bashkë me 38 persona të tjerë, në mesin e tyre shtetas të Serbisë, akuzohen për 46 pika të ndryshme të akuzës për keqpërdorime me prona në Kosovë, i cili vazhdon të procedohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Përkundër reagimit të Asociacionit të Pavarur të Gazetarëve, shoqërisë civile dhe ekspertëve të ndryshëm, në kundërshtim të mbylljes së seancave, rasti Mekaj dhe ai “Stentat” vazhdojnë të mbesin të mbyllura për publikun dhe mediat. Në anën tjetër kryetarja e GjTh në Prishtinë në komentet dhe përgjigjen e saj lidhur me të gjeturat e raportit, është deklaruar se GjTh në Prishtinë është transparente aq sa kërkon ligji. Sipas saj, rasti “Stentat” është i hapur për publikun.²⁴

Organizata Çohu! dhe CSD konsiderojnë se mbyllja e proceseve të rëndësishme gjyqësore në të cilat janë përfshirë ish zyrtarë të lartë me funksione të larta publike, dëshmon për arbitraritetin e gjyqësorit dhe bie në kundërshtim me dispozitat

24 Afërdita Bytyqi, Kryetare e GjTh në Prishtinë, 31 janar 2017, Prishtinë.



44 seanca
me vonesë

170 seanca me
kohë

tat ligjore dhe kushtetuese. Rastet e tilla me keqpërdorimin e pozitës dhe detyrës zyrtare, në të cilat janë keqpërdorur prona shoqërore dhe interesi publik, reflektojnë të rëndësishëm së veçante dhe në interes të publikut.

Pamundësia e pjesëmarrjes së publikut në seancat e tilla dhe mbyllja e seancave të tilla qoftë edhe për arsyt teknike, dëshmon në vazhdimësi mungesën e transparencës dhe llogaridhënies së gjykatësve për vendimet e tilla, e cila vazhdon t'i kontribuoj jo transparencës së gjykatave dhe mungesës së qasjes për publikun. Transparenca e gjykatave duhet të sigurohet edhe përmes hapjes së shqyrtimeve publike, në veçanti në rastet e rëndësishëm publike, bazuar në dispozitat ligjore.

Organizata Çohu! dhe CSD konsiderojnë se hapja e shqyrtimeve të tilla gjyqësore dhe transparencja e gjykatës dhe prokurorisë, kanë rëndësi publike dhe gjithashtu i kontribuojnë qasjes dhe informimit të publikut dhe transparencës së gjyqësorit, si dhe respektimit të dispozitave procedurale penale.

2.2 Vonesa në fillimin e shqyrtimeve dhe shtyrja

Bazuar në raportin statistikor të gjykatave për vitin 2016, përgatitur nga KGjK, gjendja e lëndëve të pazgjdhura në fund në të gjitha gjykatat (Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, Dhoma e posaçme si dhe gjykatat themelore) arrinë shifrën prej 399,091 lëndë. Po sipas këtij raporti, vetëm gjykatat themelore kishin të pazgjdhura 365,976 lëndë në fund të vitit 2016.²⁵

Zvarritja e seancave gjyqësore, vonesa e fillimit të tyre si dhe shtyrja e shqyrtimeve, është ndër shkaqet të cilat kanë

● Nga gjithsej 44 seancat e filluara me vonesë, në 25 të tilla arsye e fillimit me vonesë kishte qenë vonesa dhe mungesa e trupi gjykues, në 7 seanca vonesa e prokurorit ndërsa në 12 të tjera arsye e fillimit me vonesë ishte avokati dhe arsyt tjera deri të ato më teknike siç janë mungesa e sallave apo edhe vonesa e procesmbajtësve.

shtyrë në grumbullimin e lëndëve në gjykata. Gjatë monitorimit të proceseve gjyqësore, organizata Çohu! dhe CSD kanë identifikuar raste të fillimit me vonesë të shqyrtimeve si dhe raste të shtyrjes së tyre. Sipas të dhënave të monitorimit për periudhën maj 2016 – maj 2017, nga gjithsej 214 seancat e monitoruara në gjykatat themelore në Prishtinë, Gjilan dhe Mitrovicë, 44 të tilla kishin filluar me vonesë, derisa 170 seanca kanë filluar në kohën e paraparë.²⁶


Në tabelën si më poshtë, nr 1, janë pasqyruar të gjitha rastet sipas gjykatave të cilat kishin filluar me kohë dhe vonesë, në periudhën monitoruese maj 2016 – maj 2017:

Sipas të dhënave në tabelë, Gjykata Themelore në Prishtinë ka gjithsej 32 seanca të filluara me vonesë nga 165 seancat e monitoruara. Gjykata Themelore në Mitrovicë vijon me 8 seanca të filluara me vonesë nga gjithsej 23 të tilla të monitoruara si dhe Gjykata Themelore në Gjilan me 4 seanca të filluara me vonesë nga gjithsej 26 seancat e monitoruara.

²⁵ Raporti statistikor i gjykatave për vitin 2016, faqe 5; <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/report/list/1>.

²⁶ Shënim: Bazuar në monitorimin e rasteve, shumica e rasteve të monitoruara kanë filluar me vonesë deri në 15 minuta, mirëpo mar p arasysh arsyt teknike të fillimit me vonesë, në raport janë trajtuar vetëm rastet, vonesa e të cilave ka përfshi më shumë se 15 minuta, në të cilat janë specifikuar arsyt e fillimit me vonesë.

Trendi i fillimit me kohë apo me vonesë i shqyrtimeve të seancave në gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjiilan



Fillimi i seancave

Gjykatat	Me kohë	Me vonesë	Total
GjTh Prishtinë	133	32	165
GjTh Gjiilan	22	4	26
GjTh Mitrovicë	15	8	23
Total	170	44	214

TABELA NR. 1: Trendi i fillimit me kohë apo me vonesë i shqyrtimeve në gjykatat themelore në Prishtinë, Gjiilan dhe Mitrovicë për periudhën maj 2016 – maj 2017.

Arsyet e fillimit me vonesë të seancave




TABELA NR. 2: Trendi i i seancave të filluara me vonesë dhe arsyet e fillimit me vonesë në gjykatat themelore në Prishtinë, Gjilan dhe Mitrovicë për periudhën maj 2016 – maj 2017.

Të gjeturat nga monitorimi, identifikojnë se arsye kryesore e fillimit me vonesë të seancave gjyqësore ishin vonesa e vet trupit gjykues, vonesa e prokurorit dhe arsye të tjera deri të ato teknike të cilat kishin ndikuar në fillim me vonesë dhe shtyrjen e seancave gjyqësore. Arsyeja më e shpeshtë e fillimit me vonesë të seancave gjyqësore, ishte mungesa apo vonesa e trupit gjykues.

Në tabelën si më poshtë, janë pasqyruar të gjitha rastet dhe arsyet e fillimit me vonesë të seancave gjyqësore të monitoruara në periudhën maj 2016 – maj 2017 në gjykatat themelore në Prishtinë, Gjilan dhe Mitrovicë:

Nga gjithsej 44 seancat e filluara me vonesë, në 25 të tilla arsye e fillimit me vonesë kishte qenë vonesa dhe mungesa e trupit gjykues, në 7 seanca vonesa e prokurorit ndërsa në 12 të tjera arsye e fillimit me vonesë ishte avokati dhe arsyet tjera deri të ato më teknike siç janë mungesa e sallave apo edhe vonesa e procesmbajtësve.

Gjykata Themelore në Prishtinë e cila edhe ka numrin më të madh të seancave të monitoruara, gjithashtu të filluara me vonesë, dominon me gjithsej 32 seanca të filluara me vonesë nga gjithsej 44 të tilla, e pasuar nga GjTh në Mitrovicë me 8 seanca dhe GjTh në Gjilan me 4 seanca gjyqësore të filluara me vonesë.

Mungesa apo vonesa e trupit gjykues ishte arsyeja më e shpeshtë, me ç'rast nga 32 seancat në Prishtinë, në 21 të

tilla kishte munguar dhe ishte vonuar trupi gjykues.²⁷ Sipas të dhënave të monitorimit, në 5 seanca kishte munguar dhe ishte vonuar prokurori,²⁸ ndërsa 8 seancat tjera kishin filluar me vonesë për shkak të mungesës së avokatit²⁹ dhe shkaqeve të tjera, deri të ato teknike.³⁰

27 Shënim: Rasti P. nr. 58/14 i monitoruar me 16 maj 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë; Rasti P. nr. 58/14 i monitoruar me 19 maj 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë; Rasti PKR. 666/14 i monitoruar me 3 qershor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë; Rasti PKR. 666/14 i monitoruar me 11 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë; Rasti PKR. 625/15 i monitoruar me 22 qershor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë; Rasti nr. 362/16 i monitoruar me 6 shtator 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë; Rasti nr. 362/16 i monitoruar me 15 dhjetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë; Rasti PKR. 341/15 i monitoruar me 17 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë; Rasti PKR. Nr. 341/15 i monitoruar me 24 nëntor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë; Rasti PKR. Nr. 196/13 i monitoruar me 29 shtator 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë; Rasti Nr. PKR. Nr. 438/15 i monitoruar me 19 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë; Rasti PKR. Nr. 649/14 i monitoruar me 19 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Rasti PKR. nr. 327-14i monitoruar me 24 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

28 Shënim: Rasti P. Nr. 298/13i monitoruar me 11 maj 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë: Seanca e parapare të filloi në ora 13:30, kishte filluar me 25 minuta vonesë për shkak të mos prezencës së prokurorit; Rasti PKR 104-16, monitoruar me 30 maj 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë: Seanca e sotme ishte shpyrtim dytësorë, dhe u mbajt në sallën e gjyqësive, ajo filloi më 25 minuta vonesë për shkak të vonesës së prokurorës së rastit.

29 Shënim: Rasti PKR. Nr. 438-15 monitoruar me 13 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë: seanca e parapare të filloi në ora 13:15, filloi me vonesë prej 30 minutave për shkak të mungesës së mbrojtësit.

30 Shënim: Rasti P. Nr. 298/13, monitoruar me 27 korrik 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë: Seanca e parapare të filloi në ora 14:30, filloi me vonesë, përkatësisht në ora 15:05; Rasti P. Nr. 187/11, monitoruar me 17 maj 2016 në Gjykatën Themelore në Gjilan; Rasti PKR. nr. 201-14, monitoruar me 26 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë; Rasti PKR. nr. 201/14, monitoruar me 8 dhjetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Seanca filloi me vonesë prej 50 minutash, për shkak se nuk kishte sallë të lira për mbajtje të seancës; Rasti PKR. nr. 194/15, monitoruar me 31 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Gjilan; Rasti PKR. nr. 369/16, monitoruar me 21 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Seanca për këtë rast filloi me vonesë prej 45 minutash dhe përveç kësaj, ky proces nuk u zhvillua në sallat e parapara për gjykim, por ishte sallë e konferencave, për të cilën kishte vërejtje sepe nuk ishte e pajisur teknikisht, si zërim dhe të tjerë. Rasti P. nr. 135/16, monitoruar me 2 dhjetor 2016 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Seanca filloi 20 minuta me vonesë për shkak të mungesës së një procesmbajtësit.

Kryetarja e GjTh në Prishtinë potencon numrin e vogël të gjykatësve si arsye e vonesave dhe shtyrjes së shqyrtimeve gjyqësore. Sipas saj, numri i vogël me gjykatës, pamundëson kompletimin e trupit gjykues sipas ligjit.³¹

Gjykata Themelore në Gjilan e cila kishte vetëm 4 seanca të filluara me vonesë nga gjithsej 26 seancat e monitoruara me ç'rast në dy raste arsye e fillimit me vonesë ishin mungesa dhe vonesa e trupit gjykues,³² ndërsa në 2 rastet tjera, arsye e fillimit me vonesë ishin shkaqet tjera.³³

Ish Kryetari i GjTh në Gjilan i cili nuk mohon fillimin me vonesë dhe shtyrjen e shqyrtimeve gjyqësore, si shkak të fillimit me vonesë të shqyrtimeve gjyqësore dhe shtyrjes së tyre përmend numrin e madh të lëndëve më të cilat janë të ngarkuar gjykatësit.³⁴

Gjykata Themelore në Mitrovicë e cila vazhdon të jetë gjykata me më së shumti probleme marrë parasysh se ende janë të vendosura në objektet e Gjykatës në Vushtrri, ka gjithsej 8 seanca të filluara me vonesë nga gjithsej 23 seancat e monitoruara. Sipas të dhënave të monitorimit, në dy seanca arsye e fillimit me vonesë ishte mungesa dhe vonesa e trupit gjykues,³⁵ në dy raste ishte vonesa e prokurorit,³⁶ në një rast tjetër ishte vonesa e procesmbajtësit,³⁷ ndërsa në 4 raste të tjera ishin arsye të tjera. Bazuar në të dhënat e monitorimit, mungesa dhe vonesa e trupit gjykues ndër të tjera, kishte ardhur për shkak të problemeve me kompletimin e trupit gjykues. Pamundësia e kompletimit të trupit gjykues, kishte ardhur për shkak të angazhimeve të ndonjërit anëtar të trupit gjykues në raste të tjera në të njëjtën kohë kur ishte paraparë zhvillimi i se-

ancës³⁸ dhe gjithashtu, fakti i ndryshimit të trupit gjykues, zëvendësimit të anëtarëve të trupit gjykues.

Pamundësia e kompletimit të trupit gjykues dhe fillimi me vonesë e shtyrja e seancave gjyqësore për këto arsye, edhe njëherë dëshmon për numrin e vogël të gjykatësve, në veçanti në Departamentin e Krimeve të Rënda, në të cilin duhet gjykuar një trup gjykues të përbërë nga 3 gjykatës profesionist.

Ndryshimi i trupit gjykues me ç'rast ndonjëri nga anëtarët e trupit gjykues ishte zëvendësuar dhe kishte qenë i ri në përbërje,³⁹ kishte sjellë deri të nisja nga fillimi i gjithë shqyrtimit apo fillimi rishtas i shqyrtimit gjyqësor, gjë kjo e cila parashihet në dispozitat ligjore. Fillimi rishtas i shqyrtimit për shkak të zëvendësimit të anëtarëve të trupit gjykues, kishte bërë që procesi gjyqësor të prolongohet tutje, duke qar kështu në zvarritjen e proceseve gjyqësore.

Mungesa dhe vonesa e prokurorit gjithashtu ishte shkak i fillimit me vonesë të seancave gjyqësore, identifikuar nga monitorimi i organizatës Çohu! dhe CSD. Në të dyja rastet e identifikuar në GjTh në Prishtinë, prokurori nuk kishte arsyetuar mungesën.⁴⁰

31 Afërdita Bytyqi, Kryetare e GjTh në Prishtinë, 31 janar 2017, Prishtinë.

32 Shënim: Rasti PKR. 156/15, monitoruar me 16 qershor 2016 në Gjykatën Themelore në Gjilan: Seanca ishte shqyrtim kryesor dhe ishte parapare të filloi në ora 13:00, mirëpo filloi në 14:30 për shkak se Kryetari i Trupit Gjykues kishte probleme shëndetësore.

33 Shënim: Rasti P.nr 187/11, monitoruar me 17 maj 2016 në Gjykatën Themelore në Gjilan; Rasti : PKR. nr. 194/15, monitoruar me 31 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Gjilan.

34 Zyhdi Haziri, ish Kryetar i GjTh në Gjilan, 18 tetor 2016, Gjilan.

35 Shënim: Rasti nr. 128/15 monitoruar me 9 qershor 2016 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë: Seanca filloi me vonesë për shkak të vonesës së trupit gjykues; Rasti nr. 177/06 monitoruar me 14 qershor 2016 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë: Seanca filloi me vonesë për shkak të vonesës së trupit gjykues.

36 Shënim: Rasti P. Nr. 108/16, monitoruar me 26 shtator 2016 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë: Seanca ishte paraparë të fillonte në ora 10:00 por në mungesën e prokurorit i cili ishte i zënë me një seancë tjetër, filloi në ora 10:20; Rasti P. Nr. 210/16, monitoruar me 23 dhjetor 2016 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë: Seanca filloi me 30 minuta vonesë, kjo për shkak të mungesës së prokurorit, i cili siç thuhej ishte në një seancë tjetër.

37 Shënim: Rasti P. Nr. 135/16, monitoruar me 2 dhjetor 2016 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë: Seanca filloi 20 minuta me vonesë për shkak të mungesës së procesmbajtësit.

38 Rasti Nr. PKR. Nr. 438/15 i monitoruar me 19 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë: E parapare të filloi në ora 10:30, seanca filloi me vonesë në ora 11:25 minuta, për shkak se njëri nga anëtarët e Trupit Gjykues ishte në një gjykim tjetër në të njëjtën orar kur po mbahej kjo seancë; Rasti PKR. 341/15 i monitoruar me 17 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë: Seanca ishte parapare të filloi në ora 09:00, mirëpo filloi me 50 minuta vonesë për shkak se njëri nga anëtarët e Trupit Gjykues të përhershëm, ishte i angazhuar në një çështje tjetër penal me paraburgim. Trupi Gjykues kishte pësuar ndryshime në përbërje, me ç'rast u desh të zëvendësohej anëtar i trupit gjykues dhe për këtë arsye shqyrtimi filloi rishtazi;

Rasti PKR. Nr. 196/13 i monitoruar me 29 shtator 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë: Seanca ishte shqyrtim gjyqësor- kryesor, e cila filloi me vonesë prej 30 minutave. Trupit Gjykues kishte ndryshuar përbërjen e tij, për shkak se anëtar i trupit gjykues në po të njëjtën ditë ishte i angazhuar në Eulex, duke u zëvendësuar më pas nga gjykatësi tjetër; Rasti Nr. PKR. Nr. 438/15 i monitoruar me 19 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë: E parapare të filloi në ora 10:30, seanca filloi me vonesë në ora 11:25 minuta, për shkak se njëri nga anëtarët e Trupit Gjykues ishte në një gjykim tjetër në të njëjtën orar kur po mbahej kjo seancë; Rasti PKR. Nr. 649/14 i monitoruar me 19 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë: Seanca ishte shqyrtim gjyqësor, e cila filloi rreth një ore me vonesë, për shkak që njëri nga anëtarët e Trupit Gjykues ishte i angazhuar në të njëjtën kohë në një seancë tjetër.

Rasti PKR. nr. 327-14i monitoruar me 24 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë: E parapare të filloi në ora 09:30, seanca e shqyrtimit filloi me vonesë, në ora 10:55, për shkak se njëri anëtar i Trupit Gjykues ishte i angazhuar në një gjykim tjetër.

39 Shënim: Rasti PKR. 341/15 i monitoruar me 17 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë: Seanca ishte parapare të filloi në ora 09:00, mirëpo filloi me 50 minuta vonesë për shkak se njëri nga anëtarët e Trupit Gjykues të përhershëm, ishte i angazhuar në një çështje tjetër penal me paraburgim. Trupi Gjykues kishte pësuar ndryshime në përbërje dhe për këtë arsye shqyrtimi filloi rishtazi;

Rasti PKR. Nr. 341/15 i monitoruar me 24 nëntor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë: E paraparë të filloi në ora 09:00, seanca filloi me një orë vonesë. Trupi Gjykues kishte pësuar ndryshime në përbërje dhe për këtë arsye, shqyrtimi filloi rishtazi; Rasti nr. 362/16 i monitoruar me 6 shtator 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë: E paraparë të filloi në ora 13:30, seanca e sotme nisi me vonesë në ora 14:10, për shkak të mungesë se njërit prej anëtarëve të Trupit Gjykues dhe zëvendësimit të tij; Rasti PKR. Nr. 196/13 i monitoruar me 29 shtator 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë: Seanca ishte shqyrtim gjyqësor- kryesor, e cila filloi me vonesë prej 30 minutave. Trupit Gjykues kishte ndryshuar përbërjen e tij, për shkak se njëri anëtar ishte i angazhuar në Eulex dhe si zëvendësim në përbërjen e trupit gjykues ishte gjykatësi tjetër.

40 Shënim: Në rastin Rasti P. Nr. 298/13, monitoruar me 11 maj 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kishte ndodhur vonesa dhe shtyrja e shqyrtimit gjyqësor për shkak të mungesës së prokurorit, përkundër provimit dhe insistimit të kryetarit të trupit gjykues që të mari në telefon dhe të kuptojë për mundësinë e përfaqësimit në seance dhe gjithashtu të kuptojë shkaqet e mos-përfaqësimit të prokurorisë.

Ndërsa në dy rastet tjera në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, prokurori kishte qenë i zënë në shqyrtime të tjera në momentin e fillimit të seancës gjyqësore.⁴¹

Mungesa e prokurorëve në shqyrtimet gjyqësore dhe mos-arsyetimi i mungesës së tyre, vazhdon të dëmtojë mbarëvajtjen e gjykimit dhe dëshmon për pa-përgjegjësinë e prokurorisë karshi mbarëvajtjes së procesit.

Gjithashtu shqetësues mbetet fakti se në rastet e tilla të vonesës dhe mungesës, nuk është vërejtur te jetë ndërmarrë ndonjë masë nga vet kryetari i trupit gjykues/gjykatësi për të informuar dhe kërkuar nga kryeprokurori i prokurorisë përkatëse marrjen e masave ndaj prokurorëve të cilët nuk përfaqësojnë dhe nuk paralajmërojnë mungesën me arsyet. Organizata Çohu! dhe CSD nuk kanë identifikuar të jetë ndërmarrë ndonjë masë nga prokuroria ndaj prokurorëve të cilën nuk janë paraqitur në përfaqësim.

Shqyrtimet kishin filluar me vonesë edhe për shkak të mungesës së avokatëve dhe shkaqeve tjera, të cilat madje kishin pamundësuar fillimin me kohë dhe mbajtjen e shqyrtimit. Në kuadër të shkaqeve të tjera, futen gjithashtu mungesa e sallave për gjykim, vonesa dhe mungesa e procesmbajtësve dhe arsye të tjera.

Ndryshe nga kryetarët e gjykatave në Prishtinë dhe Gjilan, deklarohet UD i Kryetarit të GjTh në Mitrovicë. “Në suaza të kushteve dhe rrethanave në të cilat veprojmë, jemi shumë të kënaqur me punën dhe efikasitetin. Arsyet janë kushtet në të cilat punojnë gjykatësit, kushtet objektive” deklaroi ai.⁴²

Fillimi me kohë i shqyrtimeve gjyqësore, siç parashihet edhe me dispozitat ligjore, ka rëndësi në mbarëvajtjen e shqyrtimit dhe efikasitetin e gjykatave, e cila do t'i kontribuonte gjithashtu respektimit të dispozitave ligjore të cilat kanë të bëjnë me parimet e gjykimit të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme.

Vonesa e fillimit të seancave dhe shtyrja e tyre për shkak të vonesave dhe mungesave të gjykatësve dhe prokurorëve, avokatëve dhe arsyeve të tjera, vazhdon t'i kontribuojë zvarritjes së proceseve gjyqësore. Vonesa dhe shtyrja e seancave vazhdojnë të kenë pasojat në grumbullimin gjith-

● Nga gjithsej 102 rastet e monitoruara në 214 seanca gjyqësore për periudhën maj 2016 – maj 2017 në gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjilan, Çohu! dhe CSD kanë identifikuar shkelje të afateve procedurale pothuajse në të gjitha rastet, varësisht nga faza e procedimit (nga momenti i pranimit të rastit në gjykatë, caktimi dhe mbajtja e shqyrtimit fillestar, dytësor dhe atij kryesor, si dhe përfundimi dhe shpallja e aktgjykimit).

një më të madh të rasteve të pazgjidhura duke i kontribuar kështu mungesës së efikasitetit të gjykatave dhe shkeljes së dispozitave ligjore të cilat kanë të bëjnë me gjykimin e drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme.

2.3 Shkelja e afateve ligjore

Gjatë monitorimit të rasteve të korrupsionit, krimit të organizuar dhe veprës penale nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, Çohu! dhe CSD kanë identifikuar raste të shkeljes së dispozitave ligjore lidhur me afatet e procedimit të rasteve të tilla.

Me dispozitat e reja të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar të vitit 2013, nga momenti i pranimit të rastit në gjykatë, procedimi dhe shqyrtimi i rastit është kategorizuar në shqyrtimin e parë apo fillestar, atë dytësor kur gjykata konsideron të nevojshëm si dhe në shqyrtimin kryesor. Pra fazat e një shqyrtimi gjyqësor në gjykatë në shkallën e parë, përfshijnë veprimet nga pranimi i rastit në gjykatë, shqyrtimi fillestar, dytësor dhe ai kryesor, përfundimi i një shqyrtimi në shkallën e parë me shpalljen e aktgjykimit.

Çohu! dhe CSD kanë identifikuar shtyrje të afateve në caktimin dhe shqyrtimin e rasteve nga monitorimi i rasteve të korrupsionit, krimit të organizuar dhe veprës penale Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik.

41 Shënim: Rasti P. Nr. 108/16, monitoruar me 26 shtator 2016 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe rasti P. nr. 210/16, monitoruar me 23 dhjetor 2016 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë: Të dyja seancat kishin filluar me vonesë për shkak të mungesës së prokurorit të çështjes.

42 Ali Kutllovci, UD Kryetar i GjTh në Mitrovicë, tetor 2016, Mitrovicë.

- Sipas të dhënave të monitorimit, periudha kohore e moscaktimit të seancave gjyqësore, kishte shkuar deri në 672 ditë, edhe pse obligimi ligjor i gjykatës ka qenë që seancën caktojë jo më larg se 30 ditë nga pranimi i aktakuzës

- Shkelje të afateve lidhur me caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit dytësor kishte në të tri gjykatat e mbuluara me monitorim (GjTh në Prishtinë, GjTh në Mitrovicë dhe GjTh në Gjilan).

Nga gjithsej 102 rastet e monitoruara në 214 seanca gjyqësore për periudhën maj 2016 – maj 2017 në gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjilan, Çohu! dhe CSD kanë identifikuar shkelje të afateve procedurale pothuajse në të gjitha rastet, varësisht nga faza e procedimit (nga momenti i pranimit të rastit në gjykatë, caktimi dhe mbajtja e shqyrtimit fillestar, dytësor dhe atij kryesor, si dhe përfundimi dhe shpallja e aktgjykimit).

Pra, dispozitat e reja të Kodit të Procedurës Penale, të cilat kishin hyrë në fuqi në vitin 2013, kanë përcaktuar afatet kohore të caktimit të shqyrtimit fillestar nga momenti i pranimit të rastit në gjykatë,⁴³ afati për caktimin e shqyrtimit dytësor,⁴⁴ atij kryesor si dhe afatet e trajtimit të një shqyrtimi kryesor.⁴⁵

Në pamundësi të përfshirjes të të gjitha rasteve të shkeljeve, në raport janë inkorporuar nga tre (3) raste të shkeljeve me flagrante të afateve duke filluar nga pranimi i tyre në gjykatë dhe caktimi i shqyrtimit fillestar, atij dytësor dhe kryesor, si dhe përfundimin e shqyrtimit kryesor dhe shpalljen e aktgjykimit në rastet e tilla.

2.3.1 Shkelja e afateve në shqyrtimin fillestar

Edhe pse vetëm 30 ditë, përkatësisht 15 ditë afati i paraprirë për caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit fillestar nga momenti i pranimit të aktakuzës në gjykatë, monitorimi i Çohu! dhe CSD, kanë identifikuar rastet e shumta të mosrespektimit të afateve të tilla. Sipas të dhënave të monitorimit, periudha kohore e moscaktimit të seancave gjyqësore, kishte shkuar deri në 672 ditë, edhe pse obligimi ligjor i gjykatës ka qenë që seancën caktojë jo më larg se 30 ditë nga pranimi i aktakuzës. Gjykata me vonesë pothuajse prej 2 vjet apo saktësisht 672 ditësh ka bërë shkelje të rëndë të Kodit të Procedurës Penale përkatësisht nenit 242 të këtij ligji. E përpos KPPK-së gjykata i ka shkel edhe të drejtat elementare të njeriut të parapara me ligj, kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare, pasi gjykimi nuk është realizuar në kohë të arsyeshme.

Tre rastet me shkeljet më të rënda të afateve, janë identifikuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me ç'rast shkelja me flagrante përfshinë periudhën prej 672 ditëve nga momenti i pranimit në caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit.⁴⁶ Rasti dytë përfshinë periudhën prej 466 ditë,⁴⁷ ndërsa rasti i tretë atë prej 530 ditëve⁴⁸ nga momenti i pranimit të aktakuzës në gjykatë, deri në caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

43 Shënim: Pas ngritjes së aktakuzës nga prokuroria dhe dorëzimit të saj në gjykatë, fillon veprimi i gjykatës me ç'rast nga momenti i pranimit të saj në gjykatë, gjykata cakton mbajtjen e shqyrtimit fillestar e cila duhet të bëhet brenda periudhës 30 ditore. Këtu përjashtohen rastet kur i pandehuri është në paraburgim, në të cilat raste gjykata duhet të veprojë më shpejtë, përkatësisht në afatin prej 15 ditëve nga pranimi i rastit në gjykatë. Ndryshe, çdo vonesë pas periudhave të tilla në caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit fillestar, konsiderohet shkelje në dispozitave procedurale, përkatësisht nenit 242 të KPPK-së.

44 Shënim: Tutje gjykata pas shqyrtimit të parë mund të caktojë edhe shqyrtimin e dytë, mirëpo veprimin e tillë procedural, ligji ka lënë në kompetencë të gjykatës se si do të veprojë, pra ta caktojë dhe mbajë shqyrtimin e dytë apo jo. Mirëpo nëse shqyrtimi i dytë caktohet, ligji ka paraprirë afatin e saktë për caktimin, pra jo më herët se 30 ditë nga shqyrtimi i parë por jo më vonë se 40 ditë nga ai shqyrtim.

45 Shënim: Afatet janë paraprirë gjithashtu për shqyrtimin kryesor si dhe afatet për përfundimin e shqyrtimit të tillë. Derisa shqyrtimi kryesor është paraprirë të mbahet brenda një muaji nga shqyrtimi dytësor, një shqyrtim kryesor duhet të përfundojë brenda nëntëdhjetë (90) dite, përkatësisht njëqindnjëzetë (120) ditëve prej seancës së parë të shqyrtimit gjyqësor.

46 Shënim: Rasti PKR. nr. 198/15, monitoruar me 11 nëntor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Derisa rasti ishte pranuar në Gjykatë me 22 tetor 2013, shqyrtimi fillestar ishte caktuar dhe mbajtur me 25 gusht 2015, 672 ditë prej momentit të pranimit në gjykatë, duke mos u respektuar dispozitat procedurale siç përcakton paragrafi 4 i nenit 242 të Kodit të Procedurës Penale.

47 Rasti PKR. nr. 666/14, monitoruar me 3 qershor, 6 shtator, 11 tetor dhe 1,2 dhe 4 nëntor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Derisa rasti ishte pranuar në Gjykatë me 27 nëntor 2014, shqyrtimi fillestar ishte caktuar dhe mbajtur me 7 mars 2016, 466 ditë prej momentit të pranimit në gjykatë, duke mos u respektuar dispozitat procedurale prej 30 ditëve siç përcakton paragrafi 4 i nenit 242 të Kodit të Procedurës Penale.

48 Rasti PKR. nr. 327/14, monitoruar me 24 tetor dhe 6 dhjetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Derisa rasti ishte pranuar në Gjykatë me 12 qershor 2014, shqyrtimi fillestar ishte caktuar dhe mbajtur me 24 nëntor 2015, 530 ditë prej momentit të pranimit në gjykatë, duke mos u respektuar dispozitat procedurale prej 30 ditëve siç përcakton paragrafi 4 i nenit 242 të Kodit të Procedurës Penale.



Nga gjithsej 102 rastet me 214 seancat e monitoruara për periudhën maj 2016 – maj 2017 në gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjilan, 30 të tilla kanë përfunduar me aktgjykim në shkallën e parë, ndërsa 72 të tjera vazhdojnë të mbesin në procedim.



Shkelja e afateve të tilla, gjithashtu bie ndesh me parimet e drejtësisë sa i përket gjykimit të drejtë dhe brenda kohës të arsyeshme, të paraparë me dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kushtetutën e Kosovës si dispozitat procedurale të Kodit të Procedurës si dhe Ligjit për Gjykatat.

2.3.2 Shkelja e afateve në shqyrtimin dytësor

Gjatë monitorimit të Çohu! dhe CSD, janë identifikuar gjithashtu rastet kur shkeljet e Kodit kanë vazhduar edhe në caktimin e shqyrtimit dytësor, meqë është tejkuluar afati ligjor jo më herët se 30 ditë dhe jo më vonë se 40 ditë nga shqyrtimi fillestar.

Bazuar në të dhënat e monitorimit, shkelje të afateve lidhur me caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit dytësor kishte në të tri gjykatat e mbuluara me monitorim (GjTh në Prishtinë, GjTh në Mitrovicë dhe GjTh në Gjilan). Nga tri rastet e shkeljeve më të rënda me periudhën me të gjatë kohore, dy të tilla ishin në GjTh në Gjilan⁴⁹ dhe rasti tjetër në GjTh në Prishtinë.⁵⁰

Edhe te shqyrtimi dytësor, gjykata në çdo rast kur nuk cakton seancën sipas afateve ligjore të parapara në KPPK, bënë shkelje të rëndë të normave si dhe shkelje të të drejtave të njeriut meqë prapë nuk përmbushet parimi i drejtësisë që gjykimi duhet të realizohet në kohë të arsyeshme.

49 Shënim: Rasti PKR. nr. 156/15, monitoruar me 16 qershor 2016 në Gjykatën Themelore në Gjilan. Derisa shqyrtimi fillestar ishte mbajtur me 17 dhjetor 2015, shqyrtimi dytësor ishte mbajtur me 31 maj 2016, 166 ditë pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, duke mos u respektuar dispozitat procedurale prej me pak se 30 ditë dhe jo më shumë se 40 ditë nga shqyrtimi fillestar, siç përcakton paragrafi 5 i nenit 245 të Kodit të Procedurës Penale; Rasti PKR. nr. 70/15, monitoruar me 18 korrik 2016 në Gjykatën Themelore në Gjilan. Derisa shqyrtimi fillestar ishte mbajtur me 24 tetor 2015, shqyrtimi dytësor ishte caktuar dhe mbajtur me 22 shkurt 2016, 121 ditë pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, duke mos u respektuar dispozitat procedurale prej me pak se 30 ditë dhe jo më shumë se 40 ditë nga shqyrtimi fillestar, siç përcakton paragrafi 5 i nenit 245 të Kodit të Procedurës Penale.

50 Shënim: Rasti PKR. nr. 201/14, monitoruar me 26 tetor dhe 8 dhjetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Derisa shqyrtimi fillestar ishte mbajtur me 8 prill 2016, shqyrtimi dytësor ishte mbajtur me 5 shtator 2016, 150 ditë pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, duke mos u respektuar dispozitat procedurale prej me pak se 30 ditë dhe jo më shumë se 40 ditë nga shqyrtimi fillestar, siç përcakton paragrafi 5 i nenit 245 të Kodit të Procedurës Penale.

2.3.3 Shkelja e afateve në shqyrtimin kryesor

Pas përfundimit të shqyrtimit fillestar dhe atij dytësor nëse është caktuar, gjykata ka kohë 1 muaj që ta përgatis dhe mbajë shqyrtimin kryesor në çështjen penale.⁵¹

Monitorimi i Çohu! dhe CSD ka identifikuar raste të shkeljes së afatit të tillë në të tri gjykatat e mbuluara me monitorim (Prishtinë, Gjilan dhe Mitrovicë).

Sipas po këtyre të dhënave, ndër rastet në të cilat më së shumti kishte zgjatur distanca kohore dhe shkelja e afatit në caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit kryesor, është periudha prej 655 ditësh, edhe pse dispozitat kishin paraparë periudhën prej një muaji. Nga tri rastet me shkeljet me flagrante, dy të tilla ishin në GjTh në Prishtinë,⁵² ndërsa rasti tjetër në GjTh në Gjilan.⁵³

51 Kodi i Procedurës Penale të Kosovës; Sipas KPPK-së, neni 285 paragrafi 2 lidhur me nenin 254 paragrafi 5, gjykatësi i vetëm gjykesor ose kryetari i trupit gjykesor cakton fillimin e shqyrtimit gjyqësor brenda një (1) muaji nga shqyrtimi i dytë ose nga urdhri i fundit i lëshuar nga neni 254, paragrafi 5; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>.

52 Shënim: Rasti P. nr. 58/14, monitoruar me 16 dhe 19 maj 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Derisa shqyrtimi dytësor ishte mbajtur me 30 prill 2014, shqyrtimi kryesor ishte mbajtur me 26 janar 2016, 655 ditë pas mbajtjes së shqyrtimit dytësor, duke mos u respektuar dispozitat procedurale të cilat parashohin caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit kryesor brenda një muaji nga mbajtja e shqyrtimit dytësor, siç përcakton paragrafi 2 i nenit 285 lidhur me paragrafin 5 të nenit 254 të Kodit të Procedurës Penale; Rasti PKR. nr. 625/15, monitoruar me 22 korrik, 11 tetor dhe 23 dhjetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Derisa shqyrtimi dytësor ishte mbajtur me 28 janar 2016, shqyrtimi kryesor ishte mbajtur me 22 qershor 2016, 146 ditë pas mbajtjes së shqyrtimit dytësor, duke mos u respektuar dispozitat procedurale të cilat parashohin caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit kryesor brenda një muaji nga mbajtja e shqyrtimit dytësor, siç përcakton paragrafi 2 i nenit 285 lidhur me paragrafin 5 të nenit 254 të Kodit të Procedurës Penale.

53 Shënim: Rasti PKR. nr. 194/15, monitoruar me 31 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Gjilan. Derisa shqyrtim të dytë nuk kishte pasur dhe data e fundit e mbajtjes së shqyrtimit fillestar ishte me 24 shkurt 2016, shqyrtimi kryesor ishte mbajtur me 31 tetor 2016, 250 ditë pas mbajtjes së shqyrtimit paraparak në fazën fillestare, duke mos u respektuar dispozitat procedurale të cilat parashohin caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit kryesor brenda një muaji, siç përcakton paragrafi 2 i nenit 285 lidhur me paragrafin 5 të nenit 254 të Kodit të Procedurës Penale.

2.3.4 Shkelja e afateve lidhur me përfundimin e shqyrtimit kryesor

Me KPPK gjykatave tona u është dhënë gjithashtu afati kohor se sa duhet të zgjasë një shqyrtim pasi të fillojë shqyrtimi kryesor. Një gjë e tillë është bërë në mënyrë që shqyrtimi në përgjithësi dhe në fazat e caktuara në veçanti, të mos vazhdojë në pafundësi pa marrë një përfundim të merituar çështja e cila gjykohet si dhe të rezultojë me efikasitet në trajtimin e rasteve në gjykata. KPPK ka paraparë afatin prej 90 ditësh deri në 120 ditësh.⁵⁴

Nga gjithsej 102 rastet me 214 seancat e monitoruara për periudhën maj 2016 – maj 2017 në gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjiilan, 30 të tilla kanë përfunduar me aktgjykim në shkallën e parë, ndërsa 72 të tjera vazhdojnë të mbesin në procedim.

Në 30 rastet e përfunduara, në 11 nuk është respektuar afati 120 ditor i përfundimit të shqyrtimit gjyqësor. Bazuar në të dhënat e monitorimit të rasteve, ka pasur shkelje të afateve dhe kohëzgjatja e një shqyrtimi gjyqësor ka shkuar deri edhe në 342 ditë. Raste të tilla ka pasur në GjTh në Prishtinë⁵⁵ dhe GjTh në Gjiilan.⁵⁶

Arsye kryesore e shkeljes së afateve procedurale ligjore në shqyrtimet gjyqësore sipas vet kryetarëve të gjykatave në Prishtinë, Gjiilan dhe Mitrovicë, fillimisht është numri i madh më lëndët në gjykata dhe numri i vogël me gjykatësit për të proceduar me rastet sipas dispozitave procedurale.

Derisa kryetarja e GjTh në Prishtinë arsye kryesore përmend numrin e vogël me gjykatës,⁵⁷ ish kryetari i GjTh

në Gjiilan potencon numrin e madh të lëndëve në gjykatë.⁵⁸ Ndërsa në anën tjetër UD të kryetarit të GjTh në Mitrovicë, thekson se rrethanat e vështira të punës në të cilat punon kjo gjykatë dhe mungesa e hapësirave, janë shkaqet kryesore të cilat shtyjnë në shkeljen dhe mosrespektimin e afateve procedurale ligjore.⁵⁹

Si përfundim, organizatat Çohu! dhe CSD vlerësojnë se vendosja e afateve procedurale në fazat e ndryshme të një shqyrtimi gjyqësor dhe respektimi eventual i tyre, do të mundësonte efikasitet më të madh të gjykatave në procedimin e rasteve. Efikasiteti më i madh i procedimit të rasteve, automatikisht do të shpinte në mos-zvarritjen e rasteve dhe reduktimin e numrit të madh të rasteve në procedim.

Shkelja e afateve të tilla, gjithashtu bie ndesh me parimet e drejtësisë sa i përket gjykimit të drejtë dhe brenda kohës të arsyeshme, të paraparë me dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kushtetutën e Kosovës si dispozitat procedurale të Kodit të Procedurës si dhe Ligjit për Gjykatat.

Bazuar në të dhënat e monitorimit të Çohu! dhe CSD, pothuajse në të gjitha rastet e monitoruara, kishte shkelje dhe mos-respektim të afateve, varësisht nga faza e shqyrtimit gjyqësor (shqyrtimi fillestar, dytësor dhe ai kryesor si dhe përfundimi i një shqyrtimi kryesor). Sipas po këtyre të dhënave, zgjatja e një shqyrtimi të tillë, përfshinte periudhën nga 655 ditë, 530 ditë e tutje, edhe pse afati për veprimin procedural ishte 30 deri në 40 ditë.

Çohu! dhe CSD konsiderojnë se shkelja e afateve të tilla dhe mos-respektimi i tyre, është shkelje e dispozitave procedurale dhe vazhdon të ketë pasoja në tejzgjatjen e shqyrtimeve gjyqësore dhe grumbullimin e vazhdueshëm më lëndë. Njëkohësisht shkelja e tillë, është shkelje e parimeve të drejtësisë për një gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme.

KGJK ende nuk ka bërë ndonjë analizë apo përmbledhje për të kuptuar arsyet e vërteta të mos-respektimit të afateve procedurale duke mos ndërmarrë gjithashtu ndonjë masë ndaj përgjegjësve në rastet kur vërtetohet neglizhencë dhe papërgjegjësi.

54 Kodi i Procedurës Penale, neni 314 paragrafi 1.1 dhe 1.2: Një shqyrtim kryesor duhet të përfundojë brenda 90 dite, përkatësisht 120 ditëve prej seancës së parë të shqyrtimit gjyqësor; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>.

55 Shënim: Rasti PKR. nr. 649/14, monitoruar me 19 tetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Derisa shqyrtimi kryesor kishte filluar me 12 nëntor 2015, aktgjykimi ishte shpallë me 19 tetor 2016, 342 ditë pas fillimit të shqyrtimit kryesor, duke mos u respektuar dispozitat procedurale të cilat parashohin kohëzgjatjen e shqyrtimit kryesor prej 90 përkatësisht 120 ditësh, siç përcakton neni 314 paragrafi 1.1 dhe 1.2 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës;

Rasti PKR. nr. 625/15, monitoruar me 22 korrik, 11 tetor dhe 23 dhjetor 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Derisa shqyrtimi kryesor kishte filluar me 22 qershor 2016, aktgjykimi ishte shpallë me 23 dhjetor 2016, 184 ditë pas fillimit të shqyrtimit kryesor, duke mos u respektuar dispozitat procedurale të cilat parashohin kohëzgjatjen e shqyrtimit kryesor prej 90 përkatësisht 120 ditësh, siç përcakton neni 314 paragrafi 1.1 dhe 1.2 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës;

56 Shënim: Rasti PKR. nr. 186/15, monitoruar me 19 shtator 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Derisa shqyrtimi kryesor kishte filluar me 5 maj 2016, aktgjykimi ishte shpallë me 26 tetor 2016, 174 ditë pas fillimit të shqyrtimit kryesor, duke mos u respektuar dispozitat procedurale të cilat parashohin kohëzgjatjen e shqyrtimit kryesor prej 90 përkatësisht 120 ditësh, siç përcakton neni 314 paragrafi 1.1 dhe 1.2 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

57 Afërdita Bytyqi, Kryetare e GjTh në Prishtinë, 31 janar 2017, Prishtinë.

58 Zyhdë Haziri, ish Kryetar i GjTh në Gjiilan, 18 tetor 2016, Gjiilan.

59 Ali Kutllovci, UD Kryetar i GjTh në Mitrovicë, tetor 2016, Mitrovicë.



Çohu! rekomandon KGJK-në ndërmarrjen e masave për konstatimin e arsyeve të shkeljes së afateve procedurale ligjore përmes krijimit të mekanizmave dhe gjithashtu marrjen e masave ndaj përgjegjësve në rastet kur konstatohet shkelja e afateve të tilla për fajin dhe papërgjegjësinë e gjykatësve apo personelit tjetër.

3. Mungesa e procesit të rregullt gjyqësor dhe shkelja e të drejtave të njeriut - Mitrovicë

Procesi i rregullt gjyqësor dhe brenda kohës së arsyeshme, është paraparë me dispozitat ligjore ndërkombëtare dhe vendore.⁶⁰ Monitorimi i Çohu! dhe CSD, gjatë periudhës njëvjeçare në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, ndër parregullsitë e shumta, gjithashtu ka identifikuar shkeljen e dispozitave të cilat rregullojnë kohën dhe mbarëvajtjen e një procesi gjyqësor dhe të drejtat e palëve të përfshira në proceset e tilla.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, Gjykata Themelore e Mitrovicës, numëron degët e saj në Leposaviq, Skënderaj, Zubin Potok dhe Vushtri.⁶¹

Edhe pse kanë kaluar më shumë se 17 vjet nga përfundimi i luftës në Kosovë dhe 9 vjet nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, komunat në veriun e Kosovës, ende mbeten të paintegruara në sistemin e drejtësisë së Kosovës duke u pamundësuar kështu shtrirja e prokurorisë dhe gjykatave në gjithë territorin e komunave në regjionin e Mitrovicës.

Si pasojë e kësaj, qytetarëve të Kosovës, në veçanti atyre të regjionit të Mitrovicës, vazhdojnë t'u mohohen të drejtat themelore për qasje në drejtësi, gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme, të paraparë edhe me dispozitat ndërkombëtare, Kushtetutën e Kosovës dhe dispozitat tjera ligjore përkatëse të Kosovës.

- Edhe pse kanë kaluar më shumë se 17 vjet nga përfundimi i luftës në Kosovë dhe 9 vjet nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, komunat në veriun e Kosovës, ende mbeten të paintegruara në sistemin e drejtësisë së Kosovës duke u pamundësuar kështu shtrirja e prokurorisë dhe gjykatave në gjithë territorin e komunave në regjionin e Mitrovicës.

3.1 Historik i shkurtër

Me 1 shtator të vitit 1999, gjyqësori në Mitrovicë kishte filluar punën. Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës në muajin shkurt 2008, në regjionin e Mitrovicës, përkatësisht në veriun e Mitrovicës dhe komunat tjera si Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, regjion ky i banuar më shumicë serbe, kishin plasur tensionet me ç'rast ndër tjera, me 20 shkurt të po të njëjtit vit, ishin mbyllur gjykatat në komunat veriore të Kosovës.⁶²

Në vitin 2008, ish Gjykata Komunale dhe ajo e Qarkut e Mitrovicës (tani Gjykata Themelore e Mitrovicës), janë zhvendosur me lokacion në objektet e ish Gjykatës Komunale të Vushtrrisë. Në të njëjtin lokacion, ishte bartur gjithashtu Prokuroria e Qarkut dhe ajo Komunale e Mitrovicës (tani Prokuroria Themelore).

Si pasojë e ngjarjeve të muajit shkurt 2008, gjykatësit dhe prokurorët lokal shqiptar dhe stafi tjetër ndihmës, nuk kanë pasur qasje në veriun e Mitrovicës, ku ndodheshin prokuroria dhe gjykata.⁶³ Kjo kishte pamundësuar qasjen e qytetarëve në drejtësi dhe zhvillimin e proceseve gjyqësore duke pamundësuar gjithashtu funksionimin e sistemit gjyqësor dhe prokuroria për pjesën e tillë.

Në muajin dhjetor të vitit 2008, në gjykatën në veriun e Mitrovicës, ishin vendosur personeli i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), me ç'rast ndërtesa e gjykatës e cila ndodhet në pjesën veriore të Mitrovicës, është menaxhuar nga EULEX, i cili tani përbëhet nga personeli vendor (shqiptarë dhe serbë të Kosovës) dhe personelit ndihmës ndërkombëtar.⁶⁴ Në objektin e kësaj ndërtesë të gjykatës, vazhdon të qëndrojë EULEX.

60 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kushtetuta e Kosovës, Kodi i Procedurës Penale dhe dokumentet tjera ligjore.

61 <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/courts/page/index/198>.

62 Shënim: Gjykatat në veriun e Mitrovicës, Zveçan dhe Zubin Potok.

63 Rapori i OSBE-së lidhur me sistemin gjyqësor në Mitrovicë, janar 2011.

64 Raporti me rekomandime i Avokatit të Popullit të Kosovës, gusht 2016.

Përveç pamundësisë së trajtimit të rasteve për pjesën veriore të Kosovës për më shumë se 5 vjet (Veriun e Mitrovicës, Leposaviq, Zvečan, Zubin Potok), Prokuroria Themelore dhe Gjykata Themelore e Mitrovicës, në vazhdimësi janë përballur më sfida të ndryshme të cilat kanë pamundësuar funksionimin normal të prokurorisë dhe gjykatës, edhe pas ri-organizimit të gjyqësorit në vitin 2013.

Sipas Raportit të Avokatit të Popullit, i protokolluar në gusht të vitit 2016, vetëm në ndërtesën e gjykatës në veri të Mitrovicës, kishin mbetur të patrajtuara dhe pa-proceduara 1,700 lëndë të natyrës penale dhe 1,500 të tilla të natyrës civile.⁶⁵

Derisa gjatë vitit 2015 dega në Vushtri e GjTh të Mitrovicës është vendosur në një objekt të ri, GjTh e Mitrovicës vazhdon punën e saj në kushte të vështira në objektin e ish Gjykatës Komunale në Vushtri në të cilin objekt, ndodhet edhe PTh e Mitrovicës.

3.2 Vështirësitë

Gjatë monitorimit 1 vjeçar (maj 2016 – maj 2017), janë identifikuar probleme të vazhdueshme të cilat kanë penguar mbarëvajtjen e shqyrtimeve gjyqësore në GjTh në Mitrovicë.

Mungesa e kushteve normale për gjykim dhe mungesa e hapësirave në gjykatë, ishin problemet kryesore të cilat kanë shoqëruar dhe vazhdojnë të shoqërojnë GjTh në Mitrovicë.

Gjithashtu numri i madh i lëndëve dhe mungesa e numrit të mjaftueshëm me gjykatës dhe prokuror për të mbuluar të gjitha rastet, kishin rezultuar me vështirësitë e trajtimit të tyre (rasteve) brenda afateve ligjore.

Shkaqet e njëjta dhe mos trajtimi i lëndëve për më shumë se pesë vjet (2008 – 2013), kishte bërë që një numër i madh i lëndëve në GjTh në Mitrovicë, të arrijnë afatin e parashkrimit.

Marrëveshja e Brukselit për drejtësinë, e lidhur ndërmjet palës kosovare dhe asaj serbe, kishte për qëllim integrimin e veriut të Kosovës brenda sistemit prokurorial

● Mungesa e kushteve normale për gjykim dhe mungesa e hapësirave në gjykatë, ishin problemet kryesore të cilat kanë shoqëruar dhe vazhdojnë të shoqërojnë GjTh në Mitrovicë.

● Mos trajtimi i lëndëve për më shumë se pesë vjet (2008 – 2013), kishte bërë që një numër i madh i lëndëve në GjTh në Mitrovicë, të arrijnë afatin e parashkrimit.

dhe atij gjyqësor të Kosovës.⁶⁶ Në marrëveshjen e tillë, përveç tjerash ishte paraparë organizimi i prokurorisë dhe gjykatave për regjionin e Mitrovicës, rekrutimi i prokurorëve dhe gjykatësve të nevojshëm shqiptarë dhe serbë si dhe themelimi i njësisë së Gjykatës së Apelit në Mitrovicë, të përbërë nga gjykatës serbë dhe shqiptarë të Kosovës.

Edhe pse në aspektin politik, marrëveshja në fillim vlerësohej si një e arritur sa i përket mundësisë së shtrirjes së drejtësisë edhe në veriun e Kosovës dhe integrimin e veriut brenda sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial, në anën tjetër në aspektin praktik, një gjë e tillë gjithnjë e më shumë gjente vështirësi në zbatimin e saj. Gjithashtu vet akterë të sistemit të drejtësisë, gjyqësorit, ishin pesimist lidhur me këtë.⁶⁷

Ndër defektet kryesore të marrëveshjes sipas vet bartësve të sistemit gjyqësor, janë mënyra e rekrutimit të kryetarit të gjykatës, shpërndarja nëpër objekte të ndryshme, ndarja e departamenteve penal dhe civil në dy objekte të veçanta si dhe problemet me funksionimin normal të gjyqësorit.⁶⁸

66 Marrëveshja për Drejtësi e lidhur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, 9 shkurt 2015, Bruksel.

67 Shënim: Ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë Ali Kutllovci, deklaroi për defektet e kësaj marrëveshje dhe pamundësinë e zbatimit të sajë. Një marrëveshje e tillë sipas tij, në bazë të së cilës edhe duhej të bëhej bartja e prokurorisë dhe gjykatës në objektet e shpërndara në veri dhe jug të Mitrovicës, e paraparë së fundmi të ndodhë me 1 tetor 2016, përveçse e përealizueshme sa i përket bartjes dhe funksionalizimit, marrëveshja gjithashtu rrezikon të ketë probleme dhe mos-zbatim në të ardhmen; intervistuar me 3 nëntor 2016, Vushtri.

68 Interviste me UD Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Ali Kutllovci, intervistuar me 3 nëntor 2016, Vushtri.

65 Ibid.

3.3 Mungesa e qasjes në drejtësi dhe shkelja e të drejtave në gjykim

Degët e GjTh të Mitrovicës në Leposaviq dhe Zubin Potok, ende vazhdojnë të mos jenë funksionale dhe as brenda juridiksionit të Kosovës.

Qasja në drejtësi, e drejta për një gjykim të rregullt dhe brenda një kohe të arsyeshme si dhe afatet procedurale të hetimit dhe procedimit të rastit në prokurori dhe gjykata, janë paraparë me Kushtetutën e Kosovës,⁶⁹ Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut,⁷⁰ Ligjin për Gjykata si dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

Mbyllja e degëve në Leposaviq dhe Zubin Potok, zhvendosja në objektin e Gjykatës në Vushtrri si dhe pamundësia për të proceduar me rastet në gjykatë për 5 vjet, ka rezultuar me shkeljen e të drejtës për qasje në drejtësi, shkeljen e dispozitave dhe parimeve për një proces të rregullt gjyqësor dhe brenda kohës së arsyeshme si dhe shkeljen e afateve ligjore. E gjithë kjo për pasojë kishte ngrirjen e lëndëve ekzistuese dhe mos-procedimin e tyre, grumbullimin e lëndëve, mungesën e efikasitetit si dhe arritjen e afateve të parashkrimit.⁷¹

Marrë parasysh vështirësitë dhe problemet e tilla, GjTh në Mitrovicë kishte vendosur disa objektiva për të proceduar më me efikasitet trajtimin e rasteve, gjithashtu për të mbuluar komunat veriore në të cilat kishte munguar shtrirja e gjyqësorit. Ndër objektivat kryesore ishin ndarja dhe kategorizimi i lëndëve të mbetura, ekzekutimi i urdhëresave për komunat veriore nga ana e policisë si dhe kategorizimi dhe kryerja e lëndëve kundërvajtëse.⁷²

● Degët e GjTh të Mitrovicës në Leposaviq dhe Zubin Potok, ende vazhdojnë të mos jenë funksionale dhe as brenda juridiksionit të Kosovës.

Vendosja e objektivave dhe adresimi i tyre sipas përgjegjësisë për institucionet relevante, kishte filluar ta lëvizte gjykatën drejtë efikasitetit.⁷³

GTh në Mitrovicë gjithashtu është ballafaquar me numrin e madh të lëndëve kundërvajtëse. Angazhimi i praktikantëve dhe stafit mbështetës në kategorizimin e lëndëve kundërvajtëse nën mbikëqyrjen e gjykatësve kundërvajtës, kishte zvogëluar numrin e lëndëve kundërvajtëse për 30 mijë lëndë nga 48 mijë sa ishin gjithsej.⁷⁴

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID, në kuadër të programit për sundimin e ligjit, gjatë vitit 2016 kishte filluar inventarizimin, bartjen dhe ndihmën në kategorizimin e lëndëve të cilat kishin mbetur në sirtarët e gjykatave në veriun e Mitrovicës, në Zubin Potok dhe Leposaviq.⁷⁵

Në kuadër të këtij programi, USAID me ndihmën e zyrtarëve të Gjykatës Themelore në Prishtinë, kishte bërë inventarizimin e lëndëve në gjykatën në veri të Mitrovicës, si dhe gjykatat në Zubin Potok dhe Leposaviq dhe më pas, bartjen e tyre.

Në të tri gjykatat, atë në veri të Mitrovicës, në Zubin Potok dhe Leposaviq, janë inventarizuar gjithsej 5,012 lëndë prej të cilave, 1,666 lëndë janë penale, 1,538 civile dhe 1,808 lëndë kundërvajtëse.⁷⁶

69 Shënim: Derisa sipas nenit 102.2 të Kushtetutës së Kosovës sigurohet qasja e barabartë e qytetarëve në gjykata, neni 7 i Ligjit për Gjykatat ndër të tjera përcakton të drejtën e çdo personi që t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tyre.

70 Shënim: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në nenin 6 shprehimisht ka paraparë të drejtën e çdo individi për të pasur një proces të rregullt gjyqësor dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është paraparë edhe me nenin 32 të Kushtetutës së Kosovës.

71 Shënim: sipas të dhënave të USAID, nga gjithsej lëndët e kategorizuara deri në dhjetor 2016, 1,300 të tilla janë parashkruar (nga të tre gjykatat, Mitrovicë-Veri, Zubin Potok dhe Leposaviq).

72 Interviste me UD Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Ali Kutllovci, intervistuar me 3 nëntor 2016, Vushtrri.

73 Shënim: Sipas intervistës me UD të Kryetarit të GjTh në Mitrovicë, Ali Kutllovci, sa i përket lëndëve të mbetura të cilat ishin rreth 900 të tilla vetëm në Departamentin e Krimeve të Rënda, z. Kutllovci deklaroi të jenë ndarë dhe proceduar me efikasitet. Ndërsa për problemin e mos-ekzekutimit të urdhëresave të gjykatës nga ana e Policisë për gjithë territorin (në veçanti për pjesën veriore), pas takimit me përfaqësues të Policisë, evidentimit të përgjegjësisë për zyrtarët përgjegjës policor edhe në shkresa si dhe thellimit të bashkëpunimit, problemi i tillë ishte evituar në masë duke u respektuar kështu zbatimin i urdhëresave.

74 Interviste me UD Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Ali Kutllovci, intervistuar me 3 nëntor 2016, Vushtrri.

75 Interviste me Pranvera Recica – Kirkbride, zv/Drejtoreshë e USAID, zyra në Prishtinë, intervistuar në dhjetor 2016.

76 Shënim: Sipas përfaqësuesve të USAID, nga Gjykata hemelore në Mitrovicë (pjesa veriore) janë bartur gjithsej 2,331 lëndë, nga gjykata në Leposaviq 655 lëndë, ndërsa nga ajo në Zubin Potok 2,026 lëndë.



Në të tri gjykatat, atë në veri të Mitrovicës, në Zubin Potok dhe Leposaviq, janë inventarizuar gjithsej

5,012 Lëndë prej të cilave, 1,666 lëndë janë penale, 1,538 civile dhe 1,808 lëndë kundërvajtëse.

Gjatë vitit 2016, nga përfaqësues të USAID ishin bartur rreth 1,200 lëndë nga GjTh në Mitrovicë (veri) në objektin në Vushtri (Gjykata Themelore e Mitrovicës), lëndë këto të mbetura me vite pa u procedu

Lëndët e bartura nga Leposaviqi dhe Zubin Potoku, janë kategorizuar nga stafi i gjykatës dhe janë vendosur me vendim nga gjykatësit e GjTh në Mitrovicë , të vendosur në Vushtri, të cilat më pas, janë kthyer si të tilla në Zubin Potok dhe Leposaviq.

Nga gjithsej lëndët e kategorizuara deri në dhjetor 2016, 1,300 lëndë të tilla janë parashkruar (nga të tri gjykatat, Mitrovicë-Veri, Zubin Potok dhe Leposaviq), mbi 900 të lëndë janë mbyllur me vendim ndërsa të tjera janë në proces.⁷⁷ Të gjitha lëndët e tilla, i përkasin periudhës së para vitit 2008.

Organizata Çohu! dhe CSD fillimisht konsiderojnë se fillimi i trajtimit të rasteve nga GjTh në Mitrovicë pas 5 vjetësh dhe asistimi i USAID në bartjen dhe kategorizimin e lëndëve të pjesës veriore të Mitrovicës, regjionet e Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, ka bërë që proceset e shumta ndaj qytetarëve, të marrin epilogun, duke evituar të paktën shkeljen e vazhdueshme të të drejtave të qytetarëve.

- Nga gjithsej lëndët e kategorizuara deri në dhjetor 2016, 1,300 lëndë të tilla janë parashkruar (nga të tri gjykatat, Mitrovicë-Veri, Zubin Potok dhe Leposaviq), mbi 900 të lëndë janë mbyllur me vendim ndërsa të tjera janë në proces. Të gjitha lëndët e tilla, i përkasin periudhës së para vitit 2008.
- Për vite të tëra, qytetarë të shumtë kishin qenë të përfshirë në proceset hetimore dhe gjyqësore, mirëpo në pamundësi për të gëzuar të drejtat për një proces të drejtë gjyqësor, të paanshëm dhe brenda afateve të arsyeshme kohore.

⁷⁷ Interviste me Pranvera Recica – Kirkbride, zv/Drejtoreshë e USAID, zyra në Prishtinë, intervistuar në dhjetor 2016.



Gjykata Themelore në Mitrovicë ka zgjidhur gjithsej

601 lëndë, nga gjithsej 2,841 rastet e zgjidhura për vitin 2016



GjTh në Gjilan me

470 lëndë



GjTh në Pejë

391 lëndë

Bartja e lëndëve dhe epilogu i tyre, kishte mundësuar që shumë persona të përfshirë në proceset e tilla dhe të cilët figuronin në evidencat penale, të hiqen nga evidencat dhe të gëzojnë të drejtat e barabarta.⁷⁸

Për vite të tëra, qytetarë të shumtë kishin qenë të përfshirë në proceset hetimore dhe gjyqësore, mirëpo në pamundësi për të gëzuar të drejtat për një proces të drejtë gjyqësor, të paanshëm dhe brenda afateve të arsyeshme kohore.

Organizata Çohu! dhe CSD konstatojnë se pamundësia e zhvillimit të procesit të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të arsyeshme, shkelja e afateve hetimore dhe ato procedurale për procedimin dhe përfundimin e shqyrtimeve gjyqësore, është shkelje e të drejtave të njeriut, e paraparë me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, dispozitat kushtetuese për gjykimin e drejtë dhe të arsyeshëm, Ligjin për Gjykatat si dhe dispozitat procedurale penale.

Çohu! dhe CSD konsiderojnë se përkundër lëvizjes në drejtim të funksionimit dhe trajtimit të rasteve të tilla për regjionin e Mitrovicës (veriu i Mitrovicës, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan), komunat veriore vazhdojnë të kenë probleme serioze në funksionim. Edhe pse në fillim ishte paraparë si hap drejt normalizimit dhe funksionimit të

prokurorisë dhe gjykatave për gjithë regjionin e Mitrovicës (përfshirë regjionin verior), marrëveshja e Brukselit për Drejtësinë, vazhdon të jetë jo-funksionale, e pazbatueshme dhe sipas vet akterëve të drejtësisë në Mitrovicë, pa shpresë për fillimin dhe funksionimin e zbatimit.

3.4 Trajtimi i rasteve dhe krahasimi me gjykatat tjera

Edhe pse në kushte të vështira me hapësirat, numrin e pamjaftueshëm më gjykatës dhe vështirësitë tjera objektive, GjTh në Mitrovicë nuk qëndron larg gjykatave të tjera themelore me numrin e lëndëve të zgjidhura. Gjithashtu PTh në Mitrovicë, mbetet efikase si prokuroritë tjera themelore.

Gjatë vitit 2016, Gjykata Themelore në Mitrovicë, pas Gjykatës Themelore në Prishtinë e cila ka zgjidhur gjithsej 691 raste gjatë periudhës 1 vjeçare, prinë dukshëm krahasuar me gjykatat tjera për nga numri i lëndëve të zgjidhura. Nga gjithsej 2,841 rastet e zgjidhura për vitin 2016, Gjykata Themelore në Mitrovicë ka zgjidhur gjithsej 601 lëndë, e pasuar me GjTh në Gjilan me 470 lëndë, GjTh në Pejë me 391 lëndë të tilla dhe të tjerë. Të gjitha janë pasqyruar si në tabelën më poshtë. Tabela nr. 3: Trendi i procedimit të rasteve në Departamentet e Krimeve të Rënda në gjykatat themelore gjatë vitit 2015.

⁷⁸ Interviste me UD Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Ali Kutllovci, intervistuar me 3 nëntor 2016, Vushtrri.

Nëse analizohet procedimi i rasteve nëpër për vitin 2016, vërehet se regjioni i Mitrovicës përkundër problemeve të mëdha, vazhdon të procedojë me efikasiteti më të mirë se regjionet tjera.⁷⁹

Mirëpo, marrë parasysh mënyrën e zgjidhjes së rasteve të tilla, atëherë shqetësues mbetet numri i madh i rasteve të futura si të zgjidhura në kategorinë e lëndëve të zgjidhura në mënyrë tjetër. Nga gjithsej 601 rastet e zgjidhura nga DKR në Mitrovicë gjatë vitit 2016, 419 raste të tilla janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

Në kategorinë “të zgjidhura në mënyrë tjetër”, sipas vet UD të kryetarit të GjTh në Mitrovicë futen rastet të cilat kanë kaluar në kompetencë nga DKR në DP siç janë rastet armëmbajtje pa leje, rastet e kthyer nga Gjykata Supreme dhe të cilat kanë rënë në kompetencë nga DKR në DP, për të cilat nuk kishte rubrikë të veçantë në databazën statistikore të KGjK-së. Në po këtë kategori ishin futur gjithashtu rastet e hedhje poshtë të aktakuzës, pas shqyrtimit fillestar.

Bazuar në po këto të dhëna statistikore, gjatë vitit 2016 DKR i GjTh në Mitrovicë, kishte vendosur për 74 raste dënim me burg, 15 raste me aktgjykim lirues dhe 79 raste aktgjykim refuzues, derisa 6 raste kishte ndëshkuar me kusht, 4 me gjobë dhe për 4 raste të tjera ishin parashkuar lëndët.
























Çohu! dhe CSD konsiderojnë se mostrajtimi i lëndëve për një kohë të gjatë në GjTh në Mitrovicë dhe grumbullimi i tyre, puna në kushte të vështira dhe ndryshimet ligjore, kanë krijuar vështirësi në trajtimin me efikasitet të lëndëve dhe gjithashtu zgjidhjen e lëndëve në mënyrë tjetër.










































Organizata Çohu! dhe CSD vlerësojnë se KGjK duhet unifikuar mënyrën e tillë të zgjidhjes në të gjitha gjykatat si dhe duhet kategorizuar në databazën statistikore të gjitha rubrikat të cilat përfshijnë mënyrat e zgjidhjes. Një gjë e tillë do të mundësonte pasqyrimin e plotë të rasteve të zgjidhura dhe menaxhimin me të lehtë dhe më profesional të të dhënave të zgjidhura në të gjitha gjykatat.

● Organizata Çohu! dhe CSD konstatojnë se pamundësia e zhvillimit të procesit të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të arsyeshme, shkelja e afateve hetimore dhe ato procedurale për procedimin dhe përfundimin e shqyrtimeve gjyqësore, është shkelje e të drejtave të njeriut, e paraparë me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, dispozitat kushtetuese për gjykimin e drejtë dhe të arsyeshëm, Ligjin për Gjykatat si dhe dispozitat procedurale penale.

79 Shënim: Departamenti i Krimeve të Rënda në gjykatat themelore kishin trashëguar gjithsej 5,593 lëndë nga viti 2015, derisa kishin pranuar 2,144 të tilla të cilat gjithsej në punë arrijnë shifrën 7,737 raste për vitin 2016. Nga gjithsej 7,737 rastet në punë, gjykatat kishin zgjidhur 2,841 të tilla ndërsa kishin bartur në kompetencë 56 lëndë, duke mbetur kështu të pazgjidhura në fund, me 31 dhjetor 2016, gjithsej 4,840 lëndë.

Gjendja me lëndët në gjykatat themelore gjatë vitit 2016/DKR

Procedimi me lëndët nëpërgjykatat themelore gjatë vitit 2016 në Departamentin e Krimeve të Rënda	TRASHËGUARA	TË PRANUARA GJATË 2015
Gjykata Themelore në Prishtinë	2,170     	782  
Gjykata Themelore në Gjiilan	524 	326  
Gjykata Themelore në Prizren	253 	239 
Gjykata Themelore në Mitrovicë	1,843    	151 
Gjykata Themelore në Gjakovë	257 	169 
Gjykata Themelore në Pejë	334 	275 
Gjykata Themelore në Ferizaj	212 	202 
TOTAL	5,593	2,144

GJITHSEJ NË PUNË	ZGJIDHURA	BARTURA NË KOMPETENCË	PAZGJIDHURA NË FUND
2,952      	691 	31 	2,230     
850  	470  	0	380 
492 	234 	1 	257 
1,994 	601  	0 	1,393   
426 	263 	22 	141 
609 	391 	0 	218 
414 	191 	2 	221 
7,737	2,841	56	4,840



● Çohu! dhe CSD konsiderojnë se mostrajtimi i lëndëve për një kohë të gjatë në GjTh në Mitrovicë dhe grumbullimi i tyre, puna në kushte të vështira dhe ndryshimet ligjore, kanë krijuar vështirësi në trajtimin me efikasitet të lëndëve dhe gjithashtu zgjidhjen e lëndëve në mënyrën tjetër.

● Bazuar në të dhënat e monitorimit në tri gjykatat përkatëse (Prishtinë, Gjilan dhe Mitrovicë), vetëm 15 raste janë të kualifikuara si korrupsion i nivelit të lartë në të cilat të përfshirë janë personat nga profilet e ndryshme, deri të biznesmenë dhe qytetar të thjeshtë.

4. Rastet e profilit të lartë - luftimi i korrupsionit të nivelit të lartë

Gjatë monitorimit njëvjeçar, të rasteve të korrupsionit dhe kërimit të organizuar, Çohu! dhe CSD janë fokusuar në monitorimin e rasteve të cilat konsideroheshin të profilit të lartë. Bazuar në ligjin për Prokurorin e Shtetit, Prokurori i Shtetit me pajtimin e kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe me kryeprokuroren e EULEX-it, me 13 nëntor të vitit 2013, kishin lëshuar Udhëzimin Administrativ i cili kualifikonte korrupsionin e nivelit të lartë.⁸⁰

Në 9 nenet e udhëzimit, përfshihen veprat të cilat futen në domenin e korrupsionit të nivelit të lartë, të dyshuarit nga pozitat përkatëse publike si dhe shumat përkatëse të cilat kualifikonin korrupsionin e nivelit të lartë. Bazuar në Udhëzim, niveli i lartë i korrupsionit konsideroheshin të gjitha rastet në të cilat ishin të përfshirë: Presidenti i Kosovës, kryetari dhe anëtarët e parlamentit (deputetët), kryeministri, zv/kryeministri/at dhe ministrat e Qeverisë së Kosovës, kryetarët e komunave, gjykatësit e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit, kryeprokurori i Shtetit dhe kryeprokurorët.⁸¹

Bazuar në të dhënat e monitorimit në tri gjykatat përkatëse (Prishtinë, Gjilan dhe Mitrovicë), vetëm 15 raste janë të

kualifikuara si korrupsion i nivelit të lartë në të cilat të përfshirë janë personat nga profilet e ndryshme, deri të biznesmenë dhe qytetar të thjeshtë.

Po nga këto të dhëna gjejmë se në rastet e profilit të lartë ka deputetë, ministra, zv/ministra dhe sekretar të përgjithshëm të ministrive, kryetar të komunave, kryetar të gjykatave, kryeprokuror dhe të tjerë.

Tabela nr 3, ka pasqyruar profilin dhe pozitën e të akuzuarve për veprat penale të korrupsionit, në të cilat përfshihen edhe rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, raste këto të monitoruara në gjykatat themelore në Prishtinë, Gjilan dhe Mitrovicë:

Bazuar në të dhënat e pasqyruara në tabelë në 85 rastet monitoruara, janë të përfshirë gjithsej 285 persona, shumica prej të cilave raste të natyrës së korrupsionit.⁸² Nga gjithsej 285 personat e akuzuar, dominojnë numër më i madh i qytetarëve pa ndonjë pozite me gjithsej 64 të tillë, persona të profilit mjek me gjithsej 47 të tillë, zyrtarë në kompani dhe biznese private me 39 persona, 20 zyrtarë në ministri, 17 zyrtarë në komuna, 2 deputetë, 4 ministra dhe të tjera.

Në 15 rastet e korrupsionit të nivelit të lartë në të cilat janë të përfshirë 140 persona, Organizata Çohu! dhe CSD kanë identifikuar vetëm 13 zyrtarë të profilit të lartë, të kategorizuar si të tillë edhe sipas Udhëzimit Administrativ. Profilet e larta përfshijnë 2 deputetë të Kuvendit të Kosovës, 5 ministra, 4 kryetar komunash, një kryetar gjykate dhe një kryeprokuror (në gjykatat monitoruese, Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjilan). Zyrtarët tjerë publikë të përfshirë në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë janë personat të cilët kanë ushtruar autoritet publik

80 Udhëzimi Administrativ për Korrupsionin e Nivelit të Lartë, 13 nëntor 2013, Prishtinë.

81 Shënim: Rastet tjera të cilat kalonin shumë prej 500 Euro të përfitimit ose dëmit të shkaktuar si rezultat i veprës penale, në të cilat ishin të përfshirë: Zëvendës ministër i Qeverisë së Kosovës, Shërbyes Civil i nivelit të menaxhimit të lartë (Sekretar i Përgjithshëm apo pozita të barazvlefshme), punonjës i ministrive apo i institucioneve publike në vendim-marrje apo pozicione këshilluese; Si dhe të gjitha rastet pavarësisht nga pozita e personit, në të cilat vlera e përfitimit ose dëmit të shkaktuar si rezultat i veprës penale, tejkalon shumë prej 1 milion Euro. Vendimi kishte kualifikuar 15 vepra penale si korrupsion i nivelit të lartë.

82 Vërejtje: Në kategorizimin e të dhënave për personat e përfshirë në rastet e kategorizuara të profilit të lartë, janë përfshirë 85 rastet e para të monitorimit.

PROFILI	NR. AKUZUARVE	INSTITUCIONI	VENDI
Deputet/e	2	Kuvendi i Kosovës	Prishtinë
Ministër/e	4	Qeveria e Kosovës	Prishtinë
Zv/ministër/e	1	Qeveria e Kosovës (MKRS)	Prishtinë
Sekretar i Përgjithshëm në Ministri	4	Qeveria e Kosovës (MAShT, MSh, etj)	Prishtinë
Zyrtar në Qeveri	1	Qeveria e Kosovës	Prishtinë
Zyrtar/e në ministri	20	Qeveria e Kosovës (ministritë)	Prishtinë
Kryetar/e Komunë	4	Komunë	Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë
Zyrtar/e komunal	17	Komunë	Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë
Kryetar/e Gjykate	1	Gjykata Kushtetuese	Prishtinë
Zyrtar/e në gjykata	1	Gjykata	Prishtinë
Kryeprokuror/e	1	PTH në Gjakovë	Gjilan
Zyrtar/e në OSHP	5	Organi Shqyrtues i Prokurimit	Prishtinë
Zyrtar/e doganor	4	Dogana e Kosovës	Prishtinë, Gjilan
Zyrtar/e policor	7	Policia e Kosovës	Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë
Agjenci të Pavarura	14	Agjencioni Kosovar i Privatizimit, etj.	Prishtinë
Mjek	47	Spital Regjional, etj.	Prishtinë, Mitrovicë
Zyrtar/e në shëndetësi	4	QKUK, etj	Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë
Producent, regjisor	2	Teatri Kombëtar	Prishtinë
Punonjës në Teatrin Kombëtar	2	Teatri Kombëtar	Prishtinë
Drejtor shkolle	2	Shkollë e Mesme e Ulët	Gjilan, Prishtinë
Arsim/UP	2	Universiteti "Hasan Prishtina"	Prishtinë
Punonjës në TV publik	3	Radio Televizioni i Kosovës	Prishtinë
Ndërmarrje Publike	12	Ujësjetës, KEK, KEDS, etj.	Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë
Operator Ekonomik Mobil	1	IPKO	Prishtinë
Zyrtar/e në Bankë	5	BKT, BpB, TEB, etj.	Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë
Kompani private/ biznese	39		Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë
Student	11	Universiteti "Hasan Prishtina"	Prishtinë
Avokat	3	Oda e Avokatëve të Kosovës	Prishtinë
Kontabilist	1		Prishtinë
Qytetarë dhe të tjerë	64		Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë
Total	285		

TABELA 4: Profilet e personave të akuzuar për rastet e nivelit të lartë të korrupsionit, bazuar në të dhënat e monitorimit për periudhën maj 2016 – maj 2017 në gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjilan.



Në 15 rastet e korrupsionit të nivelit të lartë në të cilat janë të përfshirë **140 persona**, Organizata Çohu! dhe CSD kanë identifikuar vetëm **13 zyrtarë të profilit të lartë**, të kategorizuar si të tillë edhe sipas Udhëzimit Administrativ. Profilet e larta përfshijnë **2 deputetë të Kuvendit të Kosovës, 5 ministra, 4 kryetar komunash, një kryetar gjykate dhe një kryeprokuror** (në gjykatat monitoruese, Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjiilan).

nga pozitat si: zëvendës ministër, sekretar të përgjithshëm në ministritë përkatëse, drejtor të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe të tjerë, të pasqyruara si në tabelë.

Organizata Çohu! dhe CSD konsiderojnë si shqetësuese rastet e pakta të profilin të lartë si dhe mënyra e zgjidhjes së rasteve të tilla. Bazuar në të dhënat e monitorimit, nga gjithsej 13 personat e profilin të lartë, rastet ndaj 8 të akuzuarve kanë përfunduar, në shkallë të parë apo të dytë, derisa rastet për 5 të tjerë, vazhdojnë të jenë në procesin gjyqësor.

Shqetësim mbetet mënyra e zgjidhjes së rasteve të tilla, me ç'rast nga gjithsejtë 8 të akuzuarit ndaj të cilëve ka përfunduar procesi gjyqësor (dy ministra, 4 kryetarë komunash, një kryetar gjykate dhe një kryeprokuror) 4 janë shpallur fajtor dhe janë ndëshkuar me dënime minimale, ndërsa ndaj 4 të tjerëve janë hedhur poshtë aktakuzat në mungesë të provave, sipas arsyetimit të gjykatës. Në katër personat e përfshirë në ndëshkim, janë dy ministra dhe dy kryetar komunash, derisa në 4 zyrtarët tjerë të profilin të lartë ndaj të cilëve poashtu kanë përfunduar proceset gjyqësore në shkallë të parë janë dy kryetarë komunash, një kryetar gjykate dhe një kryeprokuror.

Dy ish ministrat nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Astrit Haraqija dhe Valton Beqiri të cilët në bazë të



Përkundër kërkesës së vazhdueshme të Organizatës Çohu! dhe CSD për të pasur qasje dhe siguruar të dhënat me profilin/pozitat e të akuzuarve për veprat penale të natyrës korruptive, KGJK dhe KPK nuk kishin siguruar të dhënat e tilla.

aktakuzës së prokurorisë në fillim akuzoheshin për keqpërdorim të detyrës deri në shumat prej 570.000,00 Euro, për çka edhe ishin shpallur fajtor, ishin ndëshkuar me nga një vit burgim, mirëpo i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarit në periudhën njëvjeçare, nuk kryejnë vepër tjetër penale.⁸³

Dy kryetarët tjerë të ndëshkuar, kryetari i Komunës së Klllokotit Sreqko Spasiq dhe kryetari i Komunës së Novobërdes Svetislav Ivanoviq, ishin akuzuar për Keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe konflikt të interesit. Derisa

⁸³ Shpallja e Aktgjykimit në rregjykimin e dy ish ministrave, ishte bërë me 15 dhjetor 2016, në të cilin rast të përfshirë kishin qenë gjithashtu një aktor dhe një producent, të cilët poashtu ishin shpallur fajtor dhe ishin dënuar.





Dënimet e ulëta për zyrtaret e profilit të lartë, përkundër shpalljes fajtor për shumtë e mëdha të përfitimit apo dëmtimit të buxhetit publik, përveçse nuk ndëshkon keqpërdoruesit me pozitat publike, gjithashtu bartë mesazhin negativ për keqpërdoruesit eventual. Hudhja poshtë e aktakuzave dhe lirimi i të akuzuarve, dëshmon edhe njëherë mungesën e profesionalizmit të prokurorisë me rastin e ngritjes së aktakuzave dhe pamundësinë e tyre të provimit të fakteve për të cilat prokuroria kishte pretenduar fajësinë e zyrtarëve të lartë publikë të përfshirë në hetimet e tyre.

kryetari i Komunës së Klllokotit ishte ndëshkuar me 10 muaj dënim me burgim mirëpo dënim i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 vjetëve nuk kryen veprë tjetër penale, kryetari i Novobërdës ishte dënuar me 4 mijë e 500 euro gjobë.⁸⁴

Çohu! dhe CSD vlerësojnë se dënimet e ulëta, hedhja poshtë e aktakuzave dhe lirimi i zyrtarëve të kualifikuar si zyrtar me profilin e lartë, dëshmon edhe njëherë për shkallën e ulët të luftimit dhe ndëshkimit të korrupsionit të nivelit të lartë. Dënimet e ulëta për zyrtaret e profilit të lartë, përkundër shpalljes fajtor për shumtë e mëdha të përfitimit apo dëmtimit të buxhetit publik, përveçse nuk ndëshkon keqpërdoruesit me pozitat publike, gjithashtu bartë mesazhin negativ për keqpërdoruesit eventual. Hudhja poshtë e aktakuzave dhe lirimi i të akuzuarve, dëshmon edhe njëherë mungesën e profesionalizmit të prokurorisë me rastin e ngritjes së aktakuzave dhe pamundësinë e tyre të provimit të fakteve për të cilat prokuroria kishte pretenduar fajësinë e zyrtarëve të lartë publikë të përfshirë në hetimet e tyre.

⁸⁴ Gjykata Themelore në Gjilan me 17 mars 2017 kishte dënuar kryetarin e komunës së Novobërdës, Svetislav Ivanović me 4 mijë e 500 euro gjobë, për dy vepra penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe për veprën penale të konfliktit të interesit. Kjo kishte ardhur pasi Kryetari i Novobërdës kishte negociuar me prokuroren e çështjes me ç'rast ka pranuar fajësinë, ngase ai kishte punësuar gruan e tij si menaxhere në sektorin e kulturës duke mos përfillur procedurat ligjore ku për dy vite ishte dëmtuar buxheti i Kosovës mbi 13 mijë euro.

4.1 Mungesa e të dhënave për profilet (pozitat)

Bazuar në të dhënat e KGJK-së, gjatë vitit 2016 gjykatat themelore në Kosovë me degët përkatëse, kishin në punë gjithsej 929 raste të natyrës së korrupsionit prej të cilave 640 të tilla i përkasin gjykatave themelore me degë në Prishtinë, Gjilan dhe Mitrovicë.

Gjatë monitorimit njëvjeçar, Çohu! dhe CSD në vazhdimësi kishin monitoruar 102 raste në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Gjilan dhe Mitrovicë, në të cilat raste, edhe kishte arritur të identifikojë profilin dhe pozitat e njerëzve të akuzuar për veprat penale të natyrës së korrupsionit.

Përkundër kërkesës së vazhdueshme të Organizatës Çohu! dhe CSD për të pasur qasje dhe siguruar të dhënat me profilin/pozitat e të akuzuarve për veprat penale të natyrës korruptive, KGJK dhe KPK nuk kishin siguruar të dhënat e tilla.

Në përgjigjet e tyre, KGJK dhe KPK deklarojnë të mos posedojnë të dhënat për profilin dhe pozitat si të kategorizuara të cilët në përgjigjet e tyre, nuk japin arsytet për mungesën e





Zvarritja e seancave gjyqësore, vonesa e fillimit të tyre si dhe shtyrja e shqyrtimeve, është ndër shkaqet të cilat kanë ndikuar në grumbullimin e lëndëve në gjykata.

të dhënave të tilla të kategorizuara.⁸⁵ Në përgjigjen e tyre të datës 3 prill 2017, Zyra për Statistika e KPK-së deklarojnë të mos posedojnë të dhënat për profilin e njerëzve të përfshirë në aktakuza.

Organizata Çohu! dhe CSD konsiderojnë se mungesa e të dhënave lidhur me profilin e të akuzuarve të përfshirë në rastet e korrupsionit, dëshmon edhe njëherë për brishtësinë dhe problemet e vazhdueshme të këtyre dy institucioneve lidhur me posedimin dhe unifikimin e statistikave të tilla.

Mungesa e të dhënave të kategorizuara sipas profilit të njerëzve të përfshirë në aktakuza dhe procese gjyqësore, pamundëson të dhënat e plota dhe pasqyrimin e duhur për të evidentuar se cilat institucione dhe pozita të autoritetit publik, qëndrojnë më të përfshira në rastet e korrupsionit.

Çohu! dhe CSD konstatojnë se pasqyrimi i plotë i kësaj problematike dhe të dhënat e plota për profilin dhe pozitat e personave të përfshirë në rastet e hetuara dhe gjykuara të korrupsionit, përveçse do të mundësonin një pasqyrë të plotë mbi atë se cilat institucione dhe pozita me autoritet publik janë të përfshira më shumë në rastet e natyrës korruptive, vështirëson gjithashtu krijimin dhe zbatimin e strategjisë drejtë luftimit dhe trajtimit më me efikas të

⁸⁵ Shënim: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nuk posedon statistika të kategorizuara sipas profilit dhe pozitës së të akuzuarve për rastet e korrupsionit. Në përgjigjen e tyre për organizatën Çohu!, KGJK ka ofruar disa të dhëna për profilet e larta të të përfshirëve në rastet e zgjidhura nga gjykatat, mirëpo që nuk posedonte të dhënat e kategorizuara për profilin dhe pozitën e të gjithë të akuzuarit e përfshirë në rastet e korrupsionit dhe krimin të organizuar.

rasteve të tilla ndaj institucioneve dhe autoriteteve publike të tilla.

Prandaj organizata Çohu! dhe CSD konsiderojnë se kategorizimi i të dhënave të tilla sipas profilit dhe pozitës së të akuzuarve, është me rëndësi për sistemin e drejtësisë, për evidentimin dhe pasqyrimin e plotë me rastet e tilla e cila do t'i kontribuonte gjithashtu transparencës së sistemit të drejtësisë.

5. Përfundime dhe Rekomandime

Sistemi i Drejtësisë në Kosovë ndër tjera, vazhdon të ketë vështirësi në mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore, transparencën dhe qasjen e qytetareve në drejtësi, respektimin e afateve ligjore dhe procedurale si dhe gjykimin e drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme.

Mungesa e transparencës përmes mbylljes së proceseve të rëndësishme gjyqësore në të cilat janë përfshirë ish zyrtarë të lartë me funksione të larta publike, dëshmon për arbitraritetin e gjyqësorit dhe bie në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe kushtetuese duke pamundësuar kështu qasjen dhe pjesëmarrjen e publikut në seancat e tilla të rëndësishme publike. Mbyllja e seancave qoftë për arsyt teknike, dësh-



Mungesa e të dhënave të kategorizuara sipas profilit të njerëzve të përfshirë në aktakuza dhe procese gjyqësore, pamundëson të dhënat e plota dhe pasqyrimin e duhur për të evidentuar se cilat institucione dhe pozita të autoritetit publik, qëndrojnë më të përfshira në rastet e korrupsionit.

mon në vazhdimësi mungesën e transparencës dhe llogaridhënies së gjykatësve për vendimet e tilla dhe vazhdon t'i kontribuoj jo transparencës së gjykatave dhe mungesës së qasjes për publikun.

Zvarritja e seancave gjyqësore, vonesa e fillimit të tyre si dhe shtyrja e shqyrtimeve, është ndër shkaqet të cilat kanë ndikuar në grumbullimin e lëndëve në gjykata.

Vonesat në fillimin e shqyrtimeve gjyqësore si dhe shtyrja e tyre për shkaqe të ndryshme, duke filluar nga ato teknike deri të pamundësia e krijimit të trupit gjykues dhe zëvendësimi i anëtarëve, kishte ndikuar në zvarritjen e proceseve gjyqësore si dhe grumbullimin e lëndëve në gjykata. E gjithë kjo, vazhdon t'i kontribuojë mungesës së efikasitetit të gjyqësorit në procedimin dhe zgjidhjen e lëndëve.

Organizata Çohu! dhe CSD konsiderojnë si shqetësuese rastet e pakta të profilit të lartë si dhe mënyra e zgjidhjes së rasteve të tilla. Bazuar në të dhënat e monitorimit, nga gjithsej 13 personat e profilit të lartë, rastet ndaj 8 të akuzuarve kanë përfunduar, në shkallë të parë apo të dytë, derisa rastet për 5 të tjerë, vazhdojnë të jenë në procesin gjyqësor.

Çohu! dhe CSD vlerësojnë se dënimet e ulëta, hudhja poshtë e aktakuzave dhe lirimi i zyrtarëve të kualifikuar si zyrtar me profilin e lartë, dëshmon edhe njëherë për shkallën e ulët të luftimit dhe ndëshkimit të korrupsionit të nivelit të lartë.

Theks të veçantë në trajtimet e këtij raporti, zënë mosfunktionimi i gjyqësorit në veriun e Kosovës për më shumë se 8 vjet, me ç'rast komunat në veriun e Kosovës, ende mbeten të paintegruara në sistemin e drejtësisë së Kosovës.

Si pasojë e kësaj, qytetarëve të Kosovës, në veçanti atyre të komunave të veriut të Kosovës, vazhdojnë t'u mohohen të drejtat themelore për qasje në drejtësi, gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme, të paraparë edhe me dispozitat ndërkombëtare, Kushtetutën e Kosovës dhe dispozitat tjera ligjore përkatëse të Kosovës.

Nga gjithsej 102 rastet e monitoruara në 214 seanca gjyqësore për periudhën maj 2016 – maj 2017 në gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjiilan, Çohu! dhe CSD kishin identifikuar shkelje të afateve procedurale pothuajse në të gjitha rastet, varësisht nga faza e procedimit (nga momenti i pranimit të rastit në gjykatë, caktimi dhe mbajtja e shqyrtimit fillestar, dytësor dhe atij kryesor, si dhe përfundimi dhe shpallja e aktgjykimit).

Shkelja e afateve të tilla dhe mos-respektimi i tyre, është shkelje e dispozitave procedurale dhe vazhdon të ketë pasoja në tejzgjatjen e shqyrtimeve gjyqësore dhe grumbullimin e vazhdueshëm më lëndë, e cila gjithashtu konsiderohet shkelje e parimeve të drejtësisë për një gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme.

Rastet e natyrës korruptive të cilat qëndrojnë në numër më të madh për nga zgjidhja e tyre, krahasuar me numrin





Theks të veçantë në trajtimet e këtij raporti, zënë mosfunksionimi i gjyqësorit në veriun e Kosovës për më shumë se 8 vjet, me ç'rast komunat në veriun e Kosovës, ende mbeten të paintegruara në sistemin e drejtësisë së Kosovës.

e rasteve të zgjidhura për kapitujt tjerë, në proporcion me numrin e lëndëve në punë për secilin kapitull, vazhdojnë të mbeten në numër të madh në punë gjithashtu të pazgjidhura.

Edhe pse të trajtuara me prioritet, rastet e korrupsionit vazhdojnë të bartën nga viti në vit në numër pothuajse të njëjtë më atë të viteve paraprake, duke pamundësuar efikasitetin e theksuar të prokurorive dhe gjykatave në trajtimin e rasteve të tilla.

Transparenca

- Transparenca e KPK-së lidhur me qasjen në ak-takuzat publike;
- Transparenca e gjykatës lidhur me shqyrtimet gjyqësore, sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore;
- Hapja e shqyrtimeve për publikun dhe të intere-suarit, në veçanti rasteve të rëndësisë publike;

Profilizimi dhe ngritja e kapaciteteve profesionale dhe njerëzore

- Profilizimi i prokurorëve dhe gjykatësve për ve-prat penale karakteristike si: krimi i organizuar, korrupsioni, krimet ekonomike, terrorizmi dhe të tjerë;

- Organizimi dhe arsimimi i vazhdueshëm ligjor për prokuroret dhe gjykatësit për ngritjen e aftësive dhe kapaciteteve profesionale nga Instituti Gjyqësor i Kosovës, në veçanti për veprat penale të karakterit kompleks dhe të shpallura për trajtim me prioritet;
- Emërimi i prokurorëve dhe gjykatësve të rinj, në përputhje me standardin e kategorizimit me numrin e prokurorëve dhe gjykatësve për prokuroritë dhe gjykatat përkatëse;
- Angazhimi i bashkëpunëtorëve profesional nëpër prokurori dhe gjykata;

Kushtet e punës dhe shtrirja e juridiksionit

- Respektimi i dispozitave kushtetuese, ligjore dhe i atyre ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me qasjen në drejtësi, procedimin dhe përfun-dimin e rasteve brenda afateve ligjore proce-durale si dhe parimit të gjykimit të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme;
- Krijimi i hapësirave të nevojshme për punë nga KPK për prokurorinë në regjionin e Mitrovicës (komunat e veriut të Kosovës, brenda sistemit prokurorial të Kosovës);
- Aktivizimi i gjyqësorit në komunat e veriut të Kosovës, brenda sistemit gjyqësor të Kosovës/ Shtrirja e KGJK-së në komunat e veriut të Kosovës (Veriu i Mitrovicës, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq);



Edhe pse të trajtuara me prioritet, rastet e korrupsionit vazhdojnë të bartën nga viti në vit në numër pothuajse të njëjtë më atë të viteve paraprake, duke pamundësuar efikasitetin e theksuar të prokurorive dhe gjykatave në trajtimin e rasteve të tilla.

Llogaridhënia

- Koordinimi më i mire i prokurorëve me gjykatësit në caktimin dhe mbajtjen e seancave gjyqësore;
- Marrja e masave ndaj prokurorëve me fajin e të cilëve, për mungesat e paarsyetuara në seancë, nuk ishin mbajtur seancat gjyqësore dhe ishin shtyrë për datë tjetër;
- Koordinimi i duhur i kryetarit të trupit gjykues me gjykatësit tjerë (anëtarët e trupit gjykues) me rastin e caktimit dhe mbajtjes së seancave gjyqësore;
- Informimi i kryeprokurorit përkatës për mungesën dhe vonesën e paarsyeshme të prokurorëve në shqyrtim gjyqësor;
- Marrja e masave ndaj gjykatësve për fajin e të cilëve shkaktohen vonesat në fillimin e shqyrtimit gjyqësor, si dhe mungesat e tyre, për fajin e të cilëve, edhe shtyhen shqyrtimet gjyqësore;
- Marrja e masave ndaj gjykatësve për fajin e të cilëve shkaktohen shtyrjet e shqyrtimeve gjyqësore;
- Evitimi i problemeve dhe shkaqeve teknike të cilat shkaktojnë vonesën e fillimit të shqyrtimit gjyqësor, mosmbajtjen dhe shtyrjen e tyre;
- Arritja e objektivave të Planit të Veprimit për trajtim me prioritet të rasteve të korrupsionit;

- Zgjidhja e lëndëve të vjetra të korrupsionit, të kategorizuara si lëndë më të vjetra;
- Vazhdimi i zbatimit të vendimit të KGJK-se për trajtim me prioritet të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- Evitimi i problemeve në Mekanizmin Përcjellës për Veprat Penale Karakteristike të Këshillit Prokurorial të Kosovës, i cili vazhdon të ketë probleme bazike me mospërputhjen e të dhënave sipas veprave penale karakteristike;

Shkeljet procedurale

- Respektimi i afateve procedurale ligjore nga gjykatësit me rastin e caktimit dhe mbajtjes së shqyrtimit fillestar, atij dytësor dhe kryesor;
- Respektimi i afateve procedurale ligjore nga gjykatësit të cilat kanë të bëjnë me përfundimin e shqyrtimit kryesor;
- Krijimi i mekanizmave nga KGJK për vlerësimin dhe konstatimin e arsyeve të mosrespektimit të afateve procedurale ligjore për shqyrtimet gjyqësore;
- Marrja e masave ndaj përgjegjësve për mosrespektimin e afateve procedurale në rastet e konstatimeve të neglizhencës dhe papërgjegjësisë;



ANEKS

Pra, të dhënat e tilla përfshijnë veprat penale të natyrës së korrupsionit, krimin të organizuar, veprat penale kundër dhunës në familje dhe atë të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, për vitin 2015 dhe 2016

1. Krahasimi dhe analiza e procedimit të rasteve në prokurori dhe gjyqësi gjatë viteve 2015 dhe 2016

1.1 Procedimi i rasteve në prokurori dhe gjykata gjatë vitit 2015 dhe të gjeturat

Përveç monitorimit të rasteve nga kapitujt përkatës në gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjilan, Çohu! dhe CSD kanë krahasuar dhe analizuar procedimin dhe zgjidhjen e lëndëve në prokuroritë dhe gjykatat, për lëndët e bartura (trashëguara) ato të pranuar, lëndët e zgjidhura dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre si dhe ato të mbetura në fund (të pazgjidhura) për të gjitha gjykatat dhe prokuroritë.

Pra, të dhënat e tilla përfshijnë veprat penale të natyrës së korrupsionit, krimin të organizuar, veprat penale kundër dhunës në familje dhe atë të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, për vitin 2015 dhe 2016.

Siç është potencuar edhe në të gjeturat e raportit, fokusi në monitorimin dhe analizën e këtyre dy kapitujve të veprave penale, krahasueshmërisht me dy kapitujt e tjerë, atë kundër martesës dhe familjes si dhe veprën penale të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, kishte për qëllim krahasimin e procedimit të rasteve të tilla në prokurori dhe gjykata, si dhe faktin nëse KGJK dhe KPK, respektonin vendimet e tyre për trajtim me prioritet të rasteve për të cilat kishin vendosur të trajtohen si të tilla, me prioritet (ato të korrupsionit dhe krimin të organizuar).

Rastet e paraqitura si në tabelën numër 5, përfshijnë të gjitha prokuroritë për periudhën janar – dhjetor 2015:

Për të krahasuar dhe analizuar procedimin e rasteve të tilla tutje në gjykata, organizata Çohu! dhe CSD kanë paraqitur të dhënat si më poshtë në tabelën numër 6 për periudhën e njëjtë, janar – dhjetor 2015, për veprat penale nga kapitujt e njëjtë:

Bazuar në të dhënat statistikore të KPK-së dhe KGJK-së, njëjtë si gjykatat, gjithashtu prokuroritë prijnë më numrin e madh të rasteve të korrupsionit. Derisa prokuroritë për rastet e tilla, gjatë vitit 2015 kanë pranuar në punë gjithsej 412 raste me 860 persona, ato kanë zgjidhur 456 raste me 921 persona, në anën tjetër gjykatat kompetente, gjatë vitit 2015 kanë pranuar në punë 282 raste dhe kanë zgjidhur 260 të tilla.

Njëjtë si prokuroritë, gjithashtu gjykatat kanë vazhduar të kenë numër të konsideruar të rasteve të pazgjidhura në fund. Raste të mbetura të pazgjidhura në prokuroritë themelore dhe PSRK kishin mbetur gjithsej 538 raste me 1,640 persona, ndërsa gjykatat themelore, në fund të dhjetorit 2015, kishin pasur në punë gjithsej 671.

Gjatë krahasimit dhe analizës së procedimit të rasteve të tilla sipas kapitujve për vitin 2015, fillimisht është identifikuar mos-përputhja e procedimit të rasteve nëpër kategori⁸⁶ në mekanizmin përcjellës të të dhënave në KPK për natyrat e veprave penale që janë në trajtim.⁸⁷

Sipas po këtyre të dhënave, derisa nga viti paraprak i periudhës raportuese (2014) ishin bartur gjithsej 637 raste me

86 Shënim: Rastet nëpër kategoritë: të bartura, të pranuar, rastet e zgjidhura si dhe ato të mbetura – pazgjidhura në fund.

87 Shënim: Veprat penale të natyrës së korrupsionit, krimin të organizuar, veprat penale kundër martesës dhe familjes si dhe atë të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik.

Trendi i rasteve të bartura, pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në fund




TABELA 5: Trendi i rasteve të bartura, pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në fund për veprat penale të natyrës së korrupsionit, krimin të organizuar, kundër martesës dhe familjes dhe atë të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga të gjitha prokuroritë për vitin 2015.

Gjendja me lëndët në gjykatat themelore gjatë vitit 2015

Rastet në gjykata sipas kapitujve të Kodit Penal të Kosovës (janar - dhjetor 2015)	Trashëguara	Të pranuara	Gjithsej në punë	MËNYRA E ZGJIDHJES										Pazgjdhura në fund
				LLOJET E DËNIMEVE				Aktgjykim Lirues	Aktgjykim Refuzues	Parashkrim	Mënyrë tjetër	Zgjidhura gjithsej	Bartur në kompe-tencë	
				Burg	Gjorbë	Kusht	Tjera							
Kapitulli XXXIV – Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare	662	282	944	34	40	53	1	44	33	13	42	260	13	671
Kapitulli XXIV – Krimi i organizuar	35	13	48	1	0	0	0	0	0	0	1	2	0	46
Kapitulli XXI - Veprat penale kundër martesës dhe familjes	140	59	199	5	5	19	0	0	0	5	9	43	0	156
Kapitulli XIV – Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës (neni 147 KPRK)	5	6	11	1	0	0	0	0	0	0	2	3	0	8
Total	842	360	1,202	41	45	72	1	44	33	18	54	308	13	881

TABELA 6: Trendi i rasteve të bartura, pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjdhura në fund për veprat penale të natyrës së korrupsionit, krimin të organizuar, kundër martesës dhe familjes dhe atë të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga të gjitha gjykatat themelore për periudhën raportuese (janar - dhjetor 2015).

2,094 persona, gjatë vitit 2015 ishin pranuar 482 raste me 1,122 persona për të gjithë kapitujt, të cilat gjithsej përfshinin 1,119 raste me 3,216 persona në punë gjatë vitit 2015, sipas të dhënave të prokurorisë, në fund kishin mbetur të pazgjdhura 656 raste me 2,162 persona.

(522 lëndë me 1,113 persona) dalin të jenë 597 raste me 2,103 persona dhe jo siç figurojnë në të dhënat e KPK-së, 656 raste me 2,162 persona.⁸⁸

Statistika e tillë del të jetë ndryshe nga kjo që figuron në të dhënat e KPK-së nëse llogaritim të gjitha lëndët në punë gjatë vitit 2015 (1,119 raste me 3,216 persona) pa lëndët e zgjidhura gjatë periudhës së njëjtë (522 lëndë me 1,113 persona). Sipas të dhënave të KPK-së, nëse llogariten të gjitha lëndët në punë (1,119 raste me 3,216 persona) pa lëndët e zgjidhura gjatë periudhës së njëjtë

88 Shënim: Sipas llogaritjes së tillë, dalin të figurojnë 59 raste me shumë dhe 59 persona më pak sesa do të duhej të ishin, bazuar në të dhënat në punë, pa ato të zgjidhura gjatë periudhës janar – dhjetor 2015.

Sqarim: Derisa numri i rasteve mund të lëvizë dhe të qëndrojë jo-përputhshëm me të dhënat finale, numri i personave duhet të jetë i përputhshëm në fund. Numri i rasteve mund të lëvizë për shkak se në një rast janë të përfshirë disa persona ndaj të cilëve, mund të vendoset në mënyra të ndryshme (për të njëjtin rast, për disa persona mund të procedohet tutje, për disa të tjerë të pushohen hetimet apo hudhen poshtë pretendimet), ndërsa numri i personave duhet të përkohet dhe të jetë i saktë, duke llogaritur numrin e tyre në punë gjithsej (të trashëguar dhe pranuar), pa personat ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet.

Në anën tjetër, KGJK nuk ballafaqohet me probleme të tilla të mos-përputhjes së lëndëve sa ai përket të dhënave të cilat kanë siguruar Çohu! dhe CSD për vitin 2015. Bazuar në të dhënat e siguruar në KGJK, dominojnë dënimet e lehta për rastet e veprave penale të korrupsionit, ndërsa vërehet mungesa e ndëshkimeve për rastet e krimit të organizuar.⁸⁹

1.2 Procedimi në prokurori dhe gjykata gjatë vitit 2016 dhe të gjeturat

Pothuajse trend i njëjtë i procedimit të rasteve në prokurori dhe gjykata, ka vazhduar në vitin 2016.

Organizata Çohu dhe CSD! gjatë krahasimit dhe analizës së të dhënave për vitin 2016 kanë vërejtur trend të njëjtë të rasteve të proceduara nga prokuroritë dhe gjykatat, me numrin e madh të rasteve të trashëguara nga vitet para-prake. Gjithashtu, përveç mos-përputhjes së rasteve nëpër kategori të trajtuara si më lartë për vitin 2015, në vitin 2016 janë identifikuar mos-përputhje po të këtyre të dhënave nga viti në vit (2015 – 2016).

Në tabelat si më poshtë, numër 7 dhe numër 8, janë paraqitur rastet e proceduara në prokurori dhe gjykata për periudhën 2016:

Trend i njëjtë i rasteve të pranuar dhe zgjidhura gjatë periudhës së njëjtë (2016) ka vazhduar edhe në gjykatat themelore. Rastet e paraqitura në tabelën numër 10, përfshijnë periudhën 2016, për veprat penale nga kapitujt e njëjtë të proceduara në gjykata:

Prokuroritë dhe gjykatat, kishin pasur afërsisht numër të njëjtë të rasteve në punë gjatë vitit 2016. Derisa prokuroritë gjatë periudhës së tillë kishin pranuar 500 raste për veprat penale nga kapitujt e trajtuara në këtë raport, gjykatat gjatë periudhës së njëjtë, kishin pranuar gjithsej 345 raste.

89 Shënim: Nga gjithsej 260 rastet e zgjidhura në gjykatat kompetente në shkallën e parë të natyrës së korrupsionit, vetëm 34 raste janë vendosur me dënim me burgim efektiv, 40 të tilla me dënim me gjobë dhe 53 raste me dënim me kusht. Kategoritë tjera të lëndëve të zgjidhura përfshinin ato me aktgjykim lirues (44 raste), aktgjykim refuzues (33 raste), parashkrim (13 raste) mënyrë tjetër (42 raste) dhe të bartura në kompetencë (13 raste), të cilat vazhdojnë ta dominojnë numrin e rasteve të vendosura nga gjykatat e shkallës së parë për vitin 2015. Ndërsa nga gjithsej 48 rastet e krimit të organizuar që kishte në punë në gjykatat themelore, vetëm për dy të tilla ishte vendosur, përkatësisht 1 rast dënim me burg ndërsa tjetri ishte zgjidhur në mënyrë tjetër. Të gjitha janë pasqyruar në tabelën e mësipërme.

Sipas të dhënave të KPK-së, nëse llogariten të gjitha lëndët në punë (1,119 raste me 3,216 persona) pa lëndët e zgjidhura gjatë periudhës së njëjtë (522 lëndë me 1,113 persona) dalin të jenë 597 raste me 2,103 persona dhe jo siç figurojnë në të dhënat e KPK-së, 656 raste me 2,162 persona.

Edhe në periudhën e tillë njëjtë si për vitin 2015, rastet e korrupsionit vazhdojnë të jenë më shumë në numër krahasuar me kapitujt tjerë të trajtuar. Gjatë vitit 2016, prokuroritë kishin pranuar në punë 443 raste me 824 persona duke pasur në punë gjithsej 984 raste me 2,491 persona marrë parasysh edhe 541 rastet me 1,667 persona të trashëguara nga viti paraprak, dhe kishin zgjidhur 461 raste me 1,115 persona derisa të pazgjidhura në fund kishin mbetur gjithsej 447 raste me 1,248 persona.

Në anën tjetër, gjykatat kishin pranuar 258 raste të natyrës së korrupsionit për vitin 2016 të cilat së bashku me 671 rastet e trashëguara, kishin pasur në punë gjithsej 929 të tilla. Gjatë periudhës së njëjtë, gjykatat kanë zgjidhur 357 raste, 1 rast ishte bartur në kompetencë duke mbetur të pazgjidhura në fund 785 raste për vitin 2016.

Rastet me persona sipas kapitujve për prokurori dhe rastet për gjykata, janë paraqitur në tabelat si më lartë (tabela 7 dhe 8).

1.3 Mospërputhja e të dhënave

Mospërputhja e të dhënave sipas kapitujve të trajtuar për prokuroritë ekziston gjithashtu në periudhat kohore ndërmjet vitit 2015 dhe 2016. Saktësisht, të dhënat të cilat kanë figuruar me 31 dhjetor 2015 e të cilat do të duhej të ishin po ato të dhëna që trashëgohen në vitin pasues, përkatësisht me 1 janar 2016, nuk figurojnë të jenë të barabarta. Mospërputhja e të dhënave ka ekzistuar për prokuroritë, të cilat janë paraqitur si në tabelën 9:











Rastet në prokurori sipas kapitujve të Kodit Penal të Kosovës (janar - dhjetor 2016)	Të trashëguara (1 janar 2016)		Të pranuar (janar – dhjetor 2016)		Gjithsej në punë (janar - dhjetor 2016)		Të zgjidhura (janar - dhjetor 2016)		Të pazgjidhura (31 dhjetor 2016)	
	Raste 	Persona 	Raste 	Persona 	Raste 	Persona 	Raste 	Persona 	Raste 	Persona 
Kapitulli XXXIV – Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare	541	1667	443	824	984	2491	461	1115	447	1248
Kapitulli XXIV – Krimi i organizuar	49	420	2	27	51	447	23	185	40	343
Kapitulli XXI - Veprat penale kundër martesës dhe familjes	55	73	51	60	106	133	53	61	53	72
Kapitulli XIV – Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës (neni 147 KPRK)	13	80	4	5	17	85	11	16	16	76
Total	658	2240	500	916	1158	3156	548	1377	556	1739

TABELA 7: Trendi i rasteve të bartura, pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në fund për veprat penale të natyrës së korrupsionit, krimit të organizuar, kundër martesës dhe familjes dhe atë të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga të gjitha prokuroritë për periudhën raportuese janar - dhjetor 2016.

Çohu! dhe CSD konsiderojnë se mospërputhja e të dhënave të tilla, në veçanti rasteve të korrupsionit, dëshmon problemet e vazhdueshme të KPK-së lidhur me unifikimin dhe procedimin e saktë të rasteve të tilla

Mënyra e zgjidhjes së lëndëve në gjykatat themelore gjatë viti 2016

Kapitulli XIV – Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës (neni 147 KPRK)

"Kapitulli XXI - Veprat penale kundër martesës dhe familjes "

Kapitulli XXIV – Krimi i organizuar

Kapitulli XXXIV – Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare




TABELA 8: Mënyra e zgjidhjes së lëndëve të natyrës së korrupsionit, krimit të organizuar, kundër martesës dhe familjes dhe atë të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga të gjitha gjykatat për periudhën raportuese janar - dhjetor 2016

Nëse shikohen të dhënat në fund të vitit 2015 sipas prokurorive nëpër kapituj, shohim se derisa në fund të vitit 2015 (31 dhjetor 2015) për veprat penale të korrupsionit kishim 538 raste me 1,640 persona, me 1 janar 2016, figurojnë 541 raste me 1,667 persona. Edhe pse duhej të ishte e njëjta e dhënë, sipas po këtyre të dhënave del të ketë mos-përputhje për 3 raste me 27 persona më shumë, të cilat më parë nuk figuronin fare në databazë. Rrjedhimisht diferenca prej 3 rasteve me 27 persona, nuk janë regjistruar nëpër kategori (të pranuar), apo janë regjistruar me vonesë.



Njëjtë kemi situatën edhe me kapitujt tjerë, për veprat penale nga kapitulli i krimit të organizuar,⁹⁰ ato kundër martesës dhe familjes,⁹¹ si dhe të tjerat nga neni 147 i KPRK-së.⁹²

90 Shënim: Në fund të vitit 2015 raste me persona të Krimi i Organizuar në fund të vitit 2015 (31 dhjetor 2015) kishin mbetur të pazgjidhura, 47 raste me 354 persona, me 1 janar 2016, figurojnë 49 raste me 420 persona. Edhe pse duhej të ishte e njëjta e dhënë, sipas po këtyre të dhënave, del të ketë shpërputhje për 2 raste me 66 persona më shumë, të cilat më parë nuk figuronin fare në databazë.

91 Shënim: Ndryshe prej të dhënave nga kapitujt tjerë që kishin shpërputhje, rastet me persona për veprat penale kundër martesës dhe familjes janë të përputhshme.

92 Shënim: Në fund të vitit 2015 raste me persona të vepra penale nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik në fund të vitit 2015 (31 dhjetor 2015) kishin mbetur të pazgjidhura, 16 raste me 95 persona, me 1 janar 2016, figurojnë 13 raste me 80 persona. Edhe pse duhej të ishte e njëjta e dhënë, sipas po këtyre të dhënave, del të ketë shpërputhje për 3 raste me 15 persona më pak, të cilat më parë figuronin në databazë

Diferenca e të dhënave të papërputhura

		Kapitulli XXXIV – Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare	Kapitulli XXIV – Krimi i organizuar	Kapitulli XXI - Veprat penale kundër martesës dhe familjes	Kapitulli XIV – Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës (neni 147 KPRK)	Total
RASTE		3	2	/	-3	2
PERSONA		27	66	/	-15	78









Të dhënat e mospërputhura sipas kapitujve të trajtuar (31 dhjetor 2015 – 1 janar 2016)	Të raportuara si të pazgjidhura (31 dhjetor 2015)		Të raportuara si të trashëguara (1 janar 2016)		Diferenca e të dhënave të papërputhura	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
						
Kapitulli XXXIV – Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare	538	1,640	541	1,667	3	27
Kapitulli XXIV – Krimi i organizuar	47	354	49	420	2	66
Kapitulli XXI - Veprat penale kundër martesës dhe familjes	55	73	55	73	/	/
Kapitulli XIV – Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës (neni 147 KPRK)	16	95	13	80	-3	-15
Total	656	2,162	658	2,240	2	78

TABELA 9: Trendi i rasteve dhe personave të mospërputhura sipas kapitujve të trajtuar (31 dhjetor 2015 - 1 janar 2016).

● Marrë parasysh të dhënat totale nga të gjithë kapitujt, derisa me (31 dhjetor 2015 kishin mbetur të pazgjidhura 656 raste me 2,162 persona, me 1 janar 2016 figurojnë 658 raste me 2,240 persona. Edhe pse duhej të ishte e njëjta e dhënë, sipas po këtyre të dhënave, del të ketë shpërputhje për 2 raste me 78 persona më shumë.

Marrë parasysh të dhënat totale nga të gjithë kapitujt, derisa me (31 dhjetor 2015 kishin mbetur të pazgjidhura 656 raste me 2,162 persona, me 1 janar 2016 figurojnë 658 raste me 2,240 persona. Edhe pse duhej të ishte e njëjta e dhënë, sipas po këtyre të dhënave, del të ketë shpërputhje për 2 raste me 78 persona më shumë.

Përfaqësues të KPK-së, gjatë komentimit të të gjeturave të raportit të cilat kanë të bëjnë me shpërputhjen, kanë konfirmuar se në mekanizimin përcjellës për veprat penale karakteristike, ekzistojnë shpërputhje të të dhënave. Të njëjtit shtojnë se kjo ndodhë më shumë për arsye teknike, të cilët vazhdojnë të punojnë në evitimin e problemeve të tilla.

Çohu! dhe CSD konsiderojnë se mospërputhja e të dhënave të tilla, në veçanti rasteve të korrupsionit, dëshmon problemet e vazhdueshme të KPK-së lidhur me unifikimin dhe procedimin e saktë të rasteve të tilla. Edhe pse në dukje probleme të natyrës teknike, Çohu dhe CSD vlerësojnë se mospërputhja e të dhënave nga mekanizimi përcjellës, pamundëson qasjen në të dhënat e sakta dhe si pasojë krijon vështirësi në analizën dhe përfundimin e procedimit të këtyre të dhënave nëpër kategori të ndryshme. Çohu! dhe CSD konsiderojnë se KPK duhet ndërmarrë të gjitha masat për të evituar problemet e tilla.

1.4 Përqindja e zgjidhjes së rasteve sipas kapitujve

Prokuroritë kishin zgjidhur më së shumti raste të natyrës së korrupsionit, krahasuar me kapitujt tjerë të cilat trajtohen në raport. Tabela 10, ka pasqyruar përqindjen e rasteve dhe personave të zgjidhura për nëntëmuorin:

● Bazuar në të dhënat e KPK-së të pasqyruara në tabelë, nga gjithsej 1,158 rastet me 3,156 personat sa ishin në punë gjatë vitit 2016 për katër kapitujt të përfshirë në raport, 984 (. 84.97%) raste me 2,491 persona (78.92%) janë për veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare.

Bazuar në të dhënat e KPK-së të pasqyruara në tabelë, nga gjithsej 1,158 rastet me 3,156 personat sa ishin në punë gjatë vitit 2016 për katër kapitujt të përfshirë në raport, 984 (. 84.97%) raste me 2,491 persona (78.92%) janë për veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare. Të gjitha rastet nga kapitujt, janë pasqyruar si në tabelën 10.⁹³

Tabela në vijim (tabela 11), ka pasqyruar përqindjen e rasteve të zgjidhura të veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar, atyre kundër martesës dhe familjes si dhe vepra penale e nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik në gjykatat e rregullta të Kosovës për vitin 2016:

Veprat penale të korrupsionit prijnë me përqindjen e rasteve të zgjidhura, me ç'rast nga gjithsej 929 rastet e korrupsionit në punë gjatë vitit 2016, gjykatat themelore në shkallë të parë, kanë zgjidhur 357 raste apo 38.42% të tyre. 30.62% dhe 35.74% janë zgjidhur rastet për veprat penale kundër martesës dhe familjes, përkatësisht vepra penale e nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, derisa vetëm 3 raste nga gjithsej 63 të tilla në punë të rasteve të krimit të organizuar, janë zgjidhur gjatë vitit 2016.


Pra, rastet e natyrës korruptive qëndrojnë në numër më të madh edhe për nga zgjidhja e tyre, krahasuar me numrin e rasteve të zgjidhura për kapitujt tjerë, në proporcion me numrin e lëndëve në punë për secilin kapitull.

Edhe pse të trajtuara me prioritet po ashtu nga gjykatat, rastet e korrupsionit vazhdojnë të bartën nga viti në vit në numër pothuajse të njëjtë më atë të viteve paraprake.

93 Shënim: Prokuroritë kishin zgjidhur 44.76% të personave të përfshirë në rastet e natyrës së korrupsionit gjatë vitit 2016 (1.115 persona nga gjithsej 1,248 të tillë sa ishin në punë për këtë periudhë), 45.86% të personave për veprat penale kundër martesës dhe familjes, kanë zgjidhur 41.38% për krimin e organizuar dhe vetëm 18.22% të personave për veprat penale nga neni 147 i KPRK-së (15 persona nga 84 të tillë sa kishin në punë prokuroritë gjatë periudhës janar – shtator 2016).



Personat e perfshirë në rastet e zgjidhura (në %)




Përqindja e rasteve të zgjidhura në prokurori sipas kapitujve të Kodit Penal të Kosovës (janar - dhjetor 2016)	Gjithsej në punë (janar - dhjetor 2016)		Të zgjidhura (janar - dhjetor 2016)				Të pazgjidhura (31 dhjetor 2016)	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
Kapitulli XXXIV – Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare	984	2491	461	46.84%	1115	44.76%	447	1248
Kapitulli XXIV – Krimi i organizuar	51	447	23	45.09%	185	41.38%	40	343
Kapitulli XXI - Veprat penale kundër martesës dhe familjes	106	133	53	50%	61	45.86%	53	72
Kapitulli XIV – Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës (neni 147 KPRK)	17	85	11	64.70%	16	18.22%	16	76
Total	1158	3156	548	47.32%	1377	43.63%	556	1739

TABELA 10: Përqindja e rasteve dhe personave të zgjidhura në prokurori sipas kapitujve të trajtuar (1 janar – 31 dhjetor 2016).



Rastet e zgjidhura në gjykatat themelore (në %)



Përqindja e rasteve të zgjidhura në gjykata sipas kapitujve të Kodit Penal të Kosovës (janar - dhjetor 2016)

	Trashëguara	Të pranuar	Gjithsej në punë	Zgjidhura gjithsej	Të zgjidhura - Përqindja	Bartur në kompetencë	Pazgjidhura në fund
Kapitulli XXXIV – Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare	671	258	929		38.42%	1	571
Kapitulli XXIV – Krimi i organizuar	46	17	63	3	4.76%	0	60
Kapitulli XXI - Veprat penale kundër martesës dhe familjes	145	64	209	64	30.62%	0	145
Kapitulli XIV – Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë (neni 147)	8	6	14	5	35.74%	0	9
Total	870	345	1215	429	35.30%	1	785

TABELA 11: Përqindja e rasteve dhe personave të zgjidhura në gjykata sipas kapitujve të trajtuar (1 janar – 31 dhjetor 2016).

2. Trajtimi i rasteve dhe efikasiteti në prokurori dhe gjykata

Luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar, vazhdon të mbetet një ndër sfidat e vazhdueshme të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Shkalla e lartë e korrupsionit përcillet me mungesën e gatishmërisë dhe vullnetit politik për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar e cila gjithashtu mbetet kërkesë e vazhdueshme e institucioneve ndërkom-bëtare.

Sipas Raportit të Progresit për Kosovën të Komisionit Evropian për vitin 2016, Kosova ende mbetet në fazat e hershme të luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, sipas të cilit korrupsioni vazhdon të mbetet problem serioz dhe i përhapur në fusha të ndryshme.⁹⁴ Raporti rekomandon një vullnet të fuqishëm politik dhe gjithëpërfshirës për trajtimin e korrupsionit në veçanti.⁹⁵

Tutje në draft rezolutën për progresin në Kosovë, të paraqitur në Komitetin për Politikë të Jashtme në Parlamentin Evropian (PE), është paraqitur shqetësim serioz për progresin e ngadaltë të Kosovës në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.⁹⁶

Ky kapitull fillimisht përfshinë analizën e rasteve të korrupsionit në prokurori dhe gjykata për vitin 2015 dhe 2016, pastaj me analizën e rasteve nga krimi i organizuar, ato nga kapitulli i veprave penale kundër martesës dhe familjes si dhe rastet nga vepra penale e nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik për periudhën e njëjtë.

2.1 Rastet e korrupsionit

Plani i Veprimit për Ngritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit, ishte nxjerrë nga KPK fillimisht me 1 nëntor 2013 më të cilin ishin paraparë objektivat dhe hapat e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit (rasteve të vjetra) deri

me 30 qershor të vitit pasues.⁹⁷ Pamundësia e reduktimit dhe zgjidhjes së të gjitha lëndëve të vjetra të natyrës korruptive, ka bërë që Prokuroria Speciale e Kosovës dhe të gjitha prokuroritë themelore, të vazhdojnë trajtimin me prioritet të lëndëve të korrupsionit edhe tani gjatë vitit 2017.

Gjithashtu Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me 30 dhjetor 2015 kishte nxjerrë vendim për trajtimin me prioritet absolut të lëndëve të korrupsionit, i cili kishte hartuar dhe aprovuar edhe Planin e Veprimit për Zgjidhjen e Lëndëve të Korrupsionit.⁹⁸

Bazuar në të dhënat e KPK-së dhe KGJK-së, gjatë vitit 2015, prokuroritë kishin pasur në punë 951 raste me 2,502 persona të natyrës së korrupsionit, derisa gjykatat kishin pasur në punë afër 1,000 raste të natyrës së korrupsionit (994 raste). Ndërsa në vitin 2016 prokuroritë kishin pasur në punë 984 raste derisa gjykatat për periudhën e njëjtë kishin pasur në punë 929 raste të korrupsionit.

Tabela numër 12, ka pasqyruar rastet e bartura (trashëguara) në të gjitha prokuroritë e Kosovës, ato të pranuar gjatë vitit 2015, të zgjidhura si dhe të mbetura për të gjitha prokuroritë (të pazgjidhura) për vitin 2015:

Sipas të dhënave të siguruar nga KPK, prokuroritë themelore dhe Prokuroria Speciale e Kosovës, gjatë vitit 2015 kanë pranuar në punë gjithsej 412 raste me 860 persona, kanë zgjidhur 456 raste me 921 persona, duke mbetur të pazgjidhura në fund gjithsej 538 raste me 1,640 persona.⁹⁹

Mospërputhja e të dhënave në mekanizmin përcjellës për veprat penale karakteristike në KPK, e cila është trajtuar në tabelën sipas kapitujve, në numër të madh është e vident të veprat penale të natyrës së korrupsionit. PSRK është prokuroria me numrin më të madh të rasteve të mos-përputhura,¹⁰⁰ e cila vijon me pas me PTH në Prizren,¹⁰¹

94 Raporti i Progresit për vitin 2016 | Komisionit Evropian, faqe 5, nëntor 2016 në Bruksel. 95 Ibid.

96 Draft-Rezoluta e Parlamentit Evropian për Kosovën, e paraqitur me 9 janar 2017 Komitetin për Politikë të Jashtme në Parlamentin Evropian; <https://europeanestembalkans.com/2017/01/11/ep-draft-report-on-kosovo-serious-concern-about-sloë-progress-in-fight-against-corruption-and-organised-crime/>.

97 Plani i Veprimit për Aritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit, miratuar nga KPK me 1 nëntor 2013 në Prishtinë.

98 Plani i Veprimit për Zgjidhjen e Lëndëve të Korrupsionit, miratuar në dhjetor 2015 nga KGJK në Prishtinë.

99 Shënim: PTH në Prishtinë, PSRK dhe PTH në Mitrovicë, janë prokuroritë me numrin më të madh të rasteve në procedim, të cilat janë pasqyruar si në tabelë.

100 Shënim: Derisa nga viti paraprak (2014) PSRK kishte trashëguar (bartur) gjithsej 47 raste me 261 persona, gjatë vitit 2015 kishte pranuar 14 raste me 52 persona, të cilat gjithsej përfshinin 61 raste me 313 persona në punë gjatë vitit 2015. Nëse llogaritim të gjitha lëndët në punë gjatë vitit 2015 (61 raste me 313 persona) pa lëndët e zgjidhura gjatë periudhës së njëjtë (22 lëndë me 108 persona), dalin të jenë 39 raste me 205 persona dhe jo siç figurojnë në të dhënat e KPK-së, 43 raste me 263 persona.

101 Shënim: PTH në Prizren kishte trashëguar (bartur) nga viti paraprak (2014) gjithsej 18 raste me 52 persona, gjatë vitit 2015 kishte pranuar 45 raste me 101 persona, të cilat gjithsej përfshinin 63 raste me 153 persona në punë gjatë vitit 2015. Nëse llogaritim të gjitha lëndët në punë gjatë vitit 2015 (63 raste me 153 persona) pa lëndët e zgjidhura gjatë periudhës së njëjtë (44 lëndë me 92 persona), dalin të jenë 19 raste me 61 persona dhe jo siç figurojnë në të dhënat e KPK-së, 23 raste me 64 persona.

- Sipas të dhënave të siguruara nga KPK, prokuroritë themelore dhe Prokuroria Speciale e Kosovës, gjatë vitit 2015 kanë pranuar në punë gjithsej 412 raste me 860 persona, kanë zgjidhur 456 raste me 921 persona, duke mbetur të pazgjidhura në fund gjithsej 538 raste me 1,640 persona.











PP korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare - Raste dhe persona të proceduara në secilën prokurori për periudhën raportuese (janar - dhjetor 2015)	Të trashëguara (1 janar 2015)		Të pranuar (2015)		Gjithsej në punë (2015)		Të zgjidhura (2015)		Të pazgjidhura (31 dhjetor 2015)	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
										
PSRK	47	261	14	52	61	313	22	108	43	263
PTh Prishtinë	341	993	155	351	496	1,344	192	324	336	1,018
PTh Prizren	18	52	45	101	63	153	44	92	23	64
PTh Pejë	25	70	45	71	70	141	49	96	22	45
PTh Gjilan	7	18	44	66	51	84	42	67	10	17
PTh Mitrovicë	55	143	43	93	98	236	28	73	71	163
PTh Ferizaj	30	69	32	64	62	133	43	93	19	40
PTh Gjakovë	16	36	34	62	50	98	36	68	14	30
Total	539	1,642	412	860	951	2,502	456	921	538	1,640

TABELA 12: Trendi i rasteve të bartura, pranuar, zgjidhura dhe të pazgjidhura (të mbetura) për veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare në secilën prokurori për periudhën raportuese (janar - dhjetor 2015)











PP Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare - Raste dhe persona të proceduara në secilën prokurori për periudhën raportuese (janar - dhjetor 2016)	Të trashëguara (1 janar 2016)		Të pranuar (janar - dhjetor 2016)		Gjithsej në punë (janar - dhjetor 2016)		Të zgjidhura (janar - dhjetor 2016)		Të pazgjidhura (dhjetor 2016)	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
										
PSRK	46	270	10	30	56	300	25	156	39	162
PTh Prishtinë	338	1034	165	304	503	1338	202	532	223	655
PTh Prizren	21	60	39	80	60	140	34	71	27	69
PTh Pejë	23	47	61	92	84	139	63	97	21	40
PTh Gjilan	9	18	88	173	97	191	76	144	19	48
PTh Mitrovicë	71	164	32	84	103	248	25	61	82	192
PTh Ferizaj	19	43	18	32	37	75	20	28	17	47
PTh Gjakovë	14	31	30	29	44	60	16	26	19	35
Total	541	1667	443	824	984	2491	461	1115	447	1248

TABLE 13: Trendi i rasteve me persona të bartura, pranuar, zgjidhura dhe të mbetura në fund në prokurori për veprat penale kundër detyrës zyrtare , për periudhën raportuese (janar - dhjetor 2016).

atë në Prishtinë¹⁰² dhe PTh në Pejë.¹⁰³

Bazuar në statistika, prokuroritë nuk kanë arritur të zvogëlojnë numrin e rasteve në procedim, përkundër faktit se kanë zgjidhur një numër të madh të rasteve, aq sa kanë pranuar gjatë vitit.

102 Shënim: Derisa nga viti paraprak (2014) PTh në Prishtinë kishte trashëguar (bartur) gjithsej 341 raste me 993 persona, gjatë vitit 2015 kishte pranuar 155 raste me 351 persona, të cilat gjithsej përfshinin 496 raste me 1344 persona në punë gjatë vitit 2015. Nëse llogaritim të gjitha lëndët në punë gjatë vitit 2015 (496 raste me 1344 persona) pa lëndët e zgjidhura gjatë periudhës së njëjtë (192 lëndë me 324 persona), dalin të jenë 304 raste me 1,020 persona dhe jo siç figurojnë në të dhënat e KPK-së, 336 raste me 1,018 persona.

103 Shënim: PTh në Pejë kishte trashëguar (bartur) nga viti paraprak (2014) gjithsej 25 raste me 70 persona, gjatë vitit 2015 kishte pranuar 45 raste me 71 persona, të cilat gjithsej përfshinin 70 raste me 141 persona në punë gjatë vitit 2015. Nëse llogaritim të gjitha lëndët në punë gjatë vitit 2015 (70 raste me 141 persona) pa lëndët e zgjidhura gjatë periudhës së njëjtë (49 lëndë me 96 persona), dalin të jenë 21 raste me 45 persona dhe jo siç figurojnë në të dhënat e KPK-së, 22 raste me 45 persona.

Tabela 13, gjithashtu ka pasqyruar rastet e korrupsionit në të gjitha PTh-të dhe në atë Speciale, për vitin 2016:

Në vitin 2016 trendi i rasteve të pazgjidhura është më i vogël krahasuar me atë të vitit paraprak dhe më me pak persona të përfshirë. Derisa në vitin paraprak ishin gjithsej 538 raste me 1,640 persona, të mbetura të pazgjidhura në fund të vitit 2016, prokuroritë kishin gjithsej 447 raste me 1,248 persona. Për këtë periudhë kohore, prokuroritë kishin pranuar gjithsej 443 raste me 824 persona, kishin zgjidhur 461 raste me 1,115 persona, derisa kishin mbetur në procedim në të gjitha prokuroritë 447 raste me 1,248 persona.



Nëse krahasojmë përqindjen e numrit të lëndëve të korrupsionit në gjithë Kosovën me numrin e prokurorëve në gjithë Kosovën, del se PTh në Prishtinë posedon më shumë lëndë në krahasim me prokuroritë tjera derisa më pak prokuror në krahasim më përqindjen me prokuror në prokuroritë tjera.

Sistemi prokurorial në Kosovë deri me 1 dhjetor 2016, numëronte gjithsej 146 prokurorë nga të cilët, 48 prokurorë kishte Prokuroria Themelore në Prishtinë. Bazuar në statistikën e tillë, Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte 32% e të gjithë prokurorëve, ndërsa rreth 50% të të gjitha lëndëve që kishin mbetur në procedim.

Çohu! dhe CSD vlerësojnë se përkundër faktit se prokuroritë kanë zgjidhur një numër të madh të rasteve për vitin 2016, shqetësues vazhdon të mbetet trashëgimi i lëndëve të shumta nga viti në vit.

Nga gjithsej 447 rastet me 1,248 personat të mbetura në procedim si raste të pazgjidhura, 52.48% apo më shumë se gjysma e të gjithë personave të përfshirë në raste, vazhdojnë të mbetën në PTh në Prishtinë, ndërsa 47.52% e tyre mbetën të shpërndara në prokuroritë tjera themelore dhe në atë speciale.

Nëse krahasojmë përqindjen e numrit të lëndëve të korrupsionit në gjithë Kosovën me numrin e prokurorëve në gjithë Kosovën, del se PTh në Prishtinë posedon më shumë lëndë në krahasim me prokuroritë tjera derisa më pak prokuror në krahasim më përqindjen me prokuror në prokuroritë tjera.

Sistemi prokurorial në Kosovë deri me 1 dhjetor 2016, numëronte gjithsej 146 prokurorë nga të cilët, 48 prokurorë kishte Prokuroria Themelore në Prishtinë. Bazuar në statistikën e tillë, Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte 32% e të gjithë prokurorëve, ndërsa rreth 50% të të gjitha lëndëve që kishin mbetur në procedim.

Organizata Çohu! dhe CSD konsiderojnë se një numër i madh i rasteve të pazgjidhura, të trashëguara nga viti në vit, vazhdojnë të rëndojnë tutje prokuroritë me numër të madh të lëndëve, gjithashtu qytetarët të cilët gjenden vazhdimisht në procedurat hetimore.

Çohu! dhe CSD vlerësojnë se KPK duhet rritur numrin e prokurorëve, proporcionalisht me ngarkesën e lëndëve sipas prokurorive, duke ndikuar sadopak në trajtimin më me efikasitet të rasteve të natyrave të ndryshme.

Ndryshe nga prokuroritë, gjykatat nuk posedojnë numër të shpërputhur të rasteve nëpër muaj dhe vite. Mirëpo gjykatat posedojnë numër më të vogël të rasteve të zgjidhura krahasuar me prokuroritë, për të dyja periudhat, 2015 dhe 2016.

Derisa gjatë vitit 2015, prokuroritë kishin zgjidhur 456 raste të natyrës korruptive, në anën tjetër gjykatat kishin zgjidhur 260 raste të natyrës së njëjtë. Ndërsa gjatë vitit 2016, derisa prokuroritë kishin zgjidhur gjithsej 461 raste, në anën tjetër gjykatat për periudhën e njëjtë kishin zgjidhur 357 raste të natyrës së korrupsionit.

Organizata Çohu! dhe CSD kanë kategorizuar gjithashtu rastet e korrupsionit nga gjykatat, ato të trashëguara, të pranuar, mënyra e zgjidhjes, të tjerat që janë bartur në kompetencë si dhe ato të mbetura në fund (të pazgjidhura) për vitin 2015 dhe 2016.

Në tabelën numër 14 janë pasqyruar rastet për veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare për periudhën gjatë vitit 2015, rastet e bartura apo trashëguara nga viti paraprak, ato të pranuar gjatë vitit 2015, të zgjidhura, të bartura në kompetencë dhe të pazgjidhura në fund për të gjitha gjykatat sipas veprave penale të natyrës së korrupsionit:

Kapitulli i veprave penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare përmban gjithsej 16 lloje të veprave penale të cilat janë paraqitur në tabela (tabela numër 14 dhe 15). Marrë parasysh fokusin dhe qasjen në monitorimin e seancave gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë, atë në Gjilan dhe Gjykatën Themelore në Mitrovicë, implementuar nga Organizata Çohu! dhe CSD, Çohu! ka bërë kategorizimin e të dhënave për kapitujt e trajtuar, po ashtu për veprat penale.



Gjendja me lëndët në gjykatat themelore gjatë vitit 2015

Procedimi i rasteve për veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare janar 2015	Trashëguara	Të pranuar gjatë 2015	Gjithsej në punë	MËNYRA E ZGJIDHJES										Pazgjidhura në fund
				LLOJET E DËNIMEVE				Aktgjykim Lirues	Aktgjykim Refuzues	Parashkrim	Mënyrë tjetër	Zgjidhura gjithsej	Bartur në kompetencë	
				Burg	Gjobë	Kusht	Tjera							
Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	237	137	374	20	5	14	0	23	20	10	22	114	8	252
Keqpërdorimi i informatës zyrtare	0	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Konflikti Interesit	0	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Përvetësimi në detyrë	93	19	112	2	0	7	0	2	1	1	1	14	1	97
Mashtrimi në detyrë	9	4	13	1	1	0	0	0	0	0	0	2	0	11
Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	18	2	20	0	1	0	0	1	0	0	0	2	0	18
Marrja e ryshfetit	73	18	91	5	2	2	0	6	3	0	2	20	1	70
Dhënia e ryshfetit	36	37	73	1	25	9	0	1	0	2	1	39	2	32
Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Ushtrimi i ndikimit	16	3	19	0	0	3	0	0	0	0	2	5	0	14
Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore	7	4	11	0	0	0	0	0	0	0	3	3	0	8
Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	8	4	112	0	0	0	0	0	0	0	2	2	0	10
Falsifikimi i dokumentit zyrtar	93	8	101	1	0	2	0	3	2	0	1	9	1	91
Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme..	6	1	7	0	0	0	0	1	0	0	1	2	0	5
Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë.	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Mosraportimi apo raportimi i remë i..	63	41	104	4	6	16	1	7	7	0	7	48	0	56
TOTAL	662	282	944	34	40	53	1	44	33	13	42	260	13	671

TABLE 14: Trendi i rasteve të bartura (trashëguara), pranuar, zgjidhura dhe të mbetura në fund në gjykata për veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare, për periudhën raportuese (janar – dhjetor 2015)

Gjendja me lëndët në gjykatat themelore gjatë vitit 2016

Procedimi i rasteve për veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare janar - dhjetor 2016	Trashëguara	Të pranuara	Gjithsej në punë	MËNYRA E ZGJIDHJES										Pazgjidhura në fund
				LLOJET E DËNIMEVE				Aktgjykim Lirues	Aktgjykim Refuzues	Parashkrim	Mënyrë tjetër	Zgjidhura gjithsej	Bartur në kompetencë	
				Burg	Gjobë	Kusht	Tjera							
Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	250	111	361	19	8	18	0	48	23	112	15	143	1	217
Keqpërdorimi i informatës zyrtare	250	159	409	27	10	26	0	64	29	13	25	194	1	214
Konflikti Interesit	2	1	3	1	0	1	0	0	0	0	0	2	0	1
Përvetësimi në detyrë	2	3	5	0	0	0	0	0	0	0	2	2	0	3
Mashtrimi në detyrë	97	20	117	7	4	12	0	5	1	1	3	33	0	84
Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	9	1	10	1	0	0	0	1	0	0	1	3	0	7
Marrja e ryshfetit	18	2	20	0	1	1	0	0	0	0	0	2	0	18
Dhënia e ryshfetit	70	21	91	12	0	5	0	2	3	3	2	27	0	64
Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj	30	30	60	2	12	7	1	0	1	2	2	27	0	33
Ushtrimi i ndikimit	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore	14	1	15	1	3	1	0	2	0	0	1	8	0	7
Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	7	0	7	0	0	0	0	1	0	0	0	1	0	6
Falsifikimi i dokumentit zyrtar	10	0	10	0	0	0	0	2	0	0	0	2	0	8
Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme ..	90	3	93	2	0	1	0	1	1	1	1	7	0	86
Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë.	5	2	7	0	0	0	0	1	3	0	1	5	0	2
Mosraportim apo raportimi i rremë pasurisë	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
TOTAL	64	15	79	1	10	13	1	5	11	0	3	44	0	35

TABLE 15: Trendi i rasteve të bartura (trashëguara), pranuar, zgjidhura dhe të mbetura në fund në gjykata për veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare, për periudhën raportuese (janar – dhjetor 2016)



Gjatë vitit 2015, vetëm PSRK kishte zgjidhur raste, 16 të tilla me 113 persona, duke mbetur në fund të pazgjidhura 47 raste me 354 persona në vitin 2015 (31 dhjetor).



Njëjtë si në rastet e korrupsionit, gjithashtu rastet e krimit të organizuar, janë identifikuar mospërputhje të të dhënave nga rastet në fund të vitit 2015 me ato të bartura apo trashëguara në fillim të vitit 2016.

Sipas të dhënave të tilla të siguruar nga KGJK, gjatë vitit 2015 gjykatat kishin në punë afro 1,000 raste nga veprat e tilla penale, saktësisht 944 raste. Organizata Çohu! dhe CSD kanë krahasuar të dhënat e bartura, ato të pranuar, duke krahasuar po ashtu më rastet e zgjidhura gjatë periudhës së njëjtë me ç’rast del të jenë ngarkuar gjykatat edhe më shumë me rastet e tilla.

Çohu! dhe CSD vlerësojnë se gjatë vitit 2015, gjykatat nuk ishin treguar efikase. Nga gjithsej 944 rastet në punë (662 raste të bartura dhe 282 raste të reja të pranuar gjatë vitit 2015), gjykatat kishin zgjidhur vetëm 260 të tilla. Nga kjo shifër rezultojnë se gjykatat nuk kishin arritur të zgjidhnin as shifrën e 282 rasteve të pranuar gjatë vitit, duke u ngarkuar tutje më lëndët e natyrës së njëjtë. Si rezultat, të pazgjidhura në fund të vitit 2015 kishin mbetur gjithsej 671 raste.

Tabela tjetër në vijim, ka pasqyruar rastet për veprat e njëjta penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare për 2016:

Tabela nr. 15: Trendi i rasteve të bartura (trashëguara), pranuar, zgjidhura dhe të mbetura në fund në gjykata për veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare, për periudhën raportuese (janar – dhjetor 2016)

Çohu! dhe CSD vlerësojnë se vendimi për t’i trajtuar me prioritet rastet e tilla, duket të ketë dhënë rezultatet e para, me ç’rast edhe numri i rasteve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese, përkatësisht me 31 dhjetor 2016, është më i vogël krahasuar me numrin e rasteve të pazgjidhura në fund të vitit 2015.¹⁰⁴

104 Shënim: Derisa në fund të vitit 2015, gjykatat kishin të pazgjidhura 671 raste, në fund të periudhës raportuese për vitin 2016, përkatësisht me 31 dhjetor 2016, gjykatat kishin të pazgjidhur 571 raste.

Ndryshe nga viti paraprak, gjatë vitit 2016 gjykatat kishin qenë më efikase, duke zgjidhur më shumë raste. Derisa gjatë vitit paraprak kishin zgjidhur gjithsej 260 raste, në vitin 2016 gjykatat kishin zgjidhur 357 raste.¹⁰⁵

Sa u përket rasteve të zgjidhura nga gjykatat, për periudhën e njëjtë, 2016, gjykatat kishin zgjidhur më së shumti raste po për veprën penale Keqpërdorim i detyrës zyrtare (194 raste), Mosraportim apo raportim i rremë i pasurisë.. (44), Përvetësimi në detyrë (33), Marrja e ryshfetit (27) dhe Dhëna e ryshfetit (27) si dhe të tjerat të pasqyruara si në tabelën 17.¹⁰⁶

Organizata Çohu! dhe CSD konsiderojnë se numri i madh i rasteve të trashëguara nga viti në vit, vazhdojnë të mbetën ngarkesa kryesore, në veçanti për gjyqësorin. Profilizimi i prokurorëve dhe gjykatësve për veprat penale të natyrës së njëjtë, gjithashtu rritja e numrit të nevojshëm me prokurorë, gjykatës dhe bashkëpunëtor profesional, do të ndikonte në zvogëlimin e numrit të madh të lëndëve në gjykata dhe prokurori, si dhe në procedimin më efikas të prokurorisë dhe gjykatave në trajtimin e rasteve të korrupsionit.

105 Gjatë vitit 2016, gjykatat kishin në punë 929 raste. Nga gjithsej 929 rastet në punë (671 raste të bartura dhe 258 raste të reja të pranuar gjatë vitit 2016), gjykatat kishin zgjidhur 357 të tilla. Nga kjo shifër rezultojnë se gjykatat kishin arritur të zgjidhnin 357 raste ndërsa kishin pranuar 258 të reja, duke rezultuar të pazgjidhura në fund gjithsej 571 raste.

106 Nga gjithsej 16 llojet e veprave penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare, vepra penale Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar mbetet vepra me numrin më të madh të rasteve, gjithsej 409 raste nga 929 sa kishin në punë gjykatat për periudhën vitin 2016. Më pas vije vepra penale Përvetësimi në detyrë me 117 raste në punë si dhe ajo e Falsifikimit të dokumentit zyrtar me 93 raste për periudhën e njëjtë. Ndërsa të mënyra e zgjidhjes së rasteve, si në vitin paraprak, dominojnë rastet e shumta të përfshira apo vendosura me aktgjykim lirues (84), aktgjykim refuzues (49) si dhe të parashkruara (20), gjithsej 153 raste nga gjithsej 357 rastet e zgjidhura në vitin 2016. Për periudhën e njëjtë, 54 raste ishin vendosur me dënim me burg, 40 me gjobë si dhe 67 me dënim me kusht.











PP Krimi Organizuar- Raste dhe persona në secilën prokurori për periudhën raportuese (janar - dhjetor 2015)	Të trashëguara		Të pranuarra (janar - dhjetor 2015)		Gjithsej në punë (janar - dhjetor 2015)		Të zgjidhura (janar - dhjetor 2015)		Të pazgjidhura (31 dhjetor 2015)	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
										
PSRK	39	301	14	156	53	457	16	113	45	344
PTh Prishtinë	1	4	0	0	1	4	0	0	1	4
PTh Prizren	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PTh Pejë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PTh Gjilan	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PTh Mitrovicë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PTh Ferizaj	1	6	0	0	1	6	0	0	1	6
PTh Gjakovë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total	41	311	14	156	55	467	16	113	47	354

TABELA 16: Trendi i rasteve me persona të bartura, pranuarra, zgjidhura dhe të mbetura në fund në prokurori për veprën penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar, për vitin 2015.

2.2 Rastet e Krimit të Organizuar

Kodi Penal i Kosovës i cili kishte hyrë në fuqi në vitin 2013, kishte kategorizuar në kapitull të veçantë krimin e organizuar, të cilin kishte paraparë në nenin 283 të kualifikuar si Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar.¹⁰⁷

Organizata Çohul dhe CSD të cilat kanë në fokus gjithashtu rastet e krimit të organizuar, kanë analizuar rastet e tilla në prokurori dhe gjykata për vitet 2015 dhe 2016 të cilat gjithashtu futën në kuadër të lëndëve të kategorizuara nga KPK dhe KGJK si lëndë për trajtim me prioritet.

Bazuar në dispozitat ligjore, pothuajse në të gjitha rastet, krimi i organizuar bie në kompetencën e Prokurorisë Spe-

cialë të Kosovës. Sipas të dhënave të siguruar në KPK, PSRK është e ngarkuar më pothuajse të gjitha rastet e krimit të organizuar. Përveç PSRK-së, raste nga krimi i organizuar për veprën penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar, kanë në procedim gjithashtu PTh në Prishtinë dhe PTh në Ferizaj.

Tabela numër 16, ka pasqyruar rastet e krimit të organizuar të proceduara në prokurori gjatë vitit 2015:

Nga gjithsej 55 rastet me 467 personat në punë, PSRK kishte 53 raste me 457 persona, derisa PTh në Prishtinë 1 rast me 4 persona, ndërsa PTh në Ferizaj 1 rast me 6 persona. Gjatë vitit 2015, vetëm PSRK kishte zgjidhur raste, 16 të tilla me 113 persona, duke mbetur në fund të pazgjidhura 47 raste me 354 persona në vitin 2015 (31 dhjetor).

¹⁰⁷ Kodi Penal i Kosovës, neni 183 - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834>.











